

Maj 2014
Numri: 74
E përmuajshme

Revistë edukative-kulturore - www.revistaetika.com

Shqipëri: 200 Lekë
Kosovë: 1.5 Euro
Maqedoni: 90 Den

ETIKA



QETËSIA DHE SIGURIA
OSMAN NURI TOPBASH



IMAM BUKHARIU
IMAM MUHAMMED SYFARI



IDLIR BEKTESHI
EKONOMIA TURKE



NUREDIN JËLLDËZ
KJO BOTË



ËRËSITË DHE DOBITË
E ADHURIMEVE NË ISLAM
ARIJAN YMERAJ



SALIH ZEKI MERIÇ
NË KËTË KOHË,
BESIMI ËSHTË SI ZJARR
QË MBARTET NË DORË...

Të shohësh me Nurin e Allahut...

INTUITA E BESIMTARIT



ISSN 2227-3611 0 5
9 772227 361004



KOPSHTI

Aromë Trëndafili



**U HAP KOPSHTI
“Aromë Trëndafili”!**

**Regjistrimet vazhdojnë...
Ju mund të paraqiteni
çdo ditë tek godina pranë xhamisë Perash.**



**Kushte bashkëkohore,
ushqim cilësor dhe i kontrolluar,
staf i kualifikuar, çmime të arsyeshme,
transporti është i garantuar.**

Na kontaktoni në numrin 0676078223.

Ju mirëpresim!



(Me mbështetjen e Shoqatës “Istanbul”)

Ka një fjalë të urtë, që thotë: "Të shohësh më tutje tri dredhive". Kjo fjalë shpreh se përtej asaj që duket, ka edhe të vërteta të tjera dhe se aftësia e vërtetë është të ndjerit dhe të perceptuarit e tyre. Përpykja për të kuptuar se çfarë mund të ketë pas ngjarjeve që ndodhin dhe vlerësimi i së djeshmes, të sotmes dhe të nesërme bashkë me to, më shumë është një çështje horizonti se sa një shikim momental dhe ditor. Madje, përpykja për të kuptuar botën e padukshme, e cila është përtej botës së dukshme, të perceptosh të përkohshmen, provizoren e të përhershmen dhe të kesh një kuptim e konceptim të jetës sipas tyre, është mençuri, mendjemprehtësi, largpamje, maturi dhe urtësi. E kundërta e kësaj, është budallallëku, madje verbëria. Allahu Teala thotë:

"(O Pejgamber!) **Vallë, a nuk kanë udhëtuar ata nëpër botë** (ata që të kundërshtojnë), **që zemrat e tyre të mendojnë dhe veshët të dëgjojnë? Në të vërtetë, atyre nuk u janë verbuar sytë** (në këto gjëra), **por u janë verbuar zemrat që kanë në kraharor.**" (Haxh, 46)

Funksioni i mendimit për njeriun ka një rëndësi shumë të madhe. Nëse dikujt i humb kjo cilësi, do të thotë se ka rënë në pozitën e të qenit krijesa më e keqe që ecën mbi tokë. Sepse sipas deklarimit të Kuranit Fisnik, të mosmëduarit është shkaku më kryesor i femohimit dhe ndyrësisë së shirkut, që e groposin njeriun në errësirën e injorancës në këtë botë të të vërtetave dhe e hedhin në gropën e xhehenemit në Ahiret.

Ndërsa koncepti i largpamësisë që shprehet si "syri i zemrës", është një fjalë arabe e ardhur nga rrënja "basar /shikim" dhe do të thotë "të shohësh, të ndjesh dhe sy". Në përgjithësi përkufizohet si "fuqia e perceptimit të së vërtetës së ekzistencës materiale dhe shpirtërore të zemrës së ndriçuar me dritën e shenjtë". Xhurxhani (v.816/1413), thotë se filozofët e kanë quajtur këtë fuqi të zemrës "kuvvetu'l-kudsijeh" ose "kuvvetu'n-nadharijeh".

Koncepti i largpamësisë në Kuranin Fisnik, kur bëhet fjalë për njeriun, në përgjithësi është përdorur në kuptimin "të shikosh", veçanërisht "të zbulosh të vërtetat, të njohësh rrugën e drejtë, të ndash të vërtetën nga e gabuara dhe aftësia për të marrë mësim" dhe në shumicën e rasteve është shfaqur si e kundërta e "verbimit shpirtëror" dhe e "devijimit".

Mistikët pranojnë se sikundër dy syve që njeriu ka në trup e me të cilët shikon botën e jashtme, edhe zemra ka një sy që shikon botën e padukshme dhe këtë e quajnë "ajnun'l-kalb / syri i zemrës", "dide-i xhan / syri i shpirtit" dhe "marifet gëzy / syri i marifetit". Siç shikon syri që kemi në trup krijesat, ngjarjet, ngjyrat dhe format në botën materiale, edhe syri i zemrës shikon anën e brendshme të gjërave e të ngjarjeve në botën e jashtme dhe të vërtetat në botën shpirtërore.

Syri në trup gjendet te njerëzit dhe te kafshët, por syri i zemrës i përket vetëm njeriut. Syri i zemrës është funksional te çdo njeri. Edhe pse ky sy është i hapur te disa që nga lindja si një dhuratë e Allahut Teala, ai shpeshherë mbulohet nga perdja e ndjenjës. Prandaj, ai duhet të hapet me përpjekje. Disa njerëzve u hapet shpejt syri i zemrës, ndërsa disa të tjerëve u hapet vonë. Edhe atyre që u është hapur largpamësia, kanë grada të ndryshme në shikimin e të vërtetave përtej shqisave. Siç mund të gabojë në shikim syri i trupit, mund të gabojë edhe syri i zemrës. Syri i zemrës mund të shohë plotësisht apo mangët sipas gradës së pastërtisë që zotëron.

Maj 2014

VITI: VIII
NUMRI: 74

BOTUESI
Shtëpia botuese "Progresi"

DREJTOR
Albert Halili

KRYEREDAKTOR
Alban Kali

REDAKTOR
Zija Vukaj

PËRKTHYES
Albert Halili
Artur Tagani
Fatmir Sulaj
Ilir Hoxha

DIZAJN
Bledar Xama

ADRESA
Rr: Studenti; Sheshi "2 Prilli"
Shkodër; Shqipëri

MOBILE
+355 67 607 8484

E-MAIL
revistaetika@progresibotime.com

WEBSITE
www.revistaetika.com

KOSOVË
Rr: Ardian Zurnaxhiu; pn. Ralin
Prizren; Kosovë
Mob: +377 4411 9848

MAQEDONI
Drvarska 28; Stara Carsija
Skopje; Makedonija
Mob: +389 7042 8245

ABONIMI VJETOR
Shqipëri: 2000 lekë
Kosovë: 15 Euro
Maqedoni: 900 Denar

Ju bëjmë të ditur se materialet e sjella në redaksi pavarësisht nëse botohen apo jo nuk i kthehen autorit. Koha e botimit të një materiali përcaktohet nga redaksia. Honoraret e shkrimeve autoriale ose përkthimeve duhet të vini t'i tërhiqni pranë Shtëpisë Botuese "Progresi" ose pranë zyrove të përfaqësimit në Kosovë dhe Maqedoni.

Përmbajtja



8

Mendimi dhe Firaseti
Prof. dr. Ismail Lutfi Çalkan



Siguria dhe Qetësia
Osman Nuri Topbash

34




28



20


Kjo botë
Nuredin Jëlldëz

- 5 Intuita e besimtarit**
Ahmet Tashgetiren
- 7 Edukimi i një brezi fetar**
Sadik Dana
- 11 Lutja**
Fatma Dilek
- 15 Të përfitosh nga ibadeti**
Rabia Christine Brodbeck
- 17 Forca e fjalës**
Ali Riza Temel
- 22 Ata që vrapojnë drejt mëshirës së Allahut**
Xhafer Durmush
- 24 Jeta e kësaj bote**
Dr. Kerim Bulladë
- 26 Mëshira është karakteri i myslimanit**
Prof. dr. Sulejman Derin




56

- Imam Bukhari** 28
Imam Muhamed Sytari
- Urtësia në historitë e Kuranit Fisnik** 30
Xhemal Nar
- Një Ajet - Një Hadith** 32
- Urtësitë dhe dobittë e adhurimeve në Islam** 42
Arjan Ymeraj
- Njeriu në etapën estetike** 48
Nuredin Nazarko
- Ekonomia Turke, ecuri dhe sfida** 50
Idlir Bekteshi
- Rëndësia dhe vlera e namazit të natës** 52
Jonida Vishkurti
- Arti në ateizëm ose në totalitarizëm** 54
Edison Çeraj
- Ndëshkimi i madh** 56
Filiz Konxha



Në këtë kohë, besimi
është si zjarr që mbartet në dorë...
Salih Zeki Meriç

40



Njeriu model për shërbimin fetar
Prof. dr. Hasan Kamil Jëllmaz

45

Intuita e Besimtarit

Ahmet Tashgetren

Nga i Dërguari i Allahut (a.s.), transmetohet një hadith i tillë:

"Ruhuni nga intuita (forca depërtuese e perceptimit përtej shqisor) e besimtarit, sepse ai sheh me dritën e Allahut!" (Tirmidhi, Tefsiru'l-Kur'an, 16, Sujuti, el-Xhamiu's-Sagir, 1, 24.)

Ky hadith ka edhe një pjesë që lidhet me Osmanin (r.a.), ku thuhet:

Osmani (r.a.), një njeriu që i vjen pranë, i thotë: "Në sytë e tu ka gjurmë zinaje (imoraliteti). Ti ke parë një grua." Njeriu hidhet e thotë: "Si e di këtë?". Ndërsa Osmani (r.a.), i përmend hadithin e Pejgamberit (a.s.): *"Ruhuni nga intuita e besimtarit, sepse ai sheh me dritën e Allahut!"*

Nëse shohim në traditat tona të shoqërisë islame, vërejmë se në përgjithësi, këtë hadith e kuptojmë në këtë kuadër dhe se mendimet tona i fokusojmë tek shprehja "ruhuni".

Për shembull, thuhet:

"Kur ndodheni pranë një të dashuri të Allahut, duhet të keni kujdes zemrën tuaj, sepse i dashuri i Allahut e di se ç'keni në zemra dhe, nëse aty ndodhet diçka e keqe, do të turpëroheni."

Padyshim, kjo ka edhe pjesën e saj të vërtetë. Pra, nëse do Allahu, mundet që ato të cilat ndodhen në zemrën e këtij apo atij robi, t'ua bëjë të ditur të dashurve të Vet. Mirëpo, kur pyesim se a duhet të kuptohet ky hadith vetëm në këtë mënyrë, në mendjen tonë do të lindin pyetje të tjera.

Për shembull, pyetjet mbi të cilat duhet të mendo hemi përsëri janë:

-Vallë, çfarë është në të vërtetë "intuita e besimtarit", për të cilën ka folur Rasulullahu (a.s.)?

-A ka ndonjë dimension tjetër intuita e besimtarit, përveçse të dijë se çka në zemrat e të tjerëve?

-Nëse e kufizojmë intuitën e besimtarit vetëm me njohjen e zemrave, çfarë dallimi i garanton kjo besimtarit dhe bashkësisë së besimtarëve?

-Çfarë shikimi duhet të kesh "për të parë me dritën e Allahut"?

-Vallë, a është një cilësi e veçantë vetëm për disa njerëz në bashkësinë e myslimanëve ajo të cilën e quajmë "intuita e besimtarit"?

-Nëse shohim mjerimin që po përjetojnë sot besimtarët dhe shoqëritë myslimane, a mund të flitet për ndonjë problem që po përjetojmë në lidhje me çështjen e "intuitës së besimtarit" dhe "shikimit me dritën e Allahut"? Ku është mangësia jonë si shoqëri Islame?

Këto pyetje i bëjmë me qëllim që të shohim saktë horizontin e "intuitës së besimtarit" që ka vënë përballë nesh Rasulullahu (a.s.).

Në një hadith kudsî, të transmetuar nga Rasulullahu (a.s.), flitet për faktin, se: "Allahu mund të bëhet syri me të cilin besimtari sheh, veshi me të cilin dëgjon, këmba me të cilën ecën, zemra me të cilën kupton dhe gjuha me të cilën flet". (shih. Buhari, Rikak, 38)

Padyshim që këto janë në lidhje me domosdoshmërinë e njëfarë "cilësie të besimtarit". Si bëhet Krijuesi syri, veshi apo zemra e besimtarit?

Nëse e shohim brenda një dimensionit tjetër shprehjen "intuita e besimtarit", mbase na vijnë në mendje edhe këto hadithe e ajete fisnike:

"Besimtari nuk bie dy here në të njëjtën grackë." (Buhari, Edeb, 83; Muslim, Zuhd, 63)

"O ju që besuat! Nëse i frikësoheni Allahut, Ai do t'ju japë aftësinë e të gjykuarit drejt..." (Enfal, 29)

"...Ky (Kuran) është vetëm dëshmi ndriçuese nga Zoti juaj, udhërrëfyes dhe mëshirë për njerëzit që besojnë." (Araf, 203)

Për të mos rënë dy herë në të njëjtën grackë, kërkohet njëfarë vigilance e mendjes ndaj rreziqeve e kompleteve. Nga ana tjetër, krijohet një lidhje direkte ndërmjet aftësisë për të ndarë të drejtën nga e shtrembëta dhe devotshmërisë. Dhe Kurani garanton një ndriçim urtësie për besimtarët.

Nisur nga këto ajete, mund të shihet se intuita ka një afërsi kuptimore me largpamësinë dhe mund të themi se përmban edhe kuptimet, si shikim i thellë, shikim përtej të dukshmes, perceptim, dallimi i menjëhershëm i asaj që të tjerët nuk e dallojnë etj. Në fakt, për shkak se intuita realizohet në sajë të "shikimit me dritën e Allahut", është e qartë se shpreh një shikim përtej syrit,

një shikim të ndriçuar nga Allahu.

Gjithashtu, i qartë është edhe fakti se intuita e besimtarit tregon një shikim të thellë në çdo fushë të jetës. Dhe një qasje e tillë vendos para nesh një tokë shkëmbore për sa i përket pyetjes në lidhje me marrëdhënien midis gjendjes së botës islame në ditët tona dhe "intuitës së besimtarit".

Kur i marrim parasysh të gjitha këto probleme, ndërkohë që vlerësojmë lidhjen e besimtarit me intuitën, e shohim të nevojshme të thurim njëra pas tjetrës këto fjali:

-Intuitë, do të thotë të deshifrosh të fshehtën e kohës në të cilën jeton. Intuitë është të shohësh vështirësitë dhe lehtësitë që vë përpara besimtarëve kjo kohë në të cilën ndodhemi dhe të zgjedhësh midis tyre atë më të mirën për gjithë botën islame.

- Intuitë, do të thotë të shohësh saktë gjendjen në të cilën ndodhen shoqëritë islame, t'i analizosh ato dhe nga të gjitha këto, të prodhosh një rrugëzgjdhje që do t'i japë fund këtij mjerimi.

-Intuitë, do të thotë të shohësh botën tjetër dhe ato me të cilat do të përballemi atje.

- Intuitë, do të thotë të shohësh se Allahu të sheh në çdo moment.

- Intuitë, do të thotë të shfaqësh një personalitet të ndër-tuar me të gjitha këto kritere.

Çështja e mjerimit të botës islame është një realitet të pak-tën 100- vjeçar. Dhe ne sot, edhe pas 100 vjetësh ndodhemi në kriza të ngjashme.

Para 100 vjetësh, pothuajse e gjithë bota islame u përmbys përdhe. Sot pas 100 vjetësh, ende flasim për zonat e dhimbjes dhe mjerimin e besimtarëve. Pra, kjo do të thotë se ne kemi probleme në çështjen e vlerësim-it të aktualitetit nën "shikimin me dritën e Allahut".

Mbase edhe të kuptojmë tokmakët që na bien mbi kokë, është një urtësi...

Mbase edhe të shohim ujçërit e egër që na vërsulen kur jemi duke u munduar veç për kafshatën e gojës...

Pra, ejani të gjithë o njerëzit e mençur të umetit të ditëve tona, t'i kontrollojmë përsëri sytë dhe zemrat tona, duke e parë edhe njëherë shekullin tonë e të hapim një rrugë që do ta takojë umetin tonë me lavdinë dhe nderin.





EDUKIMI i një brezi fetar

Sadik Dana

Fëmijët janë një amanet në duart e prindërve. Zemra e pastër dhe e kulluar e fëmijëve, është si një xhevahir, si një tokë e pastër. Dhe çfarë të mbillet në atë tokë të pastër, ajo do të korret. Në suren et-Tahrim, Allahu Teala ka urdhëruar: **“O ju, që besoni! Ruani veten dhe familjet tuaja nga zjarri, lënda djegëse e të cilit janë njerëzit dhe gurët...”** (Tahrim, 6)

Mbrojtja e fëmijëve nga zjarri i xhehenemit, arrihet duke u mësuar atyre besimin, adhurimet, detyrimet fetare (farzet), hallallet, haramet dhe duke i ruajtur nga shoqëria e pafe dhe e pamoralshme. Shoku i keq është babai i të gjitha të këqijave.

Prindërit që nuk ua mësojnë dhe nuk ua bëjnë të dashur fëmijëve të tyre Allahun Teala dhe Pejgamberin (a.s.), konsiderohen si shkatërrues të kësaj bote dhe botës tjetër për fëmijët e tyre. Mosgritja e fëmijës për namaz me arsyen që të mos ftohet apo të mos e prishë gjumin, është një nga shkatërrimet më të mëdha që i bëhet të ardhmes së fëmijës. Ky veprim nuk është mirësi, por një e keqe e madhe ndaj fëmijës. Në fakt, as që mund të mendohet ndonjë e keqe më e madhe se kjo.

Nëse prindërit janë të mëshirshëm, nëse i duan fëmijët e tyre, më parë u mësojnë fenë, pastaj dituritë e tjera në lidhje me këtë botë. Nëse ata u mësojnë fëmijëve të tyre vetëm se si të fitojnë sa më shumë para në këtë botë dhe e lënë pas dore mësimin e fesë, tregojnë se ata janë njerëzit më të pamëshirshëm ndër të pamëshirshmit.

Të rritësh fëmijë pa i edukuar me dituri fetare, është njësoj sikur të kultivosh pemë për t'i djegur në sobë. Allahu Teala duhet falënderuar për çdo të mirë që na ka falur. Nëse nuk falënderohet, ajo mirësi një ditë do të na ikë nga duart. Fëmija është një nga mirësitë më të mëdha që na ka falur Allahu Teala. Nëse fëmijën tonë nuk e edukojmë me besimin dhe moralin islam, nuk e kemi kryer falënderimin tonë për këtë mirësi. Mbi të gjitha, kemi tradhtuar amanetin që na ka lënë Allahu. Prandaj, i lutemi Allahut të na ruajë nga mosmirënjohja ndaj të mirave dhe tradhtia ndaj amanetit. Amin!

Edukimi i fëmijës duhet të fillojë që prej moshës trevjeçare. Mendimet apo fjalët e kota, si; “është ende i vogël, nuk kupton, etj.”, duhen hedhur mënjanë. Bima përkulet, kthehet dhe merr formë sa është ende filiz i njomë. Kur rritet, ngurtësohet dhe as nuk përkulet e as nuk merr formë. Pra, nëse neglizhohet në edukimin e tij pas

kësaj moshe, vetëm sa ia kemi vështirësuar punën vetes. Nëse prindërit tregohen të vetëdijshëm, përpjekjet e tyre në lidhje me zhvillimin shpirtëror të fëmijës nuk kanë për të shkuar dëm.

Disa prindër janë shumë të dhënë pas fëmijëve, nuk ua prishin qejfin për asgjë, duke ua plotësuar të gjitha dëshirat me vend dhe pa vend. Një veprim i tillë e dëmton rëndë procesin e tyre të edukimit. Fëmijët që edukohen në këtë mënyrë, zhvillojnë një karakter kapriçioz dhe duan t'u plotësohet çdo dëshirë. Kur rriten, bëhen kryeneçë dhe nuk u binden prindërve.

Disa prindër të tjerë e teprojnë në disiplinë dhe nuk u japin aspak liri fëmijëve të tyre. Ata nuk tolerojnë që fëmijët e tyre të flasin qoftë edhe kur kanë nevojë për diçka. Në raste të tilla, edhe pse fëmija duket i bindur, ndonjëherë ai pëlçet dhe ngre krye duke kryer veprime që mund ta dëmtojnë edhe vetë atë. Prandaj, ashtu si për çdo gjë, edhe në edukimin e fëmijëve duhet ndjekur një rrugë mesatare.

Prindi duhet të jetë shembull për fëmijët e tij në çdo çështje. Nëse nga një anë e këshillon fëmijën për diçka dhe nga ana tjetër bën të kundërtën pranë fëmijës, këshilla e tij nuk do ketë asnjë lloj efekti pozitiv.

Kur fëmija mbush shtatë vjeç, me një metodë të ëmbël dhe të lehtë, duhet mësuar të marrë abdes dhe të falë namaz. Kur arrin moshën dhjetë vjeçare, duhet të nxitet që të falë namazin rregullisht. Gjithashtu, atij duhet t'i mësohen në mënyrën e duhur edhe hallallet dhe haramet.

Në lidhje me shkollimin e fëmijëve tanë, duhet të zgjedhim shkollat që në programin e tyre mësimor kanë edhe lëndët fetare, siç janë medresetë. Fëmijët që edukohen në këto shkolla, kanë më shumë mundësi të rriten larg veseve të këqija dhe injorancës ndaj besimit islam. Si rrjedhojë, çfarëdo universiteti që të ndjekin më vonë, do të kenë më shumë mundësi për të arritur suksese. Të udhëzuar nga besimi dhe morali islam, ata do të jenë të dobishëm për veten, prindërit e tyre dhe të gjithë shoqërinë.



MENDIMI DHE FIRASETI

Prof. Dr. Ismail Lutfl Çakan

Ebu Said Hudriu, (r.a.), transmeton se i Dërguari i Allahut, (a.s.), ka thënë:

"Kini frikë nga firaseti i besimtarit, sepse ai shikon (vlerëson) me dritën e Allahut." Pastaj lexoi këtë ajet: **"Pa dyshim se në këto argumente dhe shenja, ka shumë mësim bindëse për ata që i kuptojnë."**¹

FIRASETI

Fjala firaset, sipas kuptimit terminologjik të saj në fenë islame, do të thotë të kuptosh të vërtetën e fshehur pas së dukshmes, të bësh parashikime (logjike) të vlefshme në lidhje me të ardhmen dhe t'i vlerësosh ngjarjet brenda kornizës së shpjalljes hyjnore (Kuranit-Sunetit), duke bërë komente të sakta dhe të ndryshme nga të gjithë. Fjala "mu'min / besimtar" që përmendet në hadith, do të thotë "mu'minu'l-kamil / besimtar i pjekur". Allahu Teala e ndan besimtarin e pjekur nga të tjerët me nurin e besimit që ka dhe i shfaq atij disa të fshehta. Dijetarët shpirtërorë janë dëshmitarët e Allahut në tokë. Paralajmërimi: *"Kini frikë nga firaseti i besimtarit!.."* – është kuptuar si: "Qëndroni larg mëkateve, sepse besimtari i pjekur arrin t'i kuptojë ato

që keni bërë. Pastaj turpërohni përpara tij." Firaseti është aftësia për të konkluduar, për të dalë shpejt, pothuajse në mënyrë intuitive, në lidhje me karakterin, fjalët, sjelljet, moralin, virtytin dhe ligësitë e njeriut. Këtë përkufizim e mbështesin edhe këto dy ajete:

"Pa dyshim se në këto argumente dhe shenja, ka shumë mësim bindëse për ata që i kuptojnë."²

"(Lëmosha) u takon të varfërve, të cilët kanë hyrë në rrugën e Zotit e nuk janë në gjendje të udhëtojnë (për të fituar). Kush nuk i njeh ata, kujton se janë të kamur, për shkak se ata nuk lypin. Do t'i njohësh nga pamja e tyre. Ata nuk i mërzhisin njerëzit duke lypur. Çdo gjë që shpenzoni prej të mirave, Allahu i di ato."³

Ndërsa pjesa tjetër e hadithit: *"Sepse ai shikon (vlerëson) me dritën e Allahut."* – do të thotë: "Besimtari është i ndriçuar me nurin e Allahut Teala dhe shikon me syrin e zemrës." Për këtë arsye, ai që i ruan sytë nga harami, që e frenon nefsën nga epshet, që e kontrollon zemrën dhe kujdeset të hajë vetëm hallall, e forcon firasetin, madje e pakëson shumë mundësinë për të gabuar. Nëse nuk bëjmë kujdes ndaj këtyre, drita e zemrës shuhet. Allahu Teala në Kuran thotë:

“...Ai, të cilit Allahu nuk i jep dritë, nuk do të gjejë më dritë.”⁴ Ky ajet fisnik e vërteton dhe e saktëson këtë që u tha më lart.⁵ Edhe i Dërguari i Allahut, (a.s.), duke u shprehur në hadithin e mësipërm se ndërmyjet nurit të Allahut Teala dhe firsasetit ka një lidhje të drejtpërdrejtë e të fortë, na ka treguar për burimin e firsasetit. Nisur nga kjo, firsasetin mund ta kuptojmë dhe mund ta përkufizojmë si një mirësi që Allahu Teala ia jep besimtarit për shkak të përsosmërisë që ka në besim.

SHENJAT E BESIMIT TË PËRSOSUR

I Dërguari i Allahut, (a.s.), në një hadith fisnik që transmetohet nga Ebu Umame Bahili, (r.a.), i ka shpjeguar kështu gjërat që një besimtar duhet të bëjë për ta përsosur besimin e tij: *“Besimtari që do për hir të Allahut, që zemërohet për hir të Allahut, që jep për hir të Allahut dhe që nuk jep për hir të Allahut, e ka përsosur besimin e tij.”⁶* Sipas këtij hadithi fisnik, shenjat e pjekurisë/përsosmërisë së besimit janë: Atë që e do dhe e përvetëson, atë që e urren dhe atë që e refuzon, atë që jep dhe atë që s’e jep, t’i bësh vetëm për Allahun Teala (lillahi). Veprat e përmendura në hadith janë përmendur pa i konkretizuar me ndonjë gjë. Në këtë mënyrë, është lënë hapur dera e komentimit për çdo temë.

Ai që e do dikë, për shkak të besimit dhe nënshtrimit që ka ndaj Allahut, zotëron shenjën e parë më rrënjësore dhe shpirtërore që vërteton përsosmërinë e besimit të tij. Po ashtu, edhe ai që e urren ndonjë njeri apo ndonjë send, jo për ndonjë shkak personal, por për shkak se bie ndesh me vlerat e besimit, ka arritur shenjën e dytë shpirtërore të përsosmërisë në besim. Nga ana tjetër, ata që u japin të tjerëve me gjithë shpirt, jo për ndonjë interes, por vetëm ngaqë e meritojnë dhe me vetëdijen **“Ne ju ushqejmë vetëm për hir të Zotit. Për këtë, nuk duam shpërblim e as falënderim!”⁷** dhe ata që nuk u japin disa të tjerëve, jo për shkak të ndonjë dëmi apo të keqeje, por ngaqë vlerat e besimit e kërkojnë këtë, do të thotë se zotërojnë dy shenja bazë të sjelljes në përsosmërinë e besimit të tyre.

Pas këtij hadithi fisnik, që nxjerr në pah shenjat e përsosmërisë në besim, nga aspekti i tërësisë së temës do të ishte e dobishme të transmetonim edhe këtë hadith kuds, që shpjegon se besimtari “shikon (vlerëson) me nurin e Allahut”. Transmetohet nga Ebu Hurejra, (r.a.), se i Dërguari i Allahut, (a.s.), ka thënë: *“Allahu Teala ka*

thënë: ‘Kush i shpall luftë një miku Tim (që më adhuron me sinqeritet), edhe Unë i shpall luftë atij. Robi Im nuk mund të më afrohet Mua me ndonjë gjë më të dashur se ato që ia kam bërë farz. Pastaj ai më afrohet me ibadete nafle aq sa ta dua atë. Kur ta dua atë, bëhem veshi i tij që dëgjon, syri i tij që shikon, dora e tij që mban dhe këmba e tij që ecën. Nëse kërkon diçka nga Unë, patjetër që ia jap. Nëse kërkon që ta mbroj nga ndonjë gjë, patjetër që e mbroj nga ajo.”⁸

Ky hadith kuds tregon se firsaseti ka lidhje më shumë me mendimin dhe jetesën që si prioritet kanë shpalljen hyjnore, sesa me mendjen, mendimin, përvojën dhe specializimin. Këtë mund ta quajmë edhe si vendosje të shpalljes hyjnore, Kuranin dhe Sunetin përpara mendjes. Ky parim është burimi i “firsasetit të besimtarit”, që përmendet në hadithin fisnik. Vlerësimi i ngjarjeve me nurin e Allahut, është rezultat i shpalljes hyjnore të cilës i jepet prioritet. Ndërsa për ata që i japin prioritet mendjes ndaj shpalljes hyjnore, është e qartë se ngelin larg nga kjo thellësi. Edhe fjalët e Abdullah ibn Mes’udit, (r.a.), janë shumë domethënëse në lidhje me temën tonë. Një ditë, myslimanët i kishin bërë shumë pyetje Ibn Mes’udit (r.a.), në lidhje me shumë çështje. Ai, (r.a.), ishte përgjigjur:

“E vërteta është kjo: “...Kur ndonjëri prej jush të përballet me një çështje, le të kërkojë zgjidhje për të në ajetet e Kuranit. Ai që përballet me një çështje që nuk ka zgjidhje në librin e Allahut, le ta zgjidhë duke para Sunetin e të Dërguarit të Allahut (a.s.). Ai që përballet me një çështje që nuk ka zgjidhje në librin e Allahut dhe në Sunetin e Hz. Pejgamberit (a.s.), le të përpiket ta zgjidhë çështjen duke parë fetvatë e dijetarëve. Ai që përballet me një çështje që nuk ka zgjidhje në Kuran, në hadithe dhe në fetvatë e dijetarëve, le të bëjë ixhtihad, duke përdorur mendjen e tij. Askush të mos thotë se ka frikë të bëjë ixhtihad, sepse hallalli është i qartë dhe harami është i qartë. Ndërmjet hallallit dhe haramit ka çështje të dyshimta. Atëherë, lëre atë që dyshon dhe merr atë që nuk dyshon.”⁹

Veçanërisht prijësit e xhematëve, liderët, dijetarët shpirtërorë, shkencëtarët dhe administruesit që kanë influencë të shoqëria, duhet të kenë më shumë kujdes se kë marrin për bazë dhe i japin prioritet në zgjidhjet dhe orientimet e tyre. Dhënia përparësi zgjidhjeve me prioritet shpalljen hyjnore, që nga çështjet ditore të

Ai që e do dikë,
për shkak të besimit
dhe nënshtrimit
që ka ndaj Allahut,
zotëron shenjën e parë
më rrënjësore dhe shpirtërore
që vërteton përsosmërinë e besimit
të tij. Po ashtu, edhe ai që e urren
ndonjë njeri apo ndonjë send,
jo për ndonjë shkak personal,
por për shkak se bie ndesh
me vlerat e besimit,
ka arritur shenjën
e dytë shpirtërore
të përsosmërisë
në besim.

cilat nënvlerësohen e deri te marrëdhëniet ndërko-mbëtare, nxjerr në pah dimensionin e mendimit të një myslimani të mirë dhe të pjekur. Ndërsa veprimi me këto zgjidhje dhe preferenca, nxjerr në pah dimensionin e sjelljes së myslimanit të pjekur. Besimtari i pjekur apo myslimani që zotëron firaset, është një burrë besimtar që e di se, nëse vepron me bindje personale, fatkeqësi-të e mëdha i ka në prag të derës. Po ashtu, e di se, nëse e zbaton Kuranin dhe Sunetin, domethënë, nëse vepron me mendime që i japin prioritet shpalljes hyjnore, këto lloj fatkeqësish do të qëndrojnë larg tij.

Prioriteti ndaj mendimeve personale, në shumë çështje e zvarrit njeriun në shqetësime serioze dhe në pendime të thella, edhe pse në fillim duket si diçka e lehtë. Madje, ky veprim është shumë i vështirë për t'u rregulluar dhe shkakton pasoja të rënda. Për këtë arsye, është e qartë se të gjithë kemi nevojë për një jetë në të cilën mendimi, besimi dhe veprimi i japin prioritet shpalljes.

Sehl b. Hunejfi, (r.a.)¹⁰ (v. 38.), nuk i pati dalë kundër vendimit të gjykatësit në luftën e Siffinit, që ndodhi ndërmjet Hz. Aliut dhe Muavijes në vitin tridhjetë e gjashtë hixhri. Për këtë arsye, pati prej atyre që e kritikuan për sjellje të keqe. Sehl u dha këtë përgjigje këtyre kundërshtimeve: "O njerëz! Vetën dhe mendimin tuaj testojeni me fenë (mos veproni sipas mendimeve personale)! Kur Ebu Xhendeli iu dorëzua mushrikëve në Hudejbije, sikur të kisha fuqi, isha i vendosur në mënyrë absolute për ta refuzuar vendimin e të Dërguarit të Allahut. (Por atë ditë, siç e mbajta veten për të mos i dalë kundër vendimit të të Dërguarit të Allahut edhe në këtë luftë nuk po luftoj kundër vendimit të gjykatësit, duke menduar për të mirën e myslimanëve.) Në çdo ngjarje të dhimbshme që kemi rrokur shpatat, ato na i kanë bërë më të lehta rezultatet që i shikonim si të drejta. Kjo ka vetëm një përjashtim. Ky përjashtim është ngjarja e Siffinit. Lufta e Siffinit nuk është as brengosëse dhe as e keqe."¹¹

Sehl b. Hunejfi, (r.a.), i cili ishte prej komandantëve të Hz. Aliut (r.a.), me këto që tha, tregoi se myslimanët në Hudejbije e vendosën shpalljen përpara mendjes dhe në këtë mënyrë, arritën në një fund të lumtur. Po ashtu, thekson se në çdo ngjarje që kanë rrokur shpatat, nuk janë penduar, ngaqë gjithmonë i kanë dhënë prioritet shpalljes hyjnore. Ai shpjegon se kjo mënyrë veprimi ka vetëm një përjashtim, i cili është lufta e Siffinit. Kështu e mbron veten duke pohuar se kundërshtimi i zgjidhjes

që u dha në luftën e Siffinit dhe veçanërisht i vendimit të gjykatësit, është dhënie e prioritetit jo ndaj shpalljes hyjnore, por ndaj mendjes dhe mendimeve personale. Si rezultat, ndodhën gjëra që nuk duhet të ndodhnin. Për këtë arsye, ai e pranoi vendimin e gjykatësit dhe në këtë nuk shikon kurrë ndonjë mangësi në detyrë.

Në një transmetim tjetër, sipas asaj që thotë Sehl, (r.a.), ajo që e zemëroi Umerin (r.a.), ishin nenet e marrëveshjes së Hudejbijes, që ndodhi në ngjarjen e Ebu Xhendelit dhe veçanërisht kthimi prapa i myslimanëve atë vit pa e vizituar Qaben. Hz. Umeri shkoi te i Dërguari i Allahut, (a.s.), dhe reagoi:

"A nuk jemi ne në të vërtetën? A nuk janë mushrikët në të gabuarën? A nuk janë në xhenet ata që vdesin prej nesh dhe në xhehenem ata që vdesin prej tyre? A do të kthehemi prapa pa gjykuar Allahu ndërmjet nesh dhe atyre?" I Dërguari i Allahut (a.s.), iu përgjigj:

"Unë jam i Dërguari i Allahut! Allahu kurrë nuk më humb dhe nuk më turpëron!" Në këtë mënyrë, i tregoi Hz. Umerit se ngjarja duhej të shihej thellë dhe duke i dhënë prioritet shpalljes. Pastaj Hz. Umeri (r.a.), shkoi te Hz. Ebu Bekri (r.a.) dhe reagoi në të njëjtën mënyrë, por edhe Hz. Ebu Bekri iu përgjigj si i Dërguari i Allahut (a.s.).¹²

Nga kjo ngjarje kuptohet qartë se mendimet personale duhet të testohen me parimet fetare. Edhe i Dërguari i Allahut, (a.s.), ka thënë: "Askush prej jush nuk mund të bëhet besimtar i pjekur derisa ndjenjat dhe dëshirat të mos pasojnë atë që kam sjellë!"¹³

Besimtari i pjekur apo myslimani që zotëron firaset, është një burrë besimtar që e di se, nëse vepron me bindje personale, fatkeqësitë e mëdha i ka në prag të derës.

Referencat:

- 1) Tirmidhi, Tefsiru sure 15, 6; Tuhfetu'l-ahvazi, VIII, 554-557, hadithi nr: 3333.
- 2) Sureja Hixhr, 15/75.
- 3) Sureja Bekare, 2/273.
- 4) Sureja Nur, 24/40.
- 5) Munavi, Fejzu'l-kadir, I, 142-143.
- 6) Ebu Davud, Sunnet 15; Tirmidhi, Kijame 60; Ahmed b. Hanbel, Musned, III, 438, 440. Ahmed b. Hanbeli dhe Tirmidhiu këtë hadith e kanë transmetuar nga Muadh b. Enesi me shtojcën, "që marton për hir të Allahut e ka përsosur besimin e tij". Mbi të gjitha, Tirmidhiu e vlerëson hadithin si "hasen".
- 7) Sureja Insan, 9.
- 8) Buhari, Rikak 38.
- 9) Nesai, Kaza 11. Këtë transmetim, Nesai e ka vlerësuar "xhejjid, xhejjid".
- 10) Për informacion rreth jetës së tij, shik. Dhehebi, Sijer, II, 325-329.
- 11) Shik. Buhari, I'tisim 7, Xhizje 18.
- 12) Kjo sjellje në Hudejbije e Hz. Umerit (r.a.), i cili njihej me mendimet dhe vlerësimet e tij të sakta, është rezultati i dhënies përparësi të mendimit personal të një momenti. Ai, të njëjtin reagim e pati bërë edhe kundër halifes, Ebu Bekrit (r.a.), i cili vendosi të luftojë me murdetë në fillimin e ngjarjeve të riddes. Por në të dy rastet, pasi iu kujtua nga Ebu Bekri e vërteta e shpalljes, hoqi dorë nga mendimi i tij dhe iu dorëzua shpalljes hyjnore.
- 13) Begavi, Mesabihu's-sunneh, I, 60; Nevevi, Dyzet Hadithe, Hadithi nr: 41.

Lutja

Fatma Dilek

Ekonomia është “përballimi i nevojave të pafundme me burime të kufizuara”. Ne kemi mundësi që nevojat e pafundme t’i përballojmë me një burim të pakufishëm. Lutjen. Lutje do të thotë që njeriu t’ia shfaqë nevojat e pafundme Allahut (xh.xh.), i cili ka thesare të pafundme dhe të kërkojë ndihmë nga Ai. Faktikisht dermani është vetë lutja.

Lutja është një gjendje vetëdijeje e lartë. Lutja është pranimi i ekzistencës së një Qenieje e cila, në të vërtetë, e di më mirë nga ne se për çfarë kemi nevojë dhe e cila ka vullnetin dhe fuqinë për të na dhënë. Lutja është mënyra më e sigurtë që tregon se sa shumë nevojë kemi për Allahun e Lartmadhëruar.

Njeriu, i cili zotëron paaftësi dhe nevoja të pafundme, është shumë e rëndësishme ta dijë se Allahu Teala ka fuqi dhe bujari të pafundme. Meqë çdo gjë njihet nga e kundërta e saj edhe fuqinë dhe bujarinë e Allahut të Madhëruar mund ta konceptojmë duke njohur dobësinë dhe nevojat tona. Kjo, më së miri, arrihet me lutje.

A jemi të vetëdijshëm se kujt i drejtohem kur lutemi? A jemi koshientë se thesaret e Tij (xh.xh.), nuk pakësohen duke na dhënë për nevojat tona dhe se për Atë nuk ka vështirësi? Për këtë arsye, aq sa e ka të lehtë Allahu i Madhëruar për të dhënë një lule, aq e ka të lehtë për të dhënë edhe xhenetin. Ndërmjet krijimit të një milingone dhe tubimit të të gjithë njerëzve në mahsher, nuk ka ndonjë ndryshim.

Nëse ka diçka që nuk duhet të mjaftohemi me të, ajo është lutja. Lutja nuk bëhet me logjikën që të kërkojmë pak, në mënyrë që të na jepet. Madje, sa më shumë të kërkojmë, aq më shumë kënaqet Allahu Teala. Kjo tregon se ne i perceptojmë emrat e bukur të Zotit (xh.sh.), si “Mutekebbir (Ai që shfaq madhështinë e Tij në çdo gjë dhe në çdo ngjarje), Kadir (Ai që i mjafton fuqia për të bërë atë që dëshiron dhe si të dëshirojë)”.

Sa mirësi të madhe që na paska dhënë Allahu Teala, por ne nuk e paskemi ditur. Neve na thuhet: “Kërkoni! Kërkoni çdo gjë brenda kornizave të hallallit! Mos

hezito! Mjafton të kërkoni nga Unë.” Kur kërkojmë nga njerëzit, Allahu Teala largohet prej nesh. Kur kërkojmë nga Allahu (xh.sh.), Ai na afrohet.

Thuhet se kur ngelim në gjendje të vështirë, kur jemi të pafuqishëm dhe kur jemi të dobët, ka ardhur koha e lutjes. Nisur nga kjo, koha e lutjes është një kohë që s’kalon asnjëherë. Koha e lutjes është çdo moment që marrim frymë. Nëse Allahu i Madhëruar nuk lejon, ne nuk mund të japim as frymën që kemi marrë.

Hz. Aliu, (r.a.), ka thënë: “Unë e kam njohur Allahun Teala me mosplotësimin e dëshirave të mia.” Nëse kështu ka thënë Hazreti Aliu (r.a.), i cili është drita e syve të të Dërguarit të Allahut (a.s.), çfarë na ka ndodhur ne që nxitojmë kaq shumë? Mosplotësimi i dëshirave tona apo plotësimi i tyre në një formë të ndryshme, janë një shkak që na njoftojnë për Allahun Teala. Çfarë mund të ketë synuar vallë Hazreti Aliu (r.a.), me këtë fjalë? Ndoshta ka pasur për qëllim këtë: Sikur të kisha arritur çdo gjë që dëshiroja, ndoshta do pandehja se arrihen si rezultat i vetes sime apo si realizim i shkaqeve. Atëherë, nuk do kapesha pas Krijuesit të shkaqeve, por pas shkaqeve, gjë e cila është gabim i madh. Nëse Allahu Teala nuk jep leje, nuk do të kishte ndonjë rezultat, edhe sikur të realizoheshin të gjitha shkaqet apo të mblidheshin të gjitha krijesat për të bërë ndonjë gjë. Por, nëse Allahu dëshiron të bëhet diçka, atë nuk mund ta ndalojë asgjë edhe sikur të gjitha krijesat të mblidheshin dhe të përpiqeshin ta pengonin.

O Zot! Ti je halli dhe dermani ynë. O Zot! Ne nuk kemi tjetër përveç Teje! Nuk ka derë tjetër që mund të trokitet përveç derës Tënde! Dera jote e mëshirës nuk mbyllet asnjëherë. Ti thua: “Urdhëro robim!” Ne themi: “Amin!” Ti thua: “O robim!” Ne themi: “O Zot! Ne bëjmë mëkate, por përsëri te Ti kthehem!”

Përveç të gjithash, lutja është një komunikim me të Dashurin (Zotin) dhe një gjendje në të cilën jemi më të sigurtë në gjetjen e vetvetes.

أَلَيْسَ بَدِيًّا فِي الْوَجْهِ كَوْنُ الْقَلْبِ يُعْقَلُ بِهِمَا

SHIKIME

TË NDRITSHME

Perceptime të thella

Dr. Adem Ergyl

Ka një fjalë të urtë, që thotë: "Të shohësh më tutje tri dredhive". Kjo fjalë shpreh se më tutje asaj që duket, ka edhe të vërteta të tjera dhe se aftësia e vërtetë është të ndjerit dhe të perceptuarit e tyre. Përpjekja për të kuptuar se çfarë mund të ketë pas ngjarjeve që ndodhin dhe vlerësimi i së djeshmes, të sotmes dhe të nesërme bashkë me to, më shumë është një çështje horizonti se sa një shikim momental dhe ditor. Madje, përpjekja për të kuptuar botën e padukshme, e cila është përtej botës së dukshme, të perceptosh të përkohshmen, provizoren e të përhershmen dhe të kesh një kuptim e konceptim të jetës sipas tyre, është mençuri, mendjemprehtësi, largpamje, maturi dhe urtësi. E kundërta e kësaj, është budallallëku, madje verbëria. Në Kuranin Fisnik thuhet se verbëria e vërtetë është verbëria në perceptim dhe largpamësi. Allahu Teala thotë:

"(O Pejgamber!) **Vallë, a nuk kanë udhëtuar ata nëpër botë** (ata që të kundërshtojnë), **që zemrat e tyre të mendojnë dhe veshët të dëgjojnë? Në të vërtetë, atyre nuk u janë verbuar sytë** (në këto gjëra), **por u janë verbuar zemrat që kanë në kraharor.**" (Haxhxh, 46)

Të menduarit përmendet rreth pesëdhjetë herë në Kuranin fisnik. Kur t'i shtjellojmë me vëmendje këto ajete, do të vëmë re se funksioni i mendimit të zemrës përdoret në çështjet, si në shikimin e

argumenteve që përgjithësisht ndodhen në univers, në kuptimin e ajeteve të shprehura me fjalë,¹ në të ndjerit e mendimeve dhe sjelljeve të palogjikshme,² në konceptimin e gjërave të paditura, duke u nisur nga të vërtetat e njohura³ dhe në marrjen e mësimit nga ngjarjet e përjetuara.⁴

Funksioni i mendimit për njeriun ka një rëndësi shumë të madhe. Nëse dikujt i humb kjo cilësi, do të thotë se ka rënë në pozitën e të qenit krijesa më e keqe që ecën mbi tokë.⁵ Sepse sipas deklaramit të Kuranit Fisnik, të mosmenduarit është shkak i kryesor i femohimit dhe ndyrësisë së shirkut, që e propozin njeriun në errësirën e injorancës në këtë botë të të vërtetave dhe e hedhin në gropën e xhehenemit në Ahiret.⁶

Ndërsa koncepti i largpamësisë, që shprehet si "syri i zemrës", është një fjalë arabe e ardhur nga rrënja "basar /shikim" dhe do të thotë "të shohësh, të ndjesh dhe sy"⁷. Në përgjithësi përkufizohet si "fuqia e perceptimit të së vërtetës së ekzistencës materiale dhe shpirtërore të zemrës së ndriçuar me dritën e shenjtë"⁸. Xhurxhani (v.816/1413), thotë se filozofët e kanë quajtur këtë fuqi të zemrës "kuvvetu'l-kudsijeh" ose "kuvvetu'n-nadharijeh"⁹.

Koncepti i largpamësisë në Kuranin Fisnik, kur

bëhet fjalë për njeriun, në përgjithësi është përdorur në kuptimin “të shikosh”, veçanërisht “të zbulosh të vërtetat, të njohësh rrugën e drejtë, të ndash të vërtetën nga e gabuara dhe aftësia për të marrë mësim”¹⁰ dhe në shumicën e rasteve është shfaqur si e kundërta e “verbimit shpirtëror” dhe e “devijimit”.¹¹

Mistikët pranojnë se sikundër dy syve që njeriu ka në trup e me të cilët shikon botën e jashtme, edhe zemra ka një sy që shikon botën e padukshme dhe këtë e quajnë “ajnun’l-kalb / syri i zemrës”, “dide-i xhan / syri i shpirtit” dhe “marifet gëzy / syri i marifetit”. Siç shikon syri që kemi në trup krijesat, ngjarjet, ngjyrat dhe format në botën materiale, edhe syri i zemrës shikon anën e brendshme të gjërave e të ngjarjeve në botën e jashtme dhe të vërtetat në botën shpirtërore.

Syri në trup gjendet te njerëzit dhe te kafshët, por syri i zemrës i përket vetëm njeriut. Syri i zemrës është funksional te çdo njeri. Edhe pse ky sy është i hapur te disa që nga lindja si një dhuratë e Allahut Teala, ai shpeshherë mbulohet nga perdja e ndjenjës. Prandaj, ai duhet të hapet me përpjekje. Disa njerëzve u hapet shpejt syri i zemrës, ndërsa disa të tjerëve u hapet vonë. Edhe atyre që u është hapur largpamësia, kanë grada të ndryshme në shikimin e të vërtetave përtej shqisave. Siç mund të gabojë në shikim syri i trupit, mund të gabojë edhe syri i zemrës. Syri i zemrës mund të shohë plotësisht apo mangët sipas gradës së pastërtisë që zotëron.¹²

Syri i zemrës në misticizëm ka qaq shumë rëndësi, sa që vlera e njeriut pothuajse matet me të. Kjo fjalë e Mevlanës Xhelaleddin Rumi (v.672/1273) është shumë e njohur: “Njeriu është sy, pjesa tjetër është vetëm lëkurë. Ndërsa sy quhet vetëm ai që sheh Mikun, domethënë, Allahun Teala.”¹³

Ajetet në Kuranin Fisnik, që flasin për njerëzit largpamës (ulu’l-besar), që ua zbulojnë fytyrën e vërtetë sendeve e ngjarjeve dhe marrin mësimin e nevojshëm nga ato sikundër atyre që kanë sy e veshë, por që nuk shohin e nuk dëgjojnë,¹⁴ tregojnë se njeriut i është dhënë fuqia për të zbuluar materialen dhe shpirtëroren. Edhe pse duket si e pamundur për

të arritur një rezultat të prerë në mënyrën e këtij të shikuari, mund të themi se kjo është një mënyrë perceptimi për të konceptuar të vërtetën e gjërave me një këndvështrim intuitiv të ndryshëm nga perceptimi i formuar si rezultat i mendimit dhe meditimit.


Po ashtu, duhet ta shprehim se ky shikim e ka të pamundur ta refuzojë mundësinë e një mënyre shikimi, që i ngjan shikimit të syrit të kokës kur shikon ëndërr.¹⁵ Ndërkohë që Kurani Fisnik tërheq vëmendjen nga njëra anë se ky lloj perceptimi mund të verbohet me sjellje të këqija,¹⁶ nga ana tjetër tregon se ai mund të zhvillohet me anë të devotshmërisë. Allahu i Madhëruar thotë:

“Nuk janë njësoj i verbëri dhe ai që sheh; as ai që beson e bën vepra të mira nuk është i barabartë me atë që bën keq. Sa pak që mendoni!”¹⁷ “O besimtarë! Nëse i frikësoheni Allahut, Ai do t’ju japë aftësinë e të gjykuarit drejt, do t’ju lirojë nga gjynahet tuaja dhe do t’ju falë. Allahu zotëron mirësi të madhe.” (Enfal, 29)

Këto dhe ajete të ngjashme me to, nxjerrin në pah qartazi se fuqitë e perceptimit burojnë nga zemra e njeriut dhe çdo ndryshim që ndodh në zemër, ndryshon edhe fuqitë dhe ndjesitë e perceptimit. I Dërguari i Allahut, (a.s.), duke u shprehur se besimi ia jep besimtarit këtë largpamësi dhe këtë aftësi për të ndjerë të fshehtën, thotë:

“Kini frikë nga largpamësia e besimtarit, sepse ai shikon me dritën e Allahut.”¹⁸ “Me daljen në pah të dritës hyjnore në shqisat e dukshme dhe të padukshme, njeriu arrin një vetëdije dhe konceptim më të lartë në dimensionet dhe distancat e ndryshme të perceptimeve. Sipas gradës që ka, arrin të fshehtat e ekzistencës, gjendjet shpirtërore, misteret e botëve të larta, madje të botëve të mëtejshme, arrin të kuptojë urtësitë e Zotit që shfaqen në këtë botë dhe së fundi, arrin të fshehtat e teuhidit.”¹⁹

Ky hadith fisnik tregon qartë se “largpamësia”, që ne e shprehim si “fuqia e të ndjerit dhe zbulimit”, ka lidhje me dritën hyjnore. Në lidhje me këto që thamë, edhe kjo fjalë e Ibn Kajjimit (v.751/1350) është shumë kuptimplote: “Largpamësia dhe mendjemprehtësia janë një dritë që Allahu Teala e ka hedhur në zemrën



e robit.”²⁰ Allahu Teala thotë: **“Pa dyshim se në këto argumente dhe shenja, ka shumë mësim bindëse për ata që i kuptojnë ato.”** (Hixhr, 75)

Fjalën “mutevessimin”, që përmendet në ajet, në përgjithësi komentuesit e Kuranit e kanë shpjeguar si “largpamësit”.²¹ Sipas njohësve të gnosës islame, largpamësia është shikimi i besimtarit me dritën e Allahut Teala. Siç thuhet edhe në hadithin fisnik, “Allahu bëhet syri i robit që sheh”.²² Sepse në këtë hadith fisnik që përmendëm, bëhet fjalë për këtë fshehtësi. I Dërguari i Allahut, (a.s.), transmeton këtë hadith kuds: *“Allahu Teala ka thënë: Kush i shpall luftë një të dashuri Tim edhe Unë i shpall luftë atij. Robi Im nuk mund të më afrohet Mua me ndonjë gjë më të dashur se ato që ia kam bërë farz. Pastaj, ai më afrohet me ibadete nafle aq sa ta dua atë. Kur ta dua atë, bëhem veshi i tij që dëgjon, syri i tij që shikon, dora e tij që mban dhe këmba e tij që ecën.”*²³ Nëse kërkon diçka nga Unë, patjetër që ia jap. Nëse kërkon që ta mbroj nga ndonjë gjë, patjetër që e mbroj nga ajo.”²⁴

Edhe pse duket si e pamundur për të arritur një rezultat të prerë në lidhje me atë se çfarë argumenton hadithi kuds, ata që kapen fort pas farzeve dhe nafleve, me një thënie tjetër, ata që i drejtohen devotshmërisë, kuptohet se arrijnë një përpikëri dhe thellësi të ndryshme me të tjerët në të dëgjuar, shikuar dhe perceptuar.

Hz. Jakubi, (a.s.), e ndjeu erën e këmishës së Jusufit (a.s.), që iu dërgua nga shumë kilometra larg dhe tha: **“...Unë, me të vërtetë, po ndiej erën e Jusufit, ndonëse ju mund të më quani matuf”** (Jusuf, 94) Kjo dhe disa histori të tjera të ngjashme me të, janë shumë interesante nga aspekti i dimensioneve të aftësive të njerëzve për të parë, dëgjuar dhe komentuar gjërat. Mevlana thotë: “Ndjenja në lidhje me dynjanë, është shkalla e kësaj bote. Duke u ngjitur nga këto shkallë, sigurojmë jetesën tonë.

Ndërsa ndjenja me fenë dhe gnosën, është shkalla e qiejve. Kjo shkallë na lartëson në jetën shpirtërore dhe bën të arrijmë gradën e vërtetë të njeriut. Ne kemi edhe pesë shqisa të tjera përveç atyre që i njohin të gjithë. Këto shqisa i ngjajnë floririt të kuq, ndërsa shqisat që i njohin të gjithë, i ngjajnë bakrit...” Kur drita hyjnore hyn

në sy dhe zemër, aty ndodhin ndryshime të mëdha. Sahabët e nderuar e pyetën të Dërguarin e Allahut, (a.s.): “O i Dërguari i Allahut! A zgjerohet kraharori?” I Dërguari i Allahut (a.s.), u përgjigj: “Po.” Pastaj shtoi: “Kur nuri (besimi) hyn në zemër, kraharori hapet.” Pastaj e pyetën: “O i Dërguari i Allahut! A ka ndonjë shenjë kjo?” Hz. Pejgamberi (a.s.), dha këtë përgjigje: “Shenja e kësaj është që besimtari nuk humbet në jetën e kësaj bote, e cila është një vend mashtrues, drejtohet nga bota e përhershme dhe përgatitet për vdekjen para se të ndodhë.”²⁵

Edhe në këtë ajet fisnik bëhet fjalë për këtë dritë hyjnore: **“A barazohet i vdekuri që Ne e ngjallëm dhe i dhamë dritë, me të cilën ecën midis njerëzve, me atë që është në errësirë e nuk mund të dalë prej saj? Kësisoj, jobesimtarëve u duken të bukura veprat që bëjnë.”** (En’am, 122)

Si përfundim, ne duhet t’i përgjrohemi Allahut të Madhëruar siç i është lutur edhe i Dërguari i Allahut (a.s.), në mënyrë që të arrijmë të shikojmë me “largpamësinë e besimtarit”, të arrijmë bindjen e plotë në besim dhe që të na e shtojë këtë dritë hyjnore: *“O Zot! Jepi dritë syrit dhe veshit tim! Më jep dritë në të djathtë, në të majtë, pas, para, lart dhe poshtë! Më jep dritë! O Zot! Jepu dritë damarëve, mishit, gjakut, flokëve, lëkurës, gjuhës dhe nefsit tim! Ma shto dritën dhe më bëj dritë!”*²⁶

Referencat:

- 1) Shik. Sureja Bekare, 164; Rra’d, 4; Nahl, 67; Rrum, 28.
- 2) Shik. Bekara, 44; Ali Imran, 65.
- 3) Shik. Junus, 16; Jasin, 62.
- 4) Sureja Haxh, 46.
- 5) Sureja Enfal, 22.
- 6) Sureja Junus, 100; Mulk, 10.
- 7) Ragib, Mufredat, s. 49; Asim Efendi, Kamus, II, 162.
- 8) Xhurxhani, Ta’rifat, fq. 46; Kashi, Istilahat, fq. 64; Abdulumun’im Hifni, Mu’xhem, 35.
- 9) Xhruxhani, Ta’rifat, fq. 46.
- 10) Sureja En’am, 25, 104; Taha, 96; Nur, 44; Dharijat, 21.
- 11) Sureja En’am, 104; Junus, 43; Hud, 24; Gafir, 58.
- 12) Ulludag, Sulejman, “Basiret”, Diyanet Islam Ansiklopedisi, 103.
- 13) Mesnevi, I, 107, bjt. 1405.
- 14) Sureja Ali Imran, 13; Nur, 44.
- 15) Siç dihet, ato që shihen në ëndërr, edhe pse u ngjajnë atyre që shihen me syrin e lirë, nuk shihen me syrin e vërtetë, por me një ndjenjë tjetër shikimi.
- 16) Araf, 198; Junus, 43.
- 17) Sureja Gafir, 58.
- 18) Tirmidhi, Tefsir, 15.
- 19) Muhammed Shuxhai, Makalat, I, fq. 157.
- 20) Medarixh, I, fq. 139.
- 21) Kurtubi, Tefsir, X, 29; Bejzavi, Tefsir, I, 534.
- 22) Kushejri, Risale, fq. 234-235; Ulludag, Sulejman, fq. 116.
- 23) Në disa transmetime është edhe shtesa: “Bëhem gjuha e tij që flet dhe zemra e tij që mendon.” (Shik. Ibn Haxher, Fet’hu’l-bari, XI, 344; Kastalan, Irshadu’s-sari, IX, 289.
- 24) Buhari, Rikak, 38.
- 25) Për këtë hadith dhe përr rrugët e ndryshme që është transmetuar, shik. Taberi, Xhamiu’l-Bejan, VIII, fq. 36-37.
- 26) Tirmidhi, Deavat, 30.



TË PËRFITOSH NGA IBADETI

Rabla Christine Brodbeck

Me ardhjen në këtë botë të Zotërisë së Gjithësisë, Hz. Muhamedit (a.s.), është manifestuar njëkohësisht përsosmëria e dashurisë, e vërteta e mëshirës hyjnore dhe afiniteti hyjnor. A. Jusuf Aliu, në tefsirin e Kuranit Famëlartë, bën një shpjegim të tillë: "Nuri islam është mundësia më e madhe si begati. Nëse do të arrijmë ta kuptojmë, do të krenohemi me të." "Nuri që është dërguar me Hz. Muhamed Mustafanë, ndriçon të gjithë ata që kanë merituar të jenë pjesë e shoqërisë së tij universale." Nëse njeriu nuk do ta ndjekë nurin e Islamit, nuk mund të arrijë të shijojë përsosmërinë e fesë dhe nuk mund të mbërrijë në shkallën e të qenit i mahnitur. Nëse njeriu nuk e jeton traditën profetike, nëse nuk e organizon jetën sipas haditheve, nuk mund t'i jepet siguri lidhur me të qenit pjesë e ymetit.

Tradita profetike përfaqësohet nga tradita etike më sublime e fesë islame. Sheriati përfaqëson të gjithë themelin e veprimtarisë së të qenit rob i Zotit. Brenda saj gjendet pasuria e brendshme e fesë islame. Sheriati nuk është i ndryshëm nga Pejgamberi (a.s.), i cili e solli

atë. Atëherë kur Pejgamberi (a.s.), nderoi botën me praninë e tij, bota u dritësua dhe Zotëria ynë tha: "Unë u dërgova që të përsos moralin e mirë." Sheriati që u dërgua bashkë me të është përforcuar me etikën e vullnetit, fjalët dhe të gjithë praktikat. Të gjitha kushtet e fesë, që janë të nevojshme të kryhen, në fakt janë pors një pasqyrë e drejtuar nga Resulullahu (a.s.). Ato pasqyrojnë nurin e edukatës së tij, si dhe bartin nga mëshira e pafundme e tij dhe nga vetëdija e robërisë së tij. Pejgamberi (a.s.), ka ardhur që të përsosë moralin e bukur dhe është bërë mbreti i Sheriatit. Ai është burimi i vetëm i nurit që ndriçon krijesat e botës. Mrekullia më e madhe e gjallë, që ka pasur e tërë bota është *moral muhamedan* i Pejgamberit (a.s.). kurse mrekullia më e madhe e Pejgamberit (a.s.), është Kurani Famëlartë. E vërteta e Fjalës Hyjnore kurrë s'mund të jetë e pavarur nga Pejgamberi, të cilit i është shpallur ajo, pasi ai (a.s.), ishte "Kuran i gjallë". Mrekullia më e madhe që ka krijuar Zoti i Madhëruar nuk është asgjë tjetër veçse e vërteta *muhamedane*, që shfaqet përmes moralit

profetik. Pejgamberi ynë (a.s.), ka thënë: “Unë u dërgova që të përsos moralin e mirë.” (Muvatta, Husnul-Khuluk, 8; Ahmed b. Hanbel, 2/381.). *Siratul-mustekim* është një rrugë e ndritshme. Ajo është rruga e cilësive dhe emrave të Allahut të Madhëruar. Ajo është “*Rruga muhamedane*” dhe përfaqëson “*moralin muhamedan*” të Pejgamberit tonë të dashur (a.s.). Ajo është rruga që të çon drejt Xhemalit dhe Kemalit të amëshueshëm të Zotit. Ndonëse Pejgamberi (a.s.), kishte statusin më të lartë që ka pasur ndonjë njeri ndonjëherë, i cili qe krenaria e Gjithësisë, ai sidoqoftë ishte njeriu më i thjeshtë nga njerëzit, më modesti.

Allahu i Madhëruar në Fjalën e Njesisë, të Dashurin e Tij e përmend edhe si rob edhe si resul. “Është robi dhe i dërguari i Tij”. Përmendja e profetësisë ngjitur me robërinë, nuk ka ndodhur që t’i jetë përmendur asnjë pejgamberi më parë. Fjala e Njesisë na tregon se baza e Islamit është e mbushur plot me thesarin e robërisë. Pejgamberi (a.s.), ka fituar statusin më të lartë përmes robërisë së tij dhe është bërë njeriu i vetëm që ka fituar statusin e të qenit i dashuri i Allahut. Ai është imami i të gjithë ibadeteve. Ai është imami i imamëve. Ai (a.s.), është pasqyra më e përsosur dhe më e mrekullueshme e Allahut. Ai është burimi i nurit. Ai është elementi i së vërtetës. Ai është trupëzimi i dashurisë së përsosur. Ai është kryeprofeti, mësuesi i gjithësisë, dielli i revelacionit dhe profetësisë, sal-lall-llahu alejhi ue slem! Kurani përfshin të gjitha shpalljet hyjnore të tjera. Ndaj dhe profetësia e Pejgamberit tonë (a.s.), është përmbyllëse, është vula e profetësive. E gjithë urtësia e Kuranit është akumuluar tek Pejgamberi ynë (a.s.), që do të thotë se Kurani shpjegon qenësinë (zat), cilësitë, gnosën, jetën, zemrën dhe moralin e Pejgamberit tonë të dashur (a.s.). Qenia e tij është përmbledhur me fjalët e Kuranit. Pejgamberi (a.s.), zotëronte të gjithë statuset e *irshad*-it. Në Kuran thuhet: “**Thuaju** (o Muhamed): **‘Nëse ju e doni Allahun, atëherë më ndiqni mua, që Allahu t’ju dojë dhe t’ju falë gjynahet! Allahu është Falës i Madh dhe Mëshirëplotë.’**” (Al’Imran, 31.) Ai është shembulli më i bukur për të gjithë njerëzimin dhe veçanërisht për ymetin e vet, si dhe ymeti i tij është ymeti më i përzgjedhur në mesin e të gjithë ymeteve të njerëzimit që kanë ardhur dhe që do të vijnë ndonjëherë.

Që të gjitha virtytet janë mbledhur tek ai njeri i begatë. Natyra, morali, bukuria dhe personaliteti i Pejgamberit (a.s.), janë shkaku pse Allahu krijoi gjithësinë dhe gjithçka çfarë mban brenda ajo. Zoti i botëve i është drejtuar të dashurit të vet (a.s.), duke i thënë: “*Sikur mos të ishte ti, nuk do të krijoja gjithësinë!*” Esenca e fesë islame është thesari i dashurisë; xheneti i miraxhit dhe i afinitetit janë mësimi më sublim i dashurisë për të gjitha kohët. Zeniti i dashurisë është miraxhi. Kjo gjendje ka arritur të realizohet përmes namazit.

Miraxhi është nuri hyjnor, është dhuntia hyjnore dhe përmbledhja e *moralit muhamedan*. Është pikërisht shija hyjnore që ka shijuar i Dërguari i Allahut, (a.s.), i cili thoshte: “*Në namaz më është dhënë drita e syrit.*” Begatia e namazit u dhurua në shenjë respekti të lutjes që natën e Miraxhit i bëri Pejgamberi (s.a.s), Zotit të Madhëruar. Sërish, si rrjedhojë e lutjes që ai bëri, do t’i bëjë shefat të gjithë ymetit në Ditën e Mahsherit. Në sajë të tij, mëshira dhe dhembshuria është përhapur në mbarë rruzullin tokësor. Me nurin e gnosës së tij (a.s.), i gjithë njerëzimi u bë organizma që përjetoi hallkat e Tevhidit që çelin lulet. Pejgamberi (a.s.), në mesin e njerëzve është njeriu më *dhakir*, më *shakir* dhe robi më i lartë. Robi më i lartë në këtë gjithësi është Pejgamberi ynë i dashur Muhamedi (a.s.), i cili mbarti në veten e vet fshehtësinë e përsosmërisë hyjnore mes Krijuesit dhe krijesave, robit dhe Zotit, robit dhe të Adhuruarit. Ai përfaqëson të vërtetën e Fatihë-së.

Ekziston një kusht hyjnor për ata besimtarë që duan të bëjnë ibadet të vërtetë; të tregosh dashuri të pafundme për njeriun që na solli më të lartin e ibadeteve! Pra, sa më shumë që ta duam Pejgamberin (a.s.), sa më shumë të kopjojmë moralin e bukur të tij, sa më shumë të përpiqemi që t’i ngjasojmë atij, sa më shumë të përpiqemi të dëgjojmë fjalët e tij dhe të mësojmë prej tyre, aq më shumë do të jemi brenda prehjes shpirtërore dhe çiltërsisë. Nëse do ta marrim shembull në namaz: Paramendon sikur një njeri kur fal namaz, të ndihet sikur po ngjitet në Miraxh... Këtë mund ta përjetojë vetëm atëherë kur t’i shprehë dashuri e respekt të Dërguarit të Allahut, (a.s.), i cili i dhuroi njerëzimit Sheriatin dhe dashurinë që ndjente për Allahun e Madhëruar. Sa më shumë që ta duam Pejgamberin tonë të dashur (a.s.), aq më shumë do të na ushqejë namazin tonë. Në varësi të përpjekjeve tona të sinqerta që do të shprehim për të ecur në rrugën e tij (a.s.), do të zbukurohet namazi dhe do të marrë jetë. Atëherë kur të jemi përpjekur që të mund të jemi pluhuri i këmbëve të tij, atëherë do të bëjmë sexhde më të vërteta. Sa më shumë që të jemi pjesëtarë të dhimbjeve të Pejgamberit (a.s.) dhe të shqetësimeve hyjnore të tij, sa më shumë të qajmë bashkë me të dhe të drithërohemi njëherazi, vetëm atëherë mund të meritojmë të shijojmë dhuntinë e të qenit pranë Rahmanurrahimit. Përderisa ai ka vendosur edhe jetën e vet për ne, edhe ne duhet t’ia tregojmë dashurinë që ndjelmë për të. Dashuria e vërtetë shprehet atëherë kur e marrim shembull atë, kur të gjitha ndjenjat, mendimet, ndjesitë, lëvizjet dhe veprat tona u ngajnë atyreve të tij. Shqetësimi i tij duhet të jetë edhe shqetësimi ynë. Shkurtimisht, edhe ne duhet të mund t’i ndajmë lotët, madhështinë, mërzinë, lumturinë e tij.



FORÇA E FJALËS

All Riza Temel

I Gjithëmëshirshmi ua ka mësuar Kuranin (robërve të Tij). Ka krijuar njeriun dhe i ka mësuar atij të folurit e qartë. (Rahman, 1-4)

Njeriu përkufizohet si "gjallesë që flet". Të flasësh do të thotë të përcjellësh tek bashkëbiseduesi një mesazh të caktuar. Fjala e Allahut është fjala më e saktë dhe më e bukur. Në krye të sures Rahman, Zoti flet se Ai ia ka mësuar njeriut Kuranin përpara se të pohojë se njeriu është krijuar, duke përmendur më parë atë që është më e rëndësishme. Kjo do të thotë se gjëja më kryesore është bashkëbisedimi i njeriut me Kuranin.

Krijimi i parë nisi me fjalën. Me fjalën *Bëhu* (Kun) dhe kështu u formësua çdo gjë. Në qoftë se nuk do të ekzistonte fjala, ne nuk do të dëgjonim dhe nuk do të dinim asgjë deri në përjetësi. Librat e Zotit përngajnë me tellallët që thërrasin me zë të lartë të vërtetat e Allahut të Lartmadhëruar. Profeti Muhamed (a.s.), i cili fliste fjalën më të bukur që mund të shpreh njeriu, pati thënë kështu për të shprehur forcën e fjalës: "*Disa fjalë janë si magji*" (Buhari, Tib, 51). Gjuha është më e mprehtë se tehu i shpatës, prandaj të vjetrit kanë thënë: "Plaga e shpatës shërohet, por plaga që krijon fjala nuk shërohet lehtë."

Fjala është armë. Muhamed Ikbali, njeriu i letrave dhe i zemrave, ka thënë: "Ky i ngratë ka një armë me

të cilën e sfidon botën. Ato janë dy fjalë: La ilahe ilallah, Muhamedun Resulullah!" Kjo fjali realizoi revolucionin më të madh në botë. Në sajë të kësaj fjalie u përmbyësën sa e sa idhuj. Kjo fjali ndryshoi shoqërinë, mendjet dhe zemrat e njerëzve. Për njerëzit e fuqishëm thuhet "të zotët e fjalës". Më sipër kemi shkruar se fjala është armë, e cila ashtu sikurse arma mund të përdoret edhe për mirë, edhe për keq.

Sa të bukura janë vargjet e poetit të famshëm, Junus Emre :

Ka fjalë që të fal qese me flori,

Ka fjalë që të fluturon kokën, o njeri!

Fjala e bukur u ka hije njerëzve me cilësi të bukura. "***Fjala e bukur është më e mirë se sadakaja që shoqërohet me fyerje.***" (Bekare, 263) "***Flituni njerëzve me fjalë të bukura.***" (Bekare, 83) "***O besimtarë, tregoni respekt ndaj Allahut dhe thoni fjalë të drejta.***" (Ahzab, 70) Profeti Muhamed (a.s.), ka thënë: "*Ai që beson te Allahu dhe te Dita e Kiametit, ose të flasë gjëra të mira, ose më mirë të heshtë.*" (Texhridi Sarih, hadith nr: 2023) Përdorimi negativ i gjuhës, siç janë thashethemet, gënjeshtat, mbartja e fjalëve, fyerja, mallkimi, përgojimi vijnë në krye të shkaqeve që e çojnë njeriun dhe shoqërinë në shkatërrim.

PAS BETEJËS SË HUNEJNIT

Dëshiroj të rikthej në vëmendjen tuaj një shembull që tregon efektin e një bashkëbisedimi të ngarkuar me sinqeritet, logjikë dhe ndjenja. Beteja e Hunejnit, zhvilluar kundër fiseve Hevazin dhe Sakit, në vitin e tetë të hixhretit, është njëra nga betejat në të cilat mori pjesë vetë profeti Muhamed (a.s.).

Fitorja përfundimtare u arrit në sajë të aftësisë dhe guximit të Profetit Muhamed (a.s.), për të rigrupuar sërish myslimanët, të cilët i kapi për një moment paniku nga sulmi i befasisëm i harkëtarëve të ushtrisë armike. Në përfundim të kësaj beteje, u mbledhën plaçka më e madhe e luftës që kishin mbledhur ndonjëherë myslimanët pas betejave që kishin zhvilluar më parë. Numri i robërve të luftës shkonte deri në gjashtë mijë vetë. Përveç tyre u kapën si plaçkë lufte edhe njëzet e katër mijë deve, dyzet mijë gjedhë dhe katër mijë okë argjend. Profeti ua shpërndau pjesën më të madhe të kësaj plaçke të luftës mekasve, që sapo ishin bërë myslimanë, duke dashur në këtë mënyrë t'ua ngrohte zemrat e tyre me Islamin.

Kjo bëri që disa ensarë të mërzhiteshin dhe të thoshin mes tyre: "Tani i Dërguari i Allahut e fitoi prapë fisin e tij kurejshë, prandaj nuk kanë ç' duhen të tjerët! Ai u jep atyre që nuk luftojnë dhe nuk u jep atyre që luftojnë. Kur mbetet ngushtë, na thërret neve ta ndihmojmë, por plaçkat e luftës ua jep kurejshëve."

Kur mësoi se çfarë përflitej mes tyre, profeti Muhamed (a.s.), shkoi pranë ensarëve dhe u tha:

- O ensarë! Çfarë janë ato fjalë që kam dëgjuar? A kam bërë ndonjë gjë që jua ka thyer zemrën? Kur erdha në mesin tuaj, ju ishit njerëz që e kishit humbur rrugën e drejtë. A nuk u drejtoi Allahu juve në rrugën e drejtë falë meje? Ju ishit të varfër. A nuk u bëtë të pasur falë meje? Ju ishit bërë armiq me njëri-tjetrin. A nuk u bëtë miq me njëri-tjetrin falë meje? Ju ishit të ndarë në grupe të vogla. A nuk u bëtë si një trup i vetëm falë meje?

- Po, - u përgjigjën ensarët. - Begatitë dhe të mirat e Allahut dhe të Dërguarit të Tij janë të shumta për ne.

- Përse nuk më përgjigjeni drejtpërdrejt për pyetjet që ju bëra? - i pyeti Profeti.

- Për cilat pyetje do të përgjigjemi, o i Dërguari i Allahut? - e pyetën ensarët.

- Ju duhet të më kishit dhënë këtë përgjigje dhe atëherë do të ishit të sinqertë: "Ti erdhe tek ne, kur të tjerët të përgënjeshtonin, ndërsa ne të besuam. Ti erdhe tek ne i dëbuar dhe ne të morëm në prehërin tonë. Ti erdhe tek ne i abandonuar dhe ne t'u bëmë krah dhe të ndihmuam. Erdhe tek ne i varfër dhe ne u kujdesëm për ty, aq sa kujdeseshim për veten tonë. Erdhe tek ne i pikëlluar dhe ne të falëm sigurinë.

Pastaj profeti vazhdoi duke thënë:

- Juve ju thye zemra për shkak të të mirave të kësaj bote. Unë ua dhashë të mirat e mbledhura në luftë

kurejshëve, për t'ua ngrohur zemrat me fenë islame. Juve ju kam lënë pasuritë më të vyera që do të gëzoni në jetën tjetër, sepse ju jeni të vendosur në fenë islame. O ensarë! A nuk jeni ju të kënaqur që të ktheheni në shtëpitë tuaja së bashku me të Dërguarin e Allahut, ndërsa të tjerët të largohen në shtëpitë e tyre me gjedhët, devetë dhe të mirat e tjera të kësaj bote? Beto hem tek Allahu, me lejen e të Cilit jetoj: Po të mos kishte qenë muhaxhirlëku, do të dëshiroja të isha edhe unë një ensar. Në qoftë se të gjithë njerëzit e botës do të shkonin në një rrugë dhe ensarët

do të shkonin në një rrugë tjetër, unë do të shkoja nga rruga e ensarëve. Allahu im! Mëshiroji edhe fëmijët edhe nipat e ensarëve!

Ensarët, të cilët më parë ishin mërzhitur me të Dërguarin e Allahut për shkak të plaçkës së luftës dhe kishin folur fjalë të rënda ndaj Profetit (a.s.), filluan të qanin me dënësë, aq sa lotët ua njomën mjekrat, për shkak të këtij ligjërimi të sinqertë dhe prekës të profetit Muhamed (a.s.). Të gjithë thanë me një gojë: "Na mjafton vetëm i Dërguari i Allahut si plaçkë lufte. Ne jemi të kënaqur me ty!" Sikurse kishte thënë edhe profeti Muhamed (a.s.): "Disa fjalë kanë fuqinë e magjisë." Fjalët që tha Profeti Muhamed i magjepsën të gjithë ensarët. Mërzia e tyre u shndërrua në gëzim, ndërsa zemrat e thyera u bënë mike sërish me Profetin. Sa mjeshtëra fjalësh

Fjala është armë.
Muhamed Ikbali, njeriu i letrave dhe i zemrave, ka thënë: "Ky i ngratë ka një armë me të cilën e sfidon botën. Ato janë dy fjalë: La ilahe ilallah, Muhamedun Resulullah!"

arrijnë t'i kthejnë tërësisht përmbys brenda një çasti situatat, duke ndërruar kështu edhe rrjedhën e ngjarjeve dhe të historisë?

Napoleoni, i cili arriti të kishte efekt me ligjërimin e tij mbi ushtarët, të cilët kishin ardhur ta arrestonin atë, nuk u kthye në Paris i arrestuar me pranga në duar, por si një triumfator i vërtetë, pasi i kishte robëruar ushtarët me fjalët e tij.

Në histori njihen edhe shumë raste të tjera të ngjashme me këtë të Napoleonit.

Sulltan Selimi i Rreptë u pati mbajtur një fjalim të zjarrtë ushtarëve të tij, të cilët gjatë fushatës së Çalldëranit kërkonin që fushata të ndërpritej me pretekstin e lodhjes dhe të problemeve të tjera dhe shkuan deri aty, saqë kishin flakur edhe një shigjetë në drejtim të shatores së sulltanit. Fjalët

burrërore prej shpirti guximtar të sulltan Selimit, që ishin përmbyllur

me: *"Kush është burrë të më ndjekë mua. Ata që kërkojnë qejfin dhe rehatinë le të shkojnë te gratë e tyre. Unë do të shkoj në luftë, edhe po të mbetem i vetëm fillikat"*, i bënë të gjithë të hyjnë në vijën e bindjes. Edhe sulltan Alpasllani, i cili i çeli dyert e Anadollit për fenë islame, i cili theu me një ushtri prej pesëdhjetë mijë muxhahidësh ushtrinë bizantine, që numëronte dyqind mijë ushtarë dhe zuri rob luftime Diogjenin romak, ka qenë një burrë shteti dhe një komandant që e përdorte fjalën më me mjeshtëri sesa shpatën. Ai pati veshur qefinin prej pëlhure të bardhë dhe në hytben e xhumasë pati thënë sloganin: *"Po vdiqëm, biem shehidë, po jetuam bëhemi veteran"*, duke u dhënë forcë dhe moral të lartë ushtarëve me fjalët e tij madhështore, për të nisur në këtë mënyrë pushtimin e Anadollit.

FJALA NUK DUHET TË SOSË

Fjala është përherë më superiore se arma, sepse armët vetëm djegin, shkatërrojnë, vrasin dhe sjellin plagë, gjak dhe lotë. Puna i duhet lënë fjalës, përpara se t'i lihet armës. Nuk duhet të ekzistojë vendi ku fjala merr fund. Pikërisht atëherë kur fjala merr fund, nis fatkeqësia. Këshilli, parlamenti, forumet janë vendet ku problemet zgjidhen me anë të fjalëve dhe

diskutimeve. Diplomacia është në një farë kuptimi lufta e fjalëve, që bëhet për të mos folur armët ose që ato të heshtin. Në varësi të forcës së fjalës ndalohej lufta dhe arrihet paqja. Fjala e urtë e të parëve se: *"Njerëzit merren vesh me fjalë, ndërsa kafshët duke i marrë erë njëra-tjetrës"*, shpreh një të vërtetë shumë të rëndësishme. Po ashtu edhe fjala tjetër e urtë: *"Fjala e ëmbël e nxjerr edhe gjarpurin nga vendi ku është futur"*.

Zoti i pati urdhëruar profetët Musa dhe Harun të shkonin te faraoni, i cili pretendonte se ishte perëndi dhe t'i flisnin atij me fjalë të buta. Fatura e fjalëve të këqija është shumë e rëndë. Njeriu, i cili përkufizohet edhe si *"gjallesa që flet"*, duhet ta përdorë gjuhën e tij për të shprehur sa më mirë veten, për të përcjellë mesazhin që dëshiron, të zgjidhë probleme, të

ndërmjetësojë, të urdhërojë për mirë, të pengojë të keqen dhe të sigurojë vepra të mira për këtë dhe tjetrën jetë. Me pak fjalë, gjuha duhet të jetë përkthyesi i ndjenjave dhe mendimeve të bukura. Fjala e pavërtetë pranohet në rastet kur përdoret për të miqësuar dy armiq mes tyre. Siç është shprehur edhe Junus Emreja, fjala e bukur dhe e ëmbël e shndërron helmin në mjaltë dhe ia bën njeriut të dashura edhe shfaqjet më të dhimbshme.

Ebu Hasan Enbari (v. 328 H), poeti i periudhës së kalifatit abasi, që i njohur për elegjitë që shkruante.

Ebu Tahiri, veziri i sulltan Izuddevle që vrrarë dhe varur në hunj. Poeti e pati përshkruar pamjen e kufomës, së cilës i shkonin duart majtas-djathtas, si shprehia që kishte i ndjeri kur ishte i gjallë, në shpërndarjen e dhuratave njerëzve. Kur dëgjoi këtë elegji, kalifi u shpreh se do të dëshironte të ishte ai në vendin e viktimës, duke lënë të kuptohej se ishte penduar thellë për urdhrin e vrasjes.

Le ta mbyllim me fjalën më të bukur: ***Vallë, a nuk e sheh se si Allahu e përqs fjalën e mirë me pemën e mirë, e cila rrënjën e ka të fortë në tokë, kurse degët nga qielli? Me lejen e Zotit të saj (pema) jep fruta në çdo kohë. Allahu u tregon shembuj njerëzve, që t'ua vënë veshin.*** (Ibrahim, 24-25)

Fjala është përherë më superiore se arma, sepse armët vetëm djegin, shkatërrojnë, vrasin dhe sjellin plagë, gjak dhe lotë.

Puna i duhet lënë fjalës, përpara se t'i lihet armës. Nuk duhet të ekzistojë vendi ku fjala merr fund. Pikërisht atëherë kur fjala merr fund, nis fatkeqësia.

Kjo botë

Nuredin Jëlldëz



Elhamdulillah jemi besimtarë. Ngaqë jemi besimtarë, çdo gjë të dukshme apo të padukshme e shohim sipas besimit që kemi përvetësuar. Ne e pranojmë si të zezë atë që besimi ynë e quan të zezë, edhe nëse syri ynë e shikon të bardhë. Edhe këndvështrimi ynë ndaj kësaj bote mbi të cilën gjendemi, është i njëjtë. I Dërguari i Allahut, (a.s.), na e ka shtruar përpara këtë botë si diçka që nuk ka vlerë “as sa flatra e një mize”. Edhe nëse një pjesë toke bën shumë shtrenjtë në një vend të caktuar, për ne është aq e vlefshme sa që mund ta matim me flatrën e një mize. Kështu kemi besuar dhe kështu dëshirojmë të dalim në audiencën e Allahut të Lartësuar.

Kjo vlerë e ulët e kësaj bote, aq sa është një rregull konciz për të besuar, po aq e vërteton edhe realitetin e dynjasë. Të qenët e saj e përkohshme, ia ul vlerën. Siç është vetë e përkohshme, edhe çdo gjë që gjendet mbi të është e përkohshme. Ajo vetë nuk është e përhershme dhe asnjë gjallese mbi të nuk mund t'i japë përjetshmëri. Ajo është me huqe si mushka, që asnjëherë nuk i dihet se kur do ta hedhë atë që i ka hipur. Ne jetojmë në një botë ku lulet vyshken. Ne kemi një botë, së cilës i shteron uji, i nxehti i saj të përvëlton dhe i ftohti i saj të ngrin. Atij që nuk punon, nuk i jep për të ngrënë. Atë që ushqen, nuk e mbron. Ne kemi një botë, sëmundja e së cilës është ngjitëse. Zjarri i saj është i rrezikshëm. Atij që nuk fle, nuk i bëhet e dashur, por edhe atij që fle, nuk ia shkel syrin. Ajo kalon mbi ne si retë, na bën hije dhe na lag. Siç nuk mund ta nënshtrojmë renë, nuk mund ta nënshtrojmë edhe atë.

Të vdekurit që i ka nën vete, janë shumë më tepër se të gjallët që ecin mbi të. Edhe ata që i ka brengosur dhe i ka shkatërruar, janë më shumë se ata që i ka gëzuar dhe lumturuar. Ka pasur prej atyre që kanë humbur në errësirën e natës. Ka pasur edhe prej atyre që janë përvëluar dhe kanë vdekur në shkretëtirat e saj. Ajo duket si e pafundme, por, edhe pse duket e tillë, askujt nuk i jep vend më shumë se sa një varr. Ajo rrotullohet dhe bashkë me veten, rrotullon edhe ata që ka sipër. Mashtron, vyshket, kalbet, shtypet dhe zhduket. Edhe emri që ka, e tregon se çfarë është: Vend i ulët dhe me kohë të shkurtër. Ajo është shumë për një njeri dhe pak për dy njerëz.

Kjo botë është e mbushur me mirësi, por për çdo mirësi ka dhënie llogarie. Dynjaja të bën të punosh për të arritur ndonjë mirësi dhe pasi ta arrish, të bën

të japësh llogari. Nëse pi një gotë ujë, do të merresh në llogari për të. Nëse ha një kokërr fik edhe për atë do të japësh llogari ndaj degës së fikut. Madje, nëse merr qoftë edhe një frymë, do të japësh llogari për atë ajër që ke marrë. Kështu është kjo botë e mbushur plot me mirësi. Ato nuk vijnë pa mund. Edhe pasi të vijnë, ka llogari për to. Për këtë arsye, kjo botë për ne është e pavlefshme sa një flatër mize, edhe pse ka kaq shumë mirësi marramendëse. Ajo është e pavlefshme në llogarinë e Krijuesit të saj. Këtë e ka vërtetuar edhe përvoja mijërvjeçare e njerëzve. Sado që të kenë ujë oqeanet e saj, sado që të jenë të gjera luginat e saj dhe sado që të jenë të larta malet e saj, e vërteta absolute është kjo: Ajo është e pavlerë dhe e përkohshme.

Kështu kemi besuar dhe kështu e shikojmë. Ka edhe një të vërtetë tjetër, që duhet ta besojmë: Bota është krijuar kështu, në mënyrë që të sprovohemi. Asgjë nuk është e rastësishme. Allahu i Madhëruar e ka krijuar kështu. Ai dëshiroi të shikonte se kush do të bënte vepra të mira dhe kush do të bënte vepra të këqija, prandaj tabloja që kemi përpara është e atillë. Ai dëshiroi të shikojmë nga kjo botë, që nuk vlen as sa një flatër mize, në xhenetin që s'e ka parë asnjë sy dhe s'e ka imagjinuar asnjë mendje. Ai dëshiroi të na nxjerrë nga e përkohshmja për te e përhershme. Ai kërkoi nga ne që të përgatisim prehen e përhershme nga netët pa gjumë, buzëqeshjet e përhershme nga lotët dhe fatkeqësitë, dashuritë e pandashme nga miqtë dhe miqësitë provizore.

Besimi na urdhëron që ta shohim këtë botë si një flatër mize, kundërvlera e së cilës është xheneti. Ajo është e pavlefshme, por është baza e së vlefshmes. Ajo është një hiç, por çdo gjë fitohet me të. Ajo është e përkohshme, por do të jetë dera e përjetshmërisë. Prandaj ne nuk jemi për atë, por ajo është për ne. Llogarinë e kësaj bote do ta bëjmë sipas një ekuacioni: “Çdo gjë që ka kjo botë, dëshirojmë të jetë e jona, por ato nuk i propozim në zemrën tonë. Gjëja për të cilën them “është e imja”, është ajo gjë që qëndron në dorën time. Asaj që më bën egoist, nuk mund t'i them e imja. Unë jam amanet këtu. Po ashtu edhe ato që pandeh se janë të miat. Si mund të qëndrohet pafundësisht mbi këtë botë që është e përkohshme? Dynjaja është një sprovë e rëndë. Kjo sprovë është shumë edhe më e rëndë për ata që nuk mund t'i kuptojnë dimensionet e saj.



Xhafer Durmush

ATA QË VRAPOJNË DREJT MËSHIRËS së Allahut

Në suren Al'Imran, thuhet: **"Vraponi drejt faljes së gjynaheve nga Zoti juaj dhe xhenetit, hapësira e të cilit është sa qiejt e toka dhe që është përgatitur për të devotshmit, të cilët japin lëmoshë edhe kur janë në mirëqenie, edhe kur janë në vështirësi, e mposhtin zemërimin dhe ua falin fajet njerëzve. Allahu i do bamirësit. Për ata që, kur bëjnë vepra të turpshme ose i bëjnë dëm vetes, e kujtojnë Allahun, i kërkojnë falje për gjynahet e tyre - e kush i fal gjynahet përveç Allahut? - dhe nuk ngulmojnë me vetëdije në gabimet që kanë bërë, pra, për këta do të ketë si shpërblim falje madhështore (të gjynaheve) nga ana e Zotit të tyre dhe kopshte, nëpër të cilët rrjedhin lumenj dhe ku do të qëndrojnë përherë. Sa shpërblim i bukur është ky për ata që punojnë (vepra të bukura)!"** (Al'Imran, 133-136)

Në këto ajete fisnike flitet për cilësitë e besimtarëve të devotshëm, që e vendosin kënaqësinë e Allahut Teala në qendër të jetës. Këto cilësi fillojnë me "dhënien e lëmoshës edhe në mirëqenie, edhe në vështirësi". Këtu duam të tërheqim vëmendjen: Në ajetet para këtyre, urdhërohet që fitimi të pastrohet nga kamata dhe njoftohet se ata që nuk e zbatojnë këtë urdhër, në fund do të ndëshkohen me një zjarr që është përgatitur për femohuesit. Ndërsa në ajetet që përbëjnë temën tonë, besimtarët inkurajohen të strehohen te mëshira e Allahut të Madhëruar dhe thirren për në xhenet, gjerësia e të cilit është sa qiejt e toka. Qëllimi i fjalës "vrapim" që

përmendet në ajet, është nxitimi për vepra të mira, të cilat bëjnë që robi të falet dhe të futet në xhenet.

Ndërsa shprehja "xheneti, hapësira e të cilit është sa qiejt e toka" që përmendet në ajet, është përdorur për t'ua shpjeguar robërve në mënyrë simbolike gjerësinë dhe madhështinë e xhenetit, sipas shkallës së tyre të perceptimit. Nëse bëjmë kujdes, shohim se xheneti është përgatitur për të devotshmit, sepse vetëm një ndjenjë e fortë devotshmërie mund ta inkurajojë njeriun për të bërë vepra të mira që nefsit i duken të rënda, si dhënia e lëmoshës që përmendet në ajet, mposhtja e zemërimit dhe të falësh kur ke mundësi të ndëshkosh. Cilësitë kryesore të të devotshëmve për të cilat bëhet fjalë në ajetin fisnik, janë:

Robërit e devotshëm japin lëmoshë në mirëqenie dhe në vështirësi, në gëzim dhe fatkeqësi. Siç nuk mund t'i bëjë egoistë mirëqenia dhe gëzimi, edhe vështirësia apo fatkeqësia nuk mund t'i bëjë të harrojnë dhënien për hir të Allahut Teala. Ata nuk ikin nga përgjegjësia duke ua hedhur detyrën e gjallërimit e të shpirtit të ndihmës reciproke e solidaritetit që mban në këmbë shoqërinë islame, atyre që janë më të pasur. Ata nuk i hapin rrugë kopr racisë së nefsit, duke e shtyrë këtë punë për një kohë të ardhme të pacaktuar, derisa t'u rregullohet gjendja ekonomike. Ata përpiqen ta bëjnë traditë dhënien sipas mundësisë që kanë.

Ata e mposhtin zemërimin dhe me një fuqi shpirtërore që lind nga devotshmëria,

lartësohen në një horizont më madhështor se dëshirat vetjake. Në këtë mënyrë, fitojnë një fuqi të madhe shpirtërore dhe arrijnë ta mposhtin zemërimin. Në lidhje me virtytin e mposhtjes së zemërimit, i Dërguari i Allahut (a.s.), ka thënë: *“Trim i vërtetë nuk është ai që mposht rivalin në mundje, por është ai që mposht zemërimin kur nxehet.”* (Buhari, Edeb, 76.) Pastaj ka dhënë këtë përgëzim: *“Atë që e kontrollon zemërimin kur ka mundësi të hakmerret, Allahu do ta thërrasë përpara gjithë njerëzve në Ditën e Kiametit dhe do ta lërë të lirë të zgjedhë kë të dëshirojë prej hyrive.”* (Ebu Davud, Edeb, 3.)

Robërit e devotshëm i falin ata që u bëjnë keq. Në këtë proces, preferojnë durimin, i cili është më i dobishëm. Kur zemërimi merret nën kontroll, shpirtit i vjen shumë rëndë. Zjarri që e përvëlonte zemrën, bëhet një tym që mbështjell ndërgegjen, por kur njeriu e fal atë që i ka bërë keq, duke u hedhur kështu një hap më tutje nga faza e mposhtjes së zemërimit, zemra i hapet dhe shpirti i shpëton nga rëndesa për të cilën folëm më sipër. Në këtë mënyrë, gjen mundësinë për t'u hapur ndaj horizonteve të ndritshme. Zemra shpëton nga ndikimi i flakëve përvëluese dhe arrin prehjen shpirtërore. Krahas kësaj, njeriu mund të bëhet shkak

edhe për udhëzimin e atij që e ka falur. Në lidhje me këtë, mund të themi: Vrapimi drejt kënaqësisë së Allahut / xhenetit, gjerësia e të cilit është sa toka dhe qiejt, duke kërkuar faljen e Zotit (xh.xh.), duhet të jetë shkaku themelor i sjelljeve tona. Mirësitë nuk duhet t'i bëjmë për hir të disa interesave të kësaj bote, por për shkak të devotshmërisë dhe lumturisë së botës tjetër.

“Të qenët bujar në çdo situatë, të mposhtësh zemërimin, të falësh gabimet dhe të mos insistosh në mëkatë”, të cilat konsiderohen si cilësi të të devotshmeve në ajetet fisnike, janë prej veprave që kërkojnë vendosmëri të palëkundshme dhe që mund t'i bëjnë shpirtat e lartë që i kanë lënë pas dëshirat vetjake. Siç thuhet edhe në ajetin fisnik: **“Për këta do të ketë si shpërblim falje madhështore (të gjynaheve) nga ana e Zotit të tyre dhe kopshte, nëpër të cilët rrjedhin lumenj dhe ku do të qëndrojnë përherë. Sa shpërblim i bukur është ky për ata që punojnë (vepra të bukura)!”** (Al'Imran, 136.)

Allahu i Madhëruar na dhëntë sukses të gjithëve për të hedhur hapat drejt këtij karvani me nijet të mirë dhe vendosmëri! Amin!

Lexo - Mendo


VETËDIJA NË NAMAZ

Allahu Teala në suren Ibrahim thotë: **“Thuaju robërve të Mi, të cilët besojnë: Le të falin namazin dhe le të japin fsheturazi dhe haptazi nga ajo që ua kemi dhënë Ne, para se të arrijë dita në të cilën s'ka as tregti, as miqësi.”** (Ibrahim, 31) Ndërsa në suren Mu'minun, përgëzohet ata që e falin namazin me frikërespekt ndaj Zotit (xh.sh.). (Shik. Mu'minun, 1-2) Në suren Ankebut, Allahu Teala thotë: **“Lexo (o Muhamed) atë që të është zbritur ty prej Librit (Kurani) dhe fale namazin! Vërtet që namazi të ruan nga shthurja dhe nga çdo vepër e shëmtuar dhe vërtet që përmendja e Allahut është më e madhe! Allahu di gjithçka që ju bëni.”** (Ankebut, 45)

Abdullah ibn Mes'udi (r.a.), pyeti: “Cila është vepra që pëlqen më shumë Allahu?” I Dërguari i Allahut, (a.s.), iu përgjigj: *“Namazi që falet në kohën e tij.”* (Buhari, Mevakit 5.) Ndërsa sahabi i zgjedhur, Xherir ibn Abdullahu (r.a.), ka thënë se i ka dhënë besën të Dërguarit të Allahut, alejhi's-salatu ve's-salam, që do ta falë namazin e plotë, do t'i japë këshillë çdo myslimani dhe do të jetë i drejtë. (Buhari, Iman, 42.) Në lidhje me këtë, mund të themi:

Në ajetet dhe hadithet fisnike thuhet me insistim se namazet e kryera me frikërespekt ndaj Allahut Teala, e lartësojnë shpirtin dhe e mbrojnë falësin nga të këqijat. Ndërsa namazet që nuk e inkurajojnë falësin për mirësi dhe nuk e ndalojnë nga të këqijat, janë si një mëkat që mbartet në shpinë. Atëherë, sot duhet të pyesim: A jemi të vetëdijshëm se në audiencën e kujt jemi kur falim namaz? A mund ta ndiejmë në zemrat tona madhësinë e atyre që themi? A jemi të vetëdijshëm se kemi dhënë fjalën kur lexojmë Fatihanë dhe themi: **“Vetëm Ty të adhurojmë dhe vetëm prej Teje ndihmë kërkojmë”**? A e dimë se kujt i japim selam kur themi: “es-Selamu alejke ejuhe'n-nebijj”? Rreziku më i madh në lidhje me namazet, prej të cilave duhet të nderohemi kur i falim, është falja e tyre në një mënyrë rutinë të përsëritshme dhe të pavetëdijshme.

JETA E KËSAJ BOTE



Dr. Kerim Bulladë

Në ajete të ndryshme të Kuranit Fisnik theksohet koncepti "hajatu'd-dunja / jeta e kësaj bote". Në këto ajete fisnike bëhet e qartë se jeta e kësaj bote është provizore, mashtruese, lojë, dëfrim dhe ka pak vlerë në krahasim me jetën e Ahiretit.¹ Krahas këtyre, shpjegohet se kjo botë është tërheqëse me joshjen e saj, se femohuesve u duket e bukur, se ata që nuk i besojnë Ahiretit janë të kënaqur me të, se pasuria dhe fëmijët janë stoli të saj, se përbëhet nga dëshira për lavdërim ndërmjet njerëzve, nga dëshira për të mbledhur sa më shumë pasuri dhe nga dëshira për të pasur sa më shumë fëmijë.

Jeta e kësaj bote, sigurisht se nuk është e keqe në vetvete, sepse përgjatë kësaj jete njeriu fiton Ahiretin dhe siguron kapitalin e botës së përtejme. Pa ekzistencën e kësaj bote, nuk mund të perceptohet kuptimi dhe urtësia e jetës tjetër. Ajetet e mëposhtme këshillojnë që të përfitojmë nga jeta e kësaj bote:

¹ Shik. Muhamed Fuad Abdulbaki, Muxhemu'l-Mufehres li Elfazdh'l-Kur'an'il-Kerim, Botimet Çağrı, Stamboll, pa datë, fq. 224-225.

"Përpiqu me atë që të ka dhënë Allahu të fitosh jetën e botës së ardhshme, duke mos harruar pjesën tënde në këtë botë. Bëju mirë të tjerëve, ashtu si të ka bërë mirë ty Allahu. Mos kërkoi ngatërresa në tokë, sepse Allahu nuk i do ngatërrestarët." (Kasas, 77)

Siç shikohet, qëllimi dhe synimi i jetës së kësaj bote është fitimi i botës së përtejme. Nga ana tjetër, kur të punojmë për fitimin e jetës së Ahiretit, nuk duhet të harrojmë edhe pjesën që kemi në këtë botë. Kurani Fisnik e refuzon mendimin që e konsideron jetën të përbërë vetëm nga kjo botë. Allahu Teala thotë: ***"Ata thonë: 'Nuk ka tjetër veç jetës së kësaj bote, vdesim e jetojmë dhe vetëm koha na shkatërron'. Ata nuk kanë kurrfarë dijenie për këtë, ata vetëm hamendësojnë ashtu."*** (Xhathije, 24.) Krahas kësaj, Kurani Fisnik na njofton se jeta e përtejme është e përhershme: ***"Jeta tjetër është më e mirë dhe e amëshuar."*** (A'la, 17)

Kurani na tregon edhe për gabimin e mentalitetit që pandeh se do t'i ngelet përgjithmonë pasuria që

ka fituar dhe ka mbledhur në këtë botë. Ai e refuzon kategorikisht mendimin që nuk e fut në llogari të vërtetën e përkohshmërisë dhe njofton se njerëzit e tillë do të hidhen në xhehenem: **“Mjerë për çdo përqeshës - shpifës, që grumbullon pasuri dhe e ruan, duke menduar se ajo pasuri do ta bëjë të pavdekshëm! Jo, aspak! Në të vërtetë, ai do të hidhet në torturën shkatërruese.”** (Humeze, 1-4)

Kurani Fisnik thekson se nuk është e drejtë të lakmohen pasuritë e kësaj bote duke e harruar e mohuar Ahiretin dhe duke vepruar në mënyrë të pavetëdijshme për përgjegjësinë. Në lidhje me këtë, paralajmërohet edhe Hz. Pejgamberi, (a.s.). Allahu i Madhëruar thotë: **“Mos i drejto sytë e tu nga kënaqësitë, që Ne ua kemi dhënë disave prej tyre dhe mos u hidhëro për ata! Me besimtarët sillu butë!”** (Hixhr, 88.) Në ajetin para këtij, flitet për Fatihanë dhe Kurandin, që i është dhënë të Dërguarit të Allahut (a.s.). Çfarë vlere mund të kenë mirësitë e kësaj bote në krahasim me Kurandin Fisnik dhe suren Fatiha, e cila emërtohet edhe si lutje, lavdërim, shërim, dhikër etj.? A mund të ketë mirësi më të madhe se mirësia e Kuranit? A mund të ketë pasuri më të madhe se besimi dhe se reflektimi i parimeve të tij në jetë? Për këtë arsye, i Dërguari i Allahut (a.s.) dhe besimtarët janë paralajmëruar që të mos i kenë lakmi pasuritë e femohuesve dhe të atyre që nuk e besojnë Ahiretin.

Në një ajet tjetër, i Dërguari i Allahut, (a.s.), është paralajmëruar: **“Ti (o Muhamed) mos u mashtro nga bredhja e jobesimtarëve nëpër botë! Kjo mirëqenie është e shkurtër, pastaj strehimi i tyre është xhehenemi...”** (Al’Imran, 196)

Siç shihet, ajeti fisnik e urdhëron të Dërguarin e Allahut (a.s.), të mos i ketë zili shëtitjet nëpër botë dhe jetesën në mirëqenie të atyre që nuk e njohin Allahun. Po ashtu, urdhërohet që të mos mashtrohet nga gjendjet e tyre. Edhe besimtarët nuk duhet ta lakmojnë dhe admirojnë jetën plot dëfrime dhe ekonominë e madhe të femohuesve. Këto vlerësime nuk duhet të keqkuptohen sikur po themi që besimtarët nuk duhet të përpiqen, nuk duhet të fitojnë pasuri apo nuk duhet të prodhojnë shumë. Përkundrazi, besimtarët janë të obliguar të prodhojnë më të mirën, më cilësoren dhe më të shumtën. Por prodhimi dhe konsumimi i tij duhet të jetë sipas

boshtit të besimit në botën tjetër. Në një ajet tjetër, Allahu Teala kërkon nga Hz. Pejgamberi (a.s.), që të mos e lakmojë dhe të mos ua ngulë sytë stolive dhe jetesës në komfort, që u është dhënë mohuesve: **“Mos e hidh shikimin në të mirat kalimtare, që Ne ua kemi dhënë disave prej tyre, si stoli të jetës së kësaj bote, për t’i vënë ata në provë! Shpërblimi i Zotit tënd është më i mirë dhe më i qëndrueshëm.”** (Taha, 131)

Në ajet bëhet fjalë për mirësitë që konsiderohen stoli të jetës së kësaj bote dhe që u janë dhënë femohuesve për t’i vënë në provë. Në ajetin fisnik të mëposhtëm, bëhet mjaft e qartë se jeta e kësaj bote është lojë, dëfrim, zbukurim, mburrje dhe rivalitet për më shumë pasuri e fëmijë:

“Ta dini, se jeta në këtë botë nuk është tjetër veçse lojë, dëfrim e zbukurim, si dhe mburrje ndërmjet jush e rivalitet për më shumë pasuri dhe fëmijë! Ajo i shëmbëllen bimës, e cila pas shiut rritet dhe i gëzon bujqit, por më vonë zverdhet, thahet dhe mbetet pa vlerë. Në botën tjetër ju presin vuajtje të mëdha ose falja e Allahut dhe kënaqësia e Tij. Jeta në këtë botë është vetëm kënaqësi e rreme.” (Hadid, 20)

Në kohën tonë, kur kapitalizmi i është dedikuar mendimit për të bërë një jetë sa më argëtuese duke u ndikuar nga idhulli i fitimit dhe konsumit, ajetet e mësipërme i udhëzojnë dhe i paralajmërojnë në mënyrë serioze ata që besojnë. Ata që besojnë apo që thonë se besojnë në Ahiret, nuk

duhet të jepen pas joshjes së kësaj bote, nuk duhet ta teprojnë për të mbledhur pasuri të pakufishme, nuk duhet të lakmojnë një jetë plot dëfrime dhe nuk duhet ta kalojnë masën e përcaktuar në ajet dhe sunet, siç bëjnë ata që nuk besojnë në Ahiret apo ata që nuk e përfillin atë, apo ata që nuk e kuptojnë seriozitetin e kësaj çështjeje. Faktikisht, kjo është një çështje që duhet të shtjellohet nga aspekti i itikadit. Besimtarët duhet ta llogarisin në mënyrë serioze besimin e palëkundur të tyre në Ahiret, duke menduar përsëri mbi konceptin që Kurani e shtjellon si “hajatu’d-dunja / jeta e kësaj bote”. Kjo llogari duhet të vlerësohet si një domosdoshmëri e besimit dhe si një mundësi e rëndësishme për fitimin e botës së përhershme.





Prof. Dr. Sulejman Derin

Mëshira është karakteri i myslimanit

Allahu Teala e prezanton veten në librin e Tij të lartë më shumë me cilësitë “Rahman” dhe “Rrahim”. Në të njëjtën mënyrë edhe për të Dërguarin e Tij, (a.s.), na njofton se e ka dërguar “rahmeten lil alemin”, domethënë, mëshirë për të gjithë botët. Sigurisht se rezultati i kësaj është ky: Cilësitë më të rëndësishme që myslimani duhet të ketë në marrëdhëniet me të tjerët, janë mëshira dhe dashuria. Allahu i Lartësuar i cilëson sahabët e nderuar si të mëshirshëm. Imam Rabbani, duke u nisur nga i njëjti përshkrim që u bëhet myslimanëve në Kuranin Fisnik, në letrën e njëzetekatërt të vëllimit të dytë, shpjegon se mëshira dhe dashuria janë ngjyrat kryesore të të gjitha fushave të fesë.

“Muhamedi është i Dërguar i Allahut. Ata që janë me të, janë të ashpër ndaj jobesimtarëve e të mëshirshëm midis tyre. I sheh ata si përkulen dhe bien në sexhde, duke kërkuar dhuntinë dhe kënaqësinë e Allahut. Në fytyrat e tyre shihen shenjat e sexhdes. Ky është përshkrimi i tyre në Teurat. Ndërsa në Ungjill, shembulli i tyre përshkruhet si një farë e mbjellë që lëshon filiza e forcohet e pastaj ngrihet e fortë me kërcellin e

vet, duke i gëzuar mbjellësit. (Kështu përshkruhen ata) **me qëllim që nëpërmjet tyre Ai t’i zemërojë mohuesit. Për ata, midis tyre, që besojnë dhe kryejnë vepra të mira, Allahu ka premtuar falje dhe shpërbllim të madh.”** (Fet’h, 29) Në këtë ajet fisnik Allahu Teala ka lavdëruar shokët e zotërisë së njerëzimit për shkak se ata kishin mëshirë dhe ndjenin dashuri për njëri-tjetrin, sepse fjala “rrahim”, e cila është njëjësi i fjalës “rruhama” do të thotë shumë të mëshirshëm. Veçanërisht, fjala “rrahim” është cilësi e përngjasuar. Kjo tregon vazhdimësinë e tyre në mëshirë. Kjo mëshirë dhe dashuri që ata shfaqnin ndaj njëri-tjetrit, vazhdoi edhe kur i Dërguari i Allahut (a.s.), ishte gjallë, edhe pasi ndërroi jetë. Çdo gjë që binte në kundërshtim me mëshirën dhe dashurinë e tyre, u largua nga ata në mënyrë absolute. Me një thënie tjetër, ndjenjat si urrejtja, smira dhe armiqësia ndërmjet tyre, asnjëherë nuk ekzistuan më.

Fakti që sahabët ishin të mëshirshëm, sipas Imamit nuk ishte cilësi vetëm e sahabëve të njohur. Të gjithë sahabët e nderuar ishin të mëshirshëm karshi njëri-tjetrit, sepse shprehja “ve’l-ledhine meahu” që kalon në ajet, është gjithëpërfshirëse, domethënë, ajeti

fisnik na lajmëron se të gjithë sahabët e të Dërguarit të Allahut (a.s.), ishin të mëshirshëm.

Vallë, si duhet të jetë gjendja e sahabëve kryesorë, ndërkohë që të gjithë sahabët janë cilësuar me këtë atribut të mrekullueshëm? Këtë duhet të ulemi dhe ta mendojmë seriozisht! Pa dyshim se kjo cilësi shikohet te ata në formën më të plotë dhe të përsosur. Për këtë arsye, i Dërguari i Allahut, (a.s.), ka thënë: *"Më i mëshirshmi i umetit Tim është Ebu Bekri."* (Tirmidhi, nr. 3790.) Edhe në lidhje me Umerin (r.a.), ka thënë: *"Sikur të vinte pejgamber pas Meje, ai pejgamber do të ishte Umeri."* Nga kjo kuptojmë se çdo cilësi e lartë që duhet të gjendet te një profet, gjendej te Hz. Umeri (r.a.). Por, ngaqë i Dërguari i Allahut (a.s.), ishte pejgamberi i fundit dhe koha e profetësisë ishte mbyllur me Të, Hz. Umeri (r.a.), nuk u nderua me pozitën e profetësisë.

Në komentimin e këtij hadithi, Imami shprehet se mëshira është cilësia më e rëndësishme për profetësinë. Nisur nga kjo, edhe Hz. Umeri (r.a.), ishte një njeri shumë i mëshirshëm si Hz. Ebu Bekri (r.a.). Ata nuk mund të cilësohen me attribute të këqija, si urrejtja dhe zemërimi, siç pohojnë disa medh'hebe ekstreme. Njëra prej cilësive profetike është mëshira dhe dhembshuria e madhe karshi popullit.

Sahabët e nderuar ishin njerëzit më të lartë të umetit të Muhamedit (a.s.), i cili është umeti më i mirë... Ata janë njerëzit prioritarë dhe më kryesorë të Islamit, fe kjo që i shfuqizoi dispozitat e të gjitha feve të tjera. Sipas Imamit, mendimi se sahabët e pastruar pikërisht nga Allahu Teala ishin një shoqëri larg mirësive, është në kundërshtim me deklarinimin hyjnor. Sipas tij, shkaku që ata ishin më të mirët e umetit të Muhamedit (a.s.), ishte dashuria dhe mëshira që ndjenin kundrejt njerëzve, madje kundrejt të gjitha gjallesave. A mund të bëheshin ata më të lartët e umetit të Muhamedit (a.s.), sikur të kishin ato cilësi që nuk mund t'i kenë edhe individët më të ulët të umetit?.. Cili është shkaku që ky umet është umeti më i mirë?.. Ndërkohë që mund të shpëtojnë nga cilësitë e këqija, si urrejtja dhe zemërimi edhe ata që frekuentojnë kuvendet e evlijave dhe marrin edukim shpirtëror prej tyre, si mund të pandehet se i kanë këto cilësi të këqija njerëzit që e kanë kaluar të gjithë jetën e tyre në kuvendet e Pejgamberit më të mirë dhe kanë sakrifikuar pasurinë e jetën e tyre për ta forcuar fenë islame dhe për ta lartësuar emrin e Allahut Teala? Kjo, Allahu na ruajttë, mund të ndodhë vetëm nëse e shumëzohet me zero madhështinë dhe



sublimitetin e njeriut më të mirë dhe nëse supozojmë se kuvendi i Tij ka qenë më pak influencues se kuvendi i evlijave të umetit. Ne i kërkojmë mbrojtje Allahut Teala nga një mendim i tillë. Imami, për të konfirmuar mendimet e tij të mësipërme, në veçanti na kujton edhe besimin e ehli sunetit në lidhje me evlijatë. Sipas tij, asnjë evlija prej umetit nuk mund ta arrijë shkallën e ndonjërit prej sahabëve. Nisur nga kjo, ai i kundërshton medh'hebet që shpifin për tirani dhe tradhti për sahabët. Disa pandehin se sahabët e të Dërguarit të Allahut, (a.s.), ndahen në dy grupe: Ata që kanë kundërshtuar Hazreti Aliun (r.a.) dhe ata që kanë qëndruar pranë Hz. Aliut. Sipas tyre, këto dy grupime kanë pasur armiqësi, zemërim dhe urrejtje ndaj njërit-tjetrit. Disa prej sahabëve i kanë fshehur ndjenjat e këqija, duke menduar për disa interesa të tyre. Imami u përgjigjet: *"Kini frikë Allahun dhe mos e thoni këtë gjë, sepse, nëse mendojmë se është kështu, kemi shpifur për të dy grupimet..."* Në këtë mënyrë, të dy grupimet cilësohen me këto cilësi të këqija. Atëherë, më të mirët e umetit bëhen më të këqinjët e umetit. Cila ndërgjegje e pastër i kujton me ligësi Hz. Ebu Bekrin (r.a.) e Hz. Umerin (r.a.) dhe pranon këto gjëra të turpshme për të mëdhenjtë e fesë? Nisur nga deklarimi i Zotit në Kuranin Fisnik dhe i të Dërguarit të Allahut (a.s.), karakteri i myslimanëve duhet të jetë mëshira, dhembshuria dhe dashuria. Islami është feja e dashurisë dhe mëshirës. Nisur nga kjo, ata që shpifin për Allahun, Pejgamberin dhe myslimanët, janë injorantë ose kanë ndonjë qëllim të lig. Dashuria dhe sakrifica nuk u përket vetëm të krishterëve, siç pohojnë ata, përkundrazi, ky është karakteri i myslimanëve.

Imam Bukhari

mësuesi i mësuesve, imami i muhadithëve...

Imami i shquar dhe muhadithi më i famshëm i shekujve, Muhammed ibn Ismail El-Bukhari, u lind në vitin 194 h., në qytetin e Buharasë, që sot bie në Republikën e Uzbekistanit, ndër qytetet më të mëdha të zonës së "pas lumit", d.m.th. lumit Xhejhun.¹ Lindja e tij ndodhi një vit pas vdekjes së kalifit të famshëm abasit, Harun Reshidi.

Duke iu referuar dëshmisë së Resulullahut (a.s.): "Shekulli më i mirë është shekulli im, pastaj ata që vijnë, pastaj ata që pasojnë..."², imam Bukhariu konsiderohet pjesë e kësaj periudhe të begatë treshekullore.

Thotë për veten e tij: "M'u inspirua mësimi përmendsh i hadithit, që kur isha në mejtep. Kur mbusha 16 vjet, mësova përmendsh librat e Ibn Mubarekut dhe Vekiut... Kur mbusha 18 vjet, nisa të shkruaj në çështjet e sahabëve dhe tabiinëve dhe rreth thënieve të tyre. Asokohe shkrova librin "Et-Tarikh" te varri i Pejgamberit (a.s.), gjatë netëve me hënë..."³

Imami rrëfen edhe për rrugëtimin e tij në kërkim të dijes, ku përmend: "Kam takuar më shumë se njëmijë burra, prej dijetarëve në: Hixhaz, Mekë, Medine, Kufe, Basra, Vasit, Bagdad, Sham (Damask), Misir..."⁴

Ndër momentet më të spikatura, nëpërmjet të cilave kuptohet vendosmëria e tij në kërkim të dijes dhe mosdorëzimi para pamundësive materiale, është edhe kjo dëshmi e tij, kur thotë: "Dola drejt Adem ibn Ebi Ijasit, m'u mbaruan të ardhurat që kisha me vete, saqë kam ngrënë nga barërat e tokës, pa i thënë askujt. Ditën e tretë në këtë gjendje, më erdhi një person, të cilin nuk e njihja, i cili më zgjati një qese me dinarë dhe më tha: Shpenzoji për veten tënde!"⁵

Arritja kryesore e aktivitetit të tij dituror, është pa

dyshim libri i tij "Es-Sahih", për shkrimin e të cilit na tregon: "E kam shkruar "Sahihun" në një periudhë prej 16 vjetësh, hadithet e të cilit i kam nxjerrë nga gjash-tëqind mijë hadithe. Ky libër është argument në mes meje dhe Allahut të Madhëruar."⁶

Dhe, teksa rrëfen edukatën e tij në marrëdhënie me hadithet e Profetit (a.s.), thotë: "Nuk kam regjistruar asnjë hadith në "Sahih", pa marrë gusul fillimisht dhe pa falur dy rekate"⁷. Dhe teksa llogariten hadithet e Librit të tij dhe rekatet që ka falur në bazë të kësaj dëshmie dhe të tjera si kjo, dëshmohet se: "Imami ka falur **22.830 rekate** gjatë shkrimit të këtij libri!"⁸

Duke parë vlerën dhe madhështinë e këtij dijetari të pashembullt, dijetarët e kohës kanë dhënë vlerësimet e tyre, në mesin e të cilave kam dëshirë të spikas disa:

"Sikur të kisha mundësi të shtoja nga jeta ime në jetën e Muhamed ibn Ismailit (Bukhariut), do ta bëja, sepse vdekja ime është vdekja e një personi të vetëm, ndërsa vdekja e Muhamed ibn Ismailit është ikja e dijes!"⁹ – **Mësuesi i tij Jahja ibn Xhafer El-Bikendi**.

"I kam parë dijetarët në dy haremet e shenjta (Meke dhe Medine), në Hixhaz, Sham dhe Irak, por nuk kam parë në mesin e tyre më të plotë sesa Ebu Abdullahun, Muhamed ibn Ismail Bukhariun!"¹⁰ – **Bashkëkohësi i tij, Imam Daremiu, autori i "Sunenëve"**.

Transmeton Ebu Hamid El-Kassar: "E kam dëgjuar Muslim ibn Haxhaxhin, kur erdhi tek Muhamed ibn Ismail Bukhariu, e puthi në mes të syve dhe i tha: "Më lër t'i puth edhe këmbët, o Mësues i mësuesve, o Zotëri i muhadithëve, o Mjek i hadithit dhe lëngatave të tij!"... pastaj Muslimi i tha: "Ty nuk të urren vetëm se smirëzimi dhe dëshmoj se nuk ka në botë si ti!"¹¹ – **Nxënësi i tij,**

Imam Muslimi, autori i "Sahihut".

"Nuk kam parë në Irak, as në Horasan, njeri më të ditur se Muhammed ibn Ismaili, në çështjet e thella të hadithit, në histori dhe në njohjen e isnadeve".¹² – **Nxënësi i tij, Imam Ebu Isa Tirmidhiu.**

"Nuk kam parë nën kupën e qiellit njeri më të ditur rreth hadithit të Resulull-llahut (a.s), sesa Muhamed ibn Ismail Bukhariun!" – **Nxënësi i tij, Imami i imamëve, Ibn Khuzejme.**

"Nëse do të hapja kapitullin e lëvdave të dijeta-rëve për të (Imam Bukhariun), prej atyre që nuk ishin bashkëkohës të tij, do të mbaronin fletoret, do shuhej fryma, sepse ai është det që nuk ka breg!"¹³ – **Hafiz Ibn Haxheri.**

Dhe sikurse thotë njëri ndër biografët e tij: "I mjafton krenari Bukhariut, që ai është Bukhariu!"¹⁴ dhe: "I mjafton "Sahihul-Bukhariut" krenari, që është Libri, për të cilin i gjithë ymeti ka rënë dakord se është më i sakti libër pas Kuranit Famëllartë!"¹⁵

EDUKATA E TIJ ME ALLAHUN DHE ADHURIMI I TIJ

"Falej për çdo natë 13 rekate në një gjendje përsipirtësie të pashembullt...! Ai e madhëronte Profetin (a.s.), sa ruante në rrobat e tij disa prej qimeve nga flokët e tij (a.s.)..."¹⁶

Njëkohësisht, thoshte për veten e tij: "Nuk kam marrë dikë në gojë (gibet), qëkur kam mësuar se është haram!"¹⁷ Madje, në "Historinë e Bagdadit" etj., transmetohet se Imam Bukhariu ka thënë: "Shpresoj ta takoj Allahun dhe të mos më llogarisë se kam marrë dikë nëpër gojë (gibet)"¹⁸

Në lidhje me përkushtimin e tij në namaz, transmetohet nga Ibn Ebi Hatem El-Verrak: "Muhammed ibn Ismaili u ftua në kopshtin e një prej shokëve të tij. Kur erdhi koha e namazit të drekës, u falën së bashku. Pastaj, Imami u ngrit dhe vazhdoi të falej, sa e zgjati qëndrimin në këmbë. Kur e përfundoi namazin, ngriti cepin e pasmë të këmbës së tij dhe i tha njërit prej të pranishëmve: Shih, a ka diçka nën këmbëshen time? Personi në fjalë gjeti një grenzë, që e kishte pickuar imamin në disa vende, sa i ishte enjtur trupi. Dikush e pyeti: "Po përse nuk dole nga namazi?" (Imam Bukhariu) lu përgjigj: "Po lexoja një sure, që kisha dëshirë ta përfundoja!"¹⁹

Sikurse transmetohet, se: [Kur ishte nata e parë e muajit Ramazan, shokët e tij mblidheshin përreth tij dhe ai falej imam, duke kënduar në çdo rekat 20 ajete, kështu derisa e bënte hatme Kuranin. Ndërsa në syfyr lexonte sa gjysma a një e treta e Kuranit, duke bërë një hatme në tri ditë. Ndërsa ditën bënte nga një hatme, të cilën e përfundonte në iftarin e çdo nate dhe thoshte: "Në çdo hatme ka një duá të pranuar!"²⁰

Nga transmetimet e ndryshme, ai kishte trashëguar një pasuri të madhe nga i ati, hante shumë pak, ishte shumë bujar ndaj nxënësve të tij dhe jepte pa fund në rrugën e bamirësisë.²¹

PREJTHËNIEVE TË TIJ

"Myslimanët më të mirë janë ata që ringjallin një traditë të vdekur të Resulit (a.s.). Prandaj, duroni, o ju të zotët e syneteve, Allahu ju mëshiroftë..."²²

"Ai që më lavdëron dhe ai që më shan, në sytë e mi janë njëlloj!"²³

VDEKJA E TIJ

Thotë El-Hasen ibnul-Husejn El-Bezzaz: "Bukhariu u lind ditën e xhuma, pas namazit të xhumasë në të trembëdhjetën ditë të muajit Shevval, në vitin 194 h. dhe vdiq natën e shtunë, në prag të namazit të jacisë, natën e Fitër Bajramit. U varros pas namazit të Bajramit, të shtunën e 1 Shevvalit, në vitin 256 h. Jetoj 62 vjet, pa 13 ditë!"²⁴

SIHARIQET PAS VDEKJES SË TIJ

Transmetohet në disa hadithe, se i Dërguari i Allahut (a.s.), ka thënë: (nga Ebu Hurejra): "**Ëndrra e mirë është sihariq, e sheh besimtari, ose shihet për të**"²⁵

Në "Historinë e Bagdadit" etj., transmetohet nga Abdulvahid ibn Adem Et-Tavavisi, që ka thënë: "E pashë Profetin (a.s.), në ëndërr, me një grup prej sahabëve të tij, teksa qëndronte në një vend. I dhashë selam. Ma ktheu selamin. I thashë: "Përse je ndalur, o i Dërguar i Allahut?" Tha: "Po pres Muhamed ibn Ismail Bukhariun". Pas disa ditësh, mësova se Bukhariu kishte vdekur. Kur e verifikuam, kishte vdekur në atë orë, në të cilën pashë Profetin (a.s.), në ëndërr!"²⁶

Gjithashtu, transmetohet se Muhamed ibn Jusuf El-Firebri ka dëshmuar: "E pashë Profetin (a.s.), në ëndërr. Më pyeti: "Ku po shkon?" I thashë: Po shkoj te Muhamed ibn Ismail El-Bukhari. Tha: Bëji selam prej meje!"²⁷

Allahu e mëshiroftë dhe e shpërbleftë Imam Bukhariun për shërbimet e tij të singerta ndaj Fjalës së Profetit (a.s.), një shërbim për të cilin, i gjithë ymeti, deri në Ditën e Kiametit do t'i jetë mirënjohës!

Referencat:

1) Abdusettar Esh-Shejkh, "El-Imamul-Bukhari", botimi I, 2007, Damask, fq. 37. 2) Transmetuar nga Tabaraniu në "El-Eusat", nga Omeri (r.a). 3) Abdusettar Esh-Shejkh, "El-Imamul-Bukhari", botimi I, 2007, Damask, fq. 5. 4) Po aty, fq. 5. 5) Po aty, fq. 5. 6) Po aty, fq. 6. 7) Po aty, fq. 61. 8) Po aty, fq. 62. 9) Po aty, fq. 7. 10) Po aty, fq. 642. 11) Po aty, fq. 646. 12) Po aty, fq. 646-647. 13) Po aty, fq. 9. 14) Po aty, fq. 11. 15) Po aty, fq. 12. 16) Po aty, fq. 20. 17) Po aty, fq. 81. 18) Po aty, fq. 81. 19) Po aty, fq. 60. (Nga: "Historia e Bagdadit", Ibn Asakiri etj.). 20) Po aty, fq. 64-65. 21) Po aty, fq. 73. 22) Po aty, fq. 85. 23) Po aty, fq. 86. 24) Po aty, fq. 666. 25) Transmetuar nga Tabariu në tefsirin e tij dhe e ka bërë sahih, Shejkh Albani në "Sahihat", me nr. 1786. 26) Abdusettar Esh-Shejkh, "El-Imamul-Bukhari", botimi I, 2007, Damask, fq. 668. 27) Po aty, fq. 669.



Urtësia NË HISTORITË E KURANIT FISNIK

Xhemal Nar

Historitë në Kuran tregojnë ngjarje të vërteta. Prandaj quhen "histori të vërteta". Këto histori, siç pohojnë edhe disa orientalistë, nuk janë tregime që s'kanë lidhje me të vërtetat historike apo që thuhën për të dhënë këshilla. Historitë që tregohen në Kuran, janë të vërteta historike dhe lajme në lidhje me popujt e mëparshëm. Allahu i Madhëruar ka thënë në Kuran: **"Kështu pra, Ne po të tregojmë ty (o Muhamed) disa histori të së kaluarës. Ky (Kuran) që të kemi dhënë, është një Këshillë nga ana Jonë."** (Taha, 99.) **"Ne po ta tregojmë ty historinë e tyre sipas së vërtetës. Ata ishin djelmasha që besonin në Zotin e tyre dhe Ne i forcuan në rrugën e drejtë."** (Kehf, 13.)

Këto shprehje të Kuranit Fisnik janë një mrekulli e të Dërguarit të Allahut (a.s.), i cili nuk dinte shkrim e këndim, që të lexonte librat e vjetër dhe të mësonte prej tyre. Po ashtu, janë edhe një përgjigje për politeistët që Kuranit i thoshin **"esatiru'l-evvelin / përralla të të lashtëve"**. (Kalem, 15.) Sepse Kurani Fisnik nuk përbëhet nga përrallat e të lashtëve, por ai tregon lajmet dhe historitë e tyre.

Kurani është zbritur për t'i orientuar njerëzit në rru-

gën e drejtë. Për këtë arsye, përdor metodën e urtësisë dhe këshillimit. Ngjarjet e përjetuara i tregon me një metodë ndikuese dhe kërkon që njerëzit të nxjerrin mësim nga ato, sepse të njëjtat ngjarje mund t'u ndodhin të gjithëve në çdo kohë.

Deklarimet, këshillat dhe urtësitë që Kurani i ka përdorur si metodë, janë të mbledhura bashkë në histori. Ndër pesë temat që përfshin Kurani (besimi, ibadeti, veprat, ndëshkimet, morali dhe historitë), ajo që është shtjelluar më gjerë është tema e moralit dhe historive. Me të vërtetë, synimi i dërgimit të profetëve është udhëzimi i njerëzve dhe edukimi i tyre me moral. Prandaj, relativisht gjysma e Kuranit Fisnik përbëhet nga historitë e pejgamberëve dhe popujve të mëparshëm, në mënyrë që njerëzit të marrin mësim.

Historia ka rol të madh në edukimin e njeriut. Tregimi i ngjarjeve që u kanë ndodhur njerëzve në të kaluarën dhe i shkaqeve të tyre, e udhëzon dhe i jep mësim edhe njeriut të sotëm, sepse njeriu është i njëjtë më të tjerët në aspektin e krijimit, prirjeve dhe dobësive. Ajo që bënte fjalë për njerëzit dhe popujt e mëparshëm, bën fjalë edhe për njerëzit e sotëm. Për shembull, fu-

ndi i dhimbshëm i femohuesve dhe tiranëve, shtrohet para syve në Kuran duke treguar padrejtësitë që u bënë shkak për mbytjen në det të Faraonit dhe ushtrisë së tij. Po ashtu, në historinë e Hz. Jusufit (a.s.), tregohen në mënyrën më të bukur gradat e mëdha që do të arrijnë dhe shpërblimet marramendëse që do të marrin për durimin ata që u kanë vënë gjoksin vështirësive dhe nuk e kanë humbur besimin e mbështetjen tek Allahu Teala.

Synimi i historive në Kuran nuk është dhënia e informacionit historik. Prandaj nuk tregohen vendet dhe koha të cilat shfaqin detaje. Qëllimi është "tregimi i disa cilësive në historitë e popujve të ndryshëm, shpjegimi i ngjarjeve që kanë ndodhur në jetën e Hz. Muhamedit (a.s.) dhe që u ngajnë atyre që kanë ndodhur në jetën e peygamberëve të tjerë, vërtetimi se e drejta dhe e vërteta do të fitojnë dhe do të jenë të larta gjithmonë, ngushëllimi i Pejgamberit e i besimtarëve dhe forcimi i vendosmërisë së tyre duke ua vërtetuar me shembuj historikë shkatërrimin dhe shkrirjen e atyre që kanë kundërshtuar peygamberët". (Mehmed Sofuoglu, Hyrje në Tefsir, fq. 97.)

Në Kuranin Fisnik tregohen historitë e Hz. Ademit, Hz. Nuhut, Hz. Hudit, Hz. Salihut, Hz. Ibrahimit, Hz. Ismailit, Hz. Is'hakut, Hz. Lutit, Hz. Jakubit, Hz. Jusufit, Hz. Shuajbit, Hz. Musait, Hz. Davudit, Hz. Sulejmanit, Hz. Idrisit, Hz. Lukmanit, Hz. Dhul'Kiflit, Hz. Iljasit, Hz. Uzejrit, Hz. Ejubit, Hz. Junusit, Hz. Zekerijja, Hz. Jahjas, Hz. Isait dhe Hz. Muhamedit (a.s.).

Lajmet e popujve të kaluar

Siç shprehet edhe Kurani Fisnik, në "historitë e së kaluarës" (Taha, 99.) zënë vend historitë e Hz. Dhul-Karnejnit, As'habu'l-Kehfit, As'habu'l-Uhdudit, As'habu'l-Filit, As'habu'r-Resit, As'habu'l-Ejkes, Adit, Themudit dhe e popullit të Hz. Lutit e Hz. Nuhut. Veçanërisht shtjellohet edhe historia e Israsë, Hixhretit, Bedrit, Uhdit, Benu Nadirit, Ahzabit, Çlirimit të Mekës, Luftës së Hunejnit, Ngjarjes së Ifkut dhe historitë e hipokritëve. Në suren Jusuf, e cila tregohet si historia më e bukur / ahsen kissah, ka mësim të shumanshme. Prej tyre mund të përmendim: Shpërblimi i madh për durimin dhe rezistimin ndaj vështirësive, shpresa e pathyeshme në çdo kohë ndaj Allahut Teala, mosbindja ndaj dëshirave

të këqija të nefsit dhe shejtanit, lidhja me Allahun e Lartësuar, falja e atyre që bëjnë të këqija pa dije dhe edukimi i tyre me moral të lartë, vërtetimi se je një njeri i besueshëm duke e kryer në formën më të mirë detyrën që të është dhënë, mbajtja e amanetit dhe mbrojtja e të drejtave të të tjerëve. Po, Kurani është për t'u kuptuar dhe për t'u jetuar. Ndërsa historia e bën më të lehtë dhe më të dashur leximin dhe kuptimin e tij.

HISTORIA SI MJET EDUKIMI

Rrëfimet historike, fetare dhe morale kanë një rëndësi të madhe në edukimin e fëmijëve dhe të rinjve. Përshkrimi me një gjuhë dinamike dhe metodë letrare i ngjarjeve të përjetuara apo që mund të përjetojen, ka një ndikim shumë të madh te lexuesit. Përfundimet e tmerrshme të të këqijve dhe imoralëve, më mirë tregohen me metodën e rrëfimit. Në këtë mënyrë, njerëzit largohen nga të këqijat. Edhe veprat e mira dhe shembujt e moralit të lartë duhet të tregohen në këtë mënyrë influencuese, që të rinjtë të inkurajohen për sjellje dhe vepra të mira.

Për t'ua bërë njerëzve Islamit të dashur, është përfituar shumë nga rrëfimet dhe historitë. Edhe nëse nuk ka ndonjë kundërshtim me fenë në tregimin e historive morale të këtij lloji duke synuar edukimin e të tjerëve, është e ndaluar të trillosh tregime duke u dhënë natyrë fetare për të inkurajuar apo për të ndaluar diçka që nuk ka bazë në Kuran dhe Sunet. Në historinë e njerëzimit ka pasur shumë rrëfime që kanë trilluar dhe transmetuar histori për përfitimet e tyre personale, duke e keqpërdorur ndikimin që ato kanë te njerëzit. Ngaqë mistika Islame merret me përsosjen e moralit (tehzibu'l-Ahlak) dhe edukimin e nefsit, përfiton shumë nga historitë kur shtjellon temat. Historitë që tregojnë mistikët, në shumicën e rasteve janë histori të Beni Israilëve dhe rrëfime e tregime që shpalosin moralin dhe sjelljet e personaliteteve shembullore.

fyes që kanë trilluar dhe transmetuar histori për përfitimet e tyre personale, duke e keqpërdorur ndikimin që ato kanë te njerëzit. Ngaqë mistika Islame merret me përsosjen e moralit (tehzibu'l-Ahlak) dhe edukimin e nefsit, përfiton shumë nga historitë kur shtjellon temat. Historitë që tregojnë mistikët, në shumicën e rasteve janë histori të Beni Israilëve dhe rrëfime e tregime që shpalosin moralin dhe sjelljet e personaliteteve shembullore.

Le t'i gjallërojmë kuvendet tona me historitë e peygamberëve, dijetarëve, evlijave dhe luftëtarëve tanë. Nganjëherë, ato që thuhet, harrohen, por mesazhi kryesor i një historie është i pavdekshëm. Atëherë, përse të mos përfitojmë prej historive?

Historia ka rol të madh në edukimin e njeriut. Tregimi i ngjarjeve që u kanë ndodhur njerëzve në të kaluarën dhe i shkaqeve të tyre, e udhëzon dhe i jep mësim edhe njeriut të sotëm, sepse njeriu është i njëjtë më të tjerët në aspektin e krijimit, prirjeve dhe dobësive.

"Popullit të Medjenit Ne i dërguam vëllain e tyre, Shuajbin. Ai tha: 'O populli im, adhuroni Allahun! Ju s'keni tjetër zot përveç Tij. Mos bëni hile as gjatë matjes, as në kandar. Unë po shoh se ju gjendeni në begati dhe kam frikë se do t'ju godasë dënimi i një dite, që ju përfshin të gjithëve!"

(Araf, 85)

Kurani si shkak të shkatërrimit dhe dënimit të popullit të Lutit (a.s.), tregon degjenerimin moral, kurse si shkak të shkatërrimit të popullit të Shuajbit (a.s.), tregon degjenerimin e ndershmërisë dhe etikës në tregti. Shuajbi (a.s.), i ftoi ata të jenë të drejtë në marrëdhëniet e tyre tregtare. Kur ata nuk i vunë vesh thirrjes së Shuajbit (a.s.), Allahu i dënoi me një tërmet dhe një zhurmë të frikshme. Në ajetin e mësipërm tërheqja e vëmendjes për të qenë të kujdesshëm në matje dhe peshë vjen menjëherë pas urdhrimit për të adhuruar vetëm Allahun. Thënë ndryshe, detyrimi ndaj individit është përmendur paralel me detyrimin ndaj Allahut. Kjo tregon që në sistemin e vlerave fetare detyrimet ndaj individëve zënë një vend shumë të rëndësishëm. Në ajetin e lartpërmendur Allahu tërheq vërejtje për dy padrejtësi, e para bërja shok Allahut dhe e dyta dhunimi i pasurisë së të tjerëve. Të dyja këto konsiderohen padrejtësi dhe mëkate të mëdha. Feja nuk na kërkon të zbatojmë vetëm detyrat ndaj Krijuesit, por në të njëjtën kohë na kërkon të jemi të drejtë dhe të sinqertë në marrëdhëniet me të tjerët. Ata që janë të drejtë me Allahun, janë të drejtë edhe në marrëdhëniet tregtare. Ata që bëjnë dredhi në marrëdhëniet tregtare, nuk mund të jenë të sinqertë në marrëdhëniet me Allahun.

Në kohën tonë, abuzimi në procesin e

prodhimit të produkteve dhe veprimet tregtare është bërë shumë shqetësues. Ajeti kuranor përfshin shumë aspekte të abuzimit në botën e biznesit, si cilësia e dobët, lënia mangut në sasi, përdorimi i substancave të dëmshme për organizmin, reklamimi i produkteve jocilësore, keqpërdorimi i punëtorëve etj. Sot fatkeqësisht, në shoqërinë tonë pasuria publike dhe shtetërore po keqpërdoret dhe shpërdorohet në masivitet. Njerëzit sillen përballë pasurisë publike në mënyre krejt të papërgjegjshme.

Shitblerja është një dukuri e pandashme e shoqërisë. Prandaj përhapja në të e dredhive, mashtrimeve dhe matrapazllëkut çon në degjenerimin shoqëror, sepse mashtrimi sjell me vete tronditjen e besimit midis njerëzve. Nga ana tjetër, fitimi i pasurisë përmes rrugëve të ndaluar çon në mëkate dhe humbjen e freskisë shpirtërore. Fitimi i pasurisë haram nuk sjell dëme vetëm mbi individin, por edhe mbi gjithë shoqërinë. Ajo sjell humbjen e drejtësisë, e cila nga ana e saj çon në anarshia sociale. Anarshia sociale sjell humbjen e sigurisë dhe përhapjen e grupeve të jash-tëligjshme, të cilat shkelin dhe nuk marrin parasysh respektimin e asnjë norme ligjore dhe morale. Pasojat e kësaj anarshie janë të detyruar t'i vuajnë të gjithë njerëzit pa përjashtim.

Aishja (r.a.), trasmeton se i Dërguari i Allahut ka thënë::

*"Allahu është i kënaqur me atë që,
kur kryen një punë, e kryen në formën
më të mirë të mundshme."*

(Buhari)

Besimtarët janë urdhëruar t'i kryejnë detyrat shpirtërore apo materiale në mënyrë cilësore. Ai që e kryen punën e ngarkuar në mënyrën më cilësore dhe të mirë, ka sjellë në vend përgjegjësinë që ka para Allahut dhe para shoqërisë. Kush e kryen punën si duhet, në çfarëdo lloj fushe qoftë, është i fituar si në këtë botë, ashtu edhe në botën tjetër. Kurse një person që anashkalon punën dhe nuk e bën siç duhet, së pari ka gënjyer veten.

Zhvillimi dhe përparimi në çdo fushë, vjen duke bërë çdokush siç duhet punën që i takon. Përparimin dhe zhvillimin e meritojnë vetëm ata që e kryejnë detyrën e dhënë në mënyrën më cilësore dhe të mirë. Allahu nuk e jep suksesin sipas përkatësisë fetare, por sipas punës që bëjnë pa dallim, myslimanë apo jomyslimanë, besimtarë apo jobesimtarë. Suksesi u takon atyre që, pas përpjekjeve dhe marrjes së masave që duhet për të pasur sukses në fushën përkatëse, i mbështeten Allahut (xh.sh.). Allahu nuk i jep sukses një populli vetëm pse është besimtar, pa bërë përpjekjet e duhura. Gjendja e botës islame sot është një shembull tipik i kësaj të vërtete. Në të shkuarën, kur gjyshërit tanë, me të cilët mburremi sot, krijuan një qytetërim shembull për gjithë historinë e njerëzimit, e arritën këtë sukses duke punuar me seriozitet, me bindje dhe sinqeritet. Suksesi i arkitekt Sinanit, i cili me kryeveprat e tij sfidon kohën, ka ardhur si pasojë jo vetëm e gjenialitetit të tij, por edhe e dëshirës dhe

përpjekjes titanike për të krijuar vepra cilësore. Nëse suksesi sot ndodhet në duart e qytetërimit perëndimor, është tregues i dembelizmit dhe i cilësisë së dobët të punëve që bëjmë prej shumë shekujsh. Niveli i zhvillimit të një shoqërie është i ngjashëm me një grup provëzash që komunikojnë me njëra-tjetrën nëpërmjet gypave. Kur hidhet ujë në një provëz, niveli i ujit ngrihet në të gjitha provëzat; e njëjta dukuri shfaqet edhe te niveli i zhvillimit të një shoqërie. Kështu, mosfunksionimi siç duhet i institucioneve arsimore në një shoqëri, ndikon negativisht edhe tek individët e veçantë, por edhe tek institucionet e tjera. Dhe funksionimi i institucioneve është i lidhur drejtpërdrejt me nivelin e shoqërisë, sepse ata që punojnë në këto institucione janë individët e kësaj shoqërie dhe niveli i këtyre institucioneve nuk mund të jetë më lart se sa niveli i shoqërisë. Në një shoqëri të tillë është e shpeshtë dukuria ku individët apo institucionet akuzojnë njëri-tjetrin për mosmbarëvajtjen e punëve. Kjo ndodh, sepse askush nuk e bën punën e vet siç duhet. Ngritja e nivelit të një shoqërie bëhet me përfshirjen e gjithë shoqërisë, duke filluar nga kryetari deri tek individi më i thjeshtë; kur çdonjëri prej tyre të kryejë detyrën e vet siç duhet, atëherë përparon dhe zhvillohet shoqëria.

Një person që nuk e kryen punën e ngarkuar siç duhet, nuk është i mirëpritur as nga Krijuesi, as nga shoqëria.

Mësimet që nxjerrim nga hadithi:

1. Besimtari duhet ta kryejë në formën më të mirë punën e dhënë.
2. Prej një pune pa cilësi nuk mund të merret një frut i mrekullueshëm.
3. Allahu kënaqet kur njeriu e kryen detyrën e dhënë siç duhet.

Mje Hadith



SIGURIA DHE QETËSIA

Në krye të nevojave të njeriut në këtë botë vijnë siguria dhe qetësia. Njeriu ka nevojë të mbrohet nga çdo lloj padrejtësie dhe me të drejtat që zotëron të gjejë lumturinë, me të cilën do të garantojë të ardhmen e tij në këtë botë dhe në botën tjetër. Njeriu, i cili nuk ndihet i sigurt në vendin ku jeton, nuk mund t'ua shohë kurrë fytyrën as qetësisë e as rehatisë. Dhe fuqia më madhe që mund ta garantojë këtë siguri, janë parimet hyjnore që ka vendosur Allahu i Madhëruar, pra Islami. Allahu, në lidhje me këtë fakt shprehet:

“Për të mbrojtur (fisin) kurejshët, për t'i mbrojtur ata në udhëtimin që bëjnë dimër e verë. Prandaj le të adhurojnë Zotin e kësaj shtëpie (Qabes), i Cili i ushqen ata në ditë urie dhe i siguron në ditë frike.” (Kurejsh, 1-4)

Sistemet dhe ligjet njerëzore janë shumë larg nga garantimi i kësaj sigurie dhe qetësie, sepse ato nuk kanë asnjë anë shpirtërore. Para se të vinte Islami, bota ishte mbështjellë nga një errësi e thellë injorance. E drejta i takonte të fortit. I dobëti nuk kishte asnjë të drejtë; e drejta e tij ishte të qëndronte i shtypur. Njerëzit rënkonin dhe shtypeshin nën një tirani, e cila është e pamundur të përshkruhet. Poeti i madh Mehmed Akif Ersoj, në lidhje me këtë gjendje shprehet:

I dobëti, e drejta e të cilit ishte të shtypej, u ringjall;

Tirania, zhdukja e së cilës as që mendohej, ngordhi!

Në një periudhë të tillë, Allahu i Madhëruar i fali fisit Kurejsh një mirësi hyjnore. Ndërsa ata, në sajë të kësaj

sigurie, zhvilluan veprimtaritë e tyre politike, tregtare e kulturore duke arritur rehatinë dhe pasuri të mëdha materiale e shpirtërore. Kur erdhi koha e duhur, Zoti ynë i Madhëruar nxori prej këtij fisi peygamberin e fundit, në sajë të të cilit i mësoi njerëzimit parimet më të shëndetshme të paqes, lumturisë dhe sigurisë.

ISLAMI ËSHTË BURIMI I QETËSISË DHE PAQES NË BOTË

Kuptimi i fjalës “Islam”, është shpëtim, paqe, qetësi, siguri, dorëzim dhe rehati. Dhe kjo tregon se feja islame, me të gjitha anët e saj, i fal të gjithë botës shpëtim dhe qetësi. Pra, Islami nuk u sjell shpëtim dhe qetësi vetëm njerëzve, por edhe kafshëve, bimëve, e madje edhe krijesave jo të gjalla. Vetë Peygamberi (a.s.), gjatë gjithë jetës së tij peygamberike prej 23 vjetësh, ka luftuar me çdo lloj të terrorit dhe në fund i dorëzoi botës fenë e vërtetë, që është burimi i paqes dhe sigurisë së përjetshme.

Islami e shpëton njeriun nga çdo lloj tiranie, padrejtësie dhe çdo lloj gjëje e keqe. Dijetarët islamë shprehën se synimi i fesë, është vendosja dhe mbrojtja e këtyre pesë parimeve themelore, të cilat njihen edhe si **“darurat-i dinijje”**:

- a) Mbrojtja e fesë,
- b) Mbrojtja e jetës,
- c) Mbrojtja e mendjes,
- ç) Mbrojtja e nderit dhe vlerave, për rrjedhojë mbrojtja e brezave,
- d) Mbrojtja e pasurisë.



Nëse mbrohen këto pesë parime, njeriu arrin paqen dhe sigurinë e plotë.

Islami, në lidhje me mbrojtjen e secilit prej këtyre parimeve, ka vendosur rregulla të forta dhe ka caktuar harame/të ndaluara dhe hallalle/të lejuara. Studimin më të hollësishëm të gjyqimeve në lidhje me këto çështje, e bën "muamelati/kodi i të drejtave civile", që është një nga degët e jurisprudencës islame.

Para ardhjes së Islamit, njerëzimi, nga ana e besimit, adhurimit, të drejtave civile dhe jetës së përditshme, ishte për të ardhur keq. Siç nuk kishte siguri për jetën, pasurinë dhe nderin, nuk kishte as edhe një besim, adhurim dhe moral që mund ta ngrinte njeriun. Njerëzit adhuronin idhujt që i bënin prej hurmave dhe i hanin ato kur i merrte uria. I urdhëronin skllëvërit e tyre të bënin idhuj prej druri e prej guri, pastaj prisnin ndihmë prej tyre. Kur pushonin në ndonjë vend gjatë udhëtimit, merrnin katër gurë, tre prej tyre i vinin si vatër zjarri poshtë tenxheres, njërin e bënin zot dhe e adhuronin.

Në lidhje me këtë fakt, Ebu Rexha Utaridi, thotë:

"Ne adhuronim një gur. Kur gjenim një gur tjetër më të bukur, e hidhnim atë që kishim dhe merrnim tjetrin. Kur nuk gjenim dot gur, bënim një kapule me dhé, mbi



Kuptimi i fjalës "Islam", është shpëtim, paqe, qetësi, siguri, dorëzim dhe rehati. Dhe kjo tregon se feja islame, me të gjitha anët e saj, i fal të gjithë botës shpëtim dhe qetësi. Pra, Islami nuk u sjell shpëtim dhe qetësi vetëm njerëzve, por edhe kafshëve, bimëve, e madje edhe krijesave jo të gjalla.


të cilën milnim një dele, pastaj bënim tavaf rreth saj." (Buhari, Megazi, 70.)

Islami i abrogoi të gjitha këto besime të gabuara, të cilat përdhosnin vlerat njerëzore dhe solli një besim të lartë, adhurime dhe vlera morale të cilat e lartësojnë nderin dhe vlerën e njeriut. Islami e organizoi çdo fushë të jetës njerëzore në mënyrën më të bukur. Myslimanët, të cilët shijuan ndjenjat e larta që u fali Islami, u përpoqën me shumë sakrificë që edhe njerëzit e tjerë të përfitonin nga kjo mirësi kaq e madhe. Ja disa shembuj të bukur në lidhje me këtë fakt:

Ebu Talha dëshironte shumë të martohej me **Ummu Sulejmen** (r.a.), e cila e kishte pranuar më parë Islam. Mirëpo, Ummu Sulejme (r.a.), i vuri kusht që të braktiste idhujt dhe të hynte në Islam, duke u shprehur kështu:

"Mendo pak mbi këta gurë që i adhuroni! Ata nuk mund të sjellin as dobi dhe as dëm! Po ashtu, mendo edhe për idhujt që keni bërë prej druri! Ju vjen marangozi, i cili e pret dhe e gdhend pemën, ndërsa ju e adhuroni atë si zot. Nëse e hidhni në zjarr, do të digjet e do të bëhet shkumb e hi. A nuk ju vjen turp të adhuroni drurët që mbijnë nga toka dhe gdhenden nga një skllav etiopas? Nëse thua shehadetin¹ dhe ndjek

1. - Shehadet: Deklarata Islame: "Esh'hedu en La ilahe il-lall-llah ue esh'hedu



"Askush prej jush s'ka për të besuar në kuptimin e vërtetë të fjalës, pa dëshiruar për vëllain e vet mysliman atë që dëshiron për veten."

Pejgamberin tonë, do të martohem me ty pa kërkuar asgjë prej teje!"

Pasi i dëgjoi shumë herë këto fjalë, më në fund Ebu Talha pranoi dhe u nderua me besimin islam. Ummu Sulejme (r.a.), u gëzua shumë nga kjo dhe, megjithëse kishte mundësinë të merrte sa të donte prej pasurisë së tij, u martua me Ebu Talhan duke marrë si mehri të martesës vetëm thënien e shehadetit. Pra, mehri i saj u bë **"Islami"**.²

Pejgamberi (a.s.), në lidhje me parimin i cili do t'i garantojë të gjithë njerëzimit sigurinë dhe qetësinë, është shprehur në mënyrë shumë të qartë:

"Askush prej jush s'ka për të besuar në kuptimin e vërtetë të fjalës, pa dëshiruar për vëllain e vet mysliman atë që dëshiron për veten." (Buhari, Iman, 7; Muslim, Iman 71-72.)

Nëse njerëzit e zbatojnë altruizmin që urdhërohet në këtë hadith fisnik, problemet shoqërore do të ulen në minimum dhe padrejtësitë do të marrin fund.

enne Muhammeden abduhu ue Rasuluhu / Dëshmoj se përveç Allahut nuk ka zot tjetër dhe se Muhammedi është rob dhe i Dërguari i Tij".

2. - Shih. Nesai, Nikah, 63/3340-1; Ibn-i Sa'd, Tabakat, VIII, 426-427; Ibnu'l-Esir; Usdu'l-gabe, VII, 333.

ISLAMI ËSHTË FEJA E SË VËRTETËS DHE DREJTËSISË

Ky urdhër i Allahut të Madhëruar garanton shërimin ndaj burimit më të madh të shqetësimeve të njerëzve:

"Mos ia merrni pasurinë njëri-tjetrit padrejtësisht! Dhe mos jepni ryshfet te gjykatësit për të marrë në mënyrë të paligjshme dhe me vetëdije një pjesë të mallit (pasurisë) të njerëzve." (Bekare, 188.)

Një ditë, i Dërguari i Allahut (a.s.), i pyet shokët e vet:

"A e dini se kush është i falimentuar?" Ata u përgjigjën:

"Sipas nesh, i falimentuar është ai që nuk ka para dhe mall." Por i Dërguari i Allahut (a.s.), tha:

"S'ka dyshim, se të falimentuarit e umetit³ janë ata që në Ditën e Kiametit do të vijnë me sevapet përkatëse të adhurimeve, si namazi, agjërimi, zekati etj., por, për shkak se këtë e ka sharë, për atë ka shpifur për imoralitet, këtij i ka ngrënë mallin padrejtësisht, atij tjetrit i ka derdhur gjakun dhe një tjetër e ka rrahur, të gjitha sevapet e mirësive të tij u kalojnë këtyre. Nëse sevapet i mbarojnë pa larë hakun e atyre që u ka bërë padrejtësi, gjynahet e atyre që kanë për të marrë hak, do t'i ngarkohen këtij dhe si përfundim ai do të hidhet në xhehenem." (Muslim, Birr 59; Tirmidhi, Kijamet 2; Ahmed, II, 303, 324, 372.)

Një njeri që i dorëzohet Islamit me gjithë zemër, duke i mbajtur gjithmonë në mendje këto ajete dhe hadithe fisnike, sigurisht që nuk mund të mendojë aspak t'i bëjë keq ndokujt.

Botëkuptimi i **"drejtësisë"** që solli Islami, qëndron mbi çdo lloj imagjinate. Një shembull në lidhje me këtë fakt është edhe ky:

Gjatë betejës së Bedrit, para se të fillonte lufta, Resulullahu (a.s.), me shigjetën që mbante në dorë, i vinte në rresht dhe i numëronte luftëtarët me urdhrat, si **"Bëj para, bëj mbrapa"**. Në këtë moment, prek barkun e **Seuad bin Gazijes** (r.a.), i cili kishte dalë pak para rreshtit dhe i thotë:

"O Seuad! Vihu në rresht!" Kurse Seuadi (r.a.), tha:

"O Rasulallah, më vrave! Allahu të ka dërguar me të vërtetën, prandaj kërkoj të marr hak!" Pas kësaj, Pejgamberi ynë (a.s.), hapi këmishën dhe tha:

"Eja merr hak!" Disa prej Ensarëve⁴ u shqetësuan dhe duke dashur ta sillnin në vete Seuadin, thanë:

"O Seuad! Ky është i Dërguari i Allahut!" Seuadi tha:

3. Umet: Popull

4. - Ensar (Ndihmës): Janë quajtur banorët e qytetit të Medinës që pritën emigrantët/muhaxhirët, të cilët erdhën së bashku me Pejgamberin (a.s.), nga Meka dhe u vendosën në Medinë.

"Para drejtësisë, asnjë njeri nuk është më i lartë se një njeri tjetër!" I Dërguari i Allahut (a.s.), tha përsëri:

"Eja merr hak!" Por Seuadi (r.a.), e puthi barkun e bekuar të Pejgamberit (a.s.), i cili tha:

"O Seuad! Përse e bërë këtë?" Seuadi (r.a.), u përgjigj:

"Siç e shihni, jemi përgatitur për të luftuar. Unë dëshirova që momenti im i fundit të jetë ky që po të prek ty!"

Pas kësaj, Rasulallahu (a.s.), u lut për të.⁵

Pejgamberi (a.s.), i cili gjatë gjithë jetë së tij ka treguar një kujdes të jashtëzakonshëm ndaj të drejtave të të gjitha krijesave. Edhe në momentet e fundit të jetës nuk harroi këtë çështje dhe madje, megjithëse ishte i pafuqishëm, doli në minber dhe tha:

"Shokët e mi! Nëse kam marrë pa dashje mallin e ndonjërit prej jush, ja ku është malli im, le të vijë e ta marrë!.. Nëse i kam rënë dikujt në kurriz (padashje), ja ku është kurrizi im, le të vijë e të më bjerë!.."⁶

ISLAMI ËSHTË FE E DELIKATESËS DHE MIRËSJELLJES

Islami i mëson myslimanët të jetojnë duke menduar Ditën e Llogarisë dhe të mos i përdhosin të drejtat e të tjerëve. Rasulullahu (a.s.), myslimanin e devotshëm e ka përkufizuar me këto fjalë:

"Mysliman, është ai, prej gjuhës dhe dorës së të cilit nuk dëmtohet askush..." (Buhari, Iman, 4-5.)

Me të vërtetë që një mysliman, gjatë gjithë edukimit islam dhe adhurimeve, mëson të jetë "i padëmshëm". Në fund, arrin një gjendje të tillë, saqë askush nuk mendon se prej tij mund të vijë ndonjë dëm. Një besimtar i tillë, ngjall gjithmonë qetësi dhe siguri përreth vetes.

I Dërguari i Allahu (a.s.), ka thënë:

"Besimtari i ngjan bletës. Bleta ha gjithmonë gjëra të pastra, bën gjëra të pastra, qëndron në vende të pastra dhe, për shkak se kur ulet në ndonjë vend vepron me delikatesë, ajo nuk dëmton, nuk thyen e nuk prish asgjë. Ndërsa kur rrëzohet, nuk thyhet e nuk dëmtohet."⁷

Bleta është një krijesë jashtëzakonisht e aftë, specialiste, e zgjuar, e dobishme dhe modeste. Madje, ajo punon edhe natën. E mbledh ushqim e saj prej luleve dhe ha gjithmonë gjëra të pastra. Ajo është e bindur ndaj prijsëve të saj dhe dëmet e saj janë jashtëzakonisht minimale. Qëndron larg gjërave të pista dhe nuk e ha djersën e tjetrit.

Edhe besimtari, ashtu si bleta, e fiton pasurinë në



"Besimtari i ngjan bletës. Bleta ha gjithmonë gjëra të pastra, bën gjëra të pastra, qëndron në vende të pastra dhe, për shkak se kur ulet në ndonjë vend vepron me delikatesë, ajo nuk dëmton, nuk thyen e nuk prish asgjë. Ndërsa kur rrëzohet, nuk thyhet e nuk dëmtohet!"

mënyrë hallall, ha ushqime hallall dhe qëndron në vende të pastra nga gjynahet. Kudo që ndodhet, shpërndan mëshirë prej shpirtit të tij. Nuk cenon askënd dhe nuk cenohet prej askujt. Kur bën ndonjë gabim, e kupton menjëherë atë, e korrigjon veten dhe gjithmonë e ruan dinjitetin dhe maturinë. Ai është modest dhe punon gjithmonë për të mirën e të gjithëve. Po ashtu, ai qëndron larg shkujdesjes, ngatërresave, haramëve dhe dëshirave të ulëta të egos.

Një shoqëri, individët e së cilës janë si bleta, padyshim që mund të arrijë nivelin më të lartë të paqes dhe sigurisë. Resulullahu (a.s.), këtë e ka deklaruar që në vitet e para të Islamit:

Habbab bin Eret (r.a.), tregon:

Një ditë, shkuam pranë Rasulallahut (a.s.). Ai kishte vendosur rrobën e tij poshtë kokës si jastëk dhe po pushonte nën hijen e Qabes. Duke iu ankuar prej torturave që na bënin idhujtarët, thamë:

"A nuk do të kërkoni ndihmë për ne? A nuk do t'i luteni Allahut për ne?"

Rasulullahu (a.s.), u mërzit paksa dhe me fytyrë të skuqur u ngrit dhe tha:

"Në popujt e mëparshëm, një besimtar kapej dhe

5. - Ibn-i Hisham, II, 266-267; Uakidi, I, 57; Ibn-i Sa'd, III, 516; Ebu Daud, Edeb, 148-149/5224; Dijat, 14/4536.

6. - Shih. Ibn-i Sa'd, II, 255; Taberi, Tarihi, III, 190 Ahmed, III, 400.

7. Shih. Ahmed, II, 199; Hakim, I, 147; Bejhaki, Shuab, V, 58; Sujuti, Xhami, no: 8147.

futej në një gropë. Pastaj ia ndanin kokën më dysh me sharrë dhe ia krihnin mishin dhe kockën me kreher hekuri. Por të gjitha këto nuk mundën ta kthejnë atë nga feja e vet. Beto hem se Allahu patjetër do ta bëjë mbizotëruese këtë fe. Aqsa një kalorës i vetmuar do të udhëtojë nga San'a deri në Hadramaut⁸ pa asnjë shqetësim e frikë tjetër përveç Allahut dhe sulmit të ndonjë ujku ndaj kopesë (bagëtime) së tij. Por ju po nxitoheni (jeni të padurueshëm)!" (Buhari, Menakib, 25, Isti'zan 35, Menakibu'l Ensar 29; Ebu Daud, Xhihad, 97/2649.)

Njëherë tjetër, Resulullahu (a.s.), i thotë Adij bin Hatimit, i cili ngurronte të bëhej mysliman:

"Unë e di shkakun që të pengon të hysh në Islam. Ti mendon se: "Atë (Islamin) e ndjekin vetëm të dobëtit dhe të pafuqishmit, të cilët arabët i shohin si të pavlerë. A e di Hiren?" Ai u përgjigj:

"Nuk e kam parë, por e kam dëgjuar." I Dërguari i Allahut (a.s.), tha:

"Beto hem në Allahun, i Cili mban në dorë shpirtin tim, se Allahu do ta plotësojë këtë çështje! Aq sa një grua do të vijë e vetme prej Hires dhe do të bëjë tavaf shtëpinë e Allahut. Pastaj do të hapen thesaret e Kisra bin Hurmuzit!" Adij bin Hatimi i habitur pyeti:

"Të Kisra bin Hurmuzit?" Ndërsa Pejgamberi (a.s.), tha:

"Po të Kisra bin Hurmuzit!" Pastaj vazhdoi duke thënë:

"S'ka për të kaluar shumë dhe pasuria do të shtohet aq shumë, saqë askush nuk do ta prekë me dorë dhe nuk do të gjendet dikush që do të pranojë zekatin e pasurisë!"

Më vonë, kur Adij bin Hatimi (r.a.), e tregoi këtë ndodhi, tha:

"Vallahi, unë kam parë një grua që erdhi e vetme nga Hira mbi devenë e saj pa u frikësuar nga asgjë dhe bëri haxh në Shtëpinë e Zotit! Vallahi edhe unë kam qenë bashkë me ata që kanë hapur thesaret e Kisras. Beto hem në Allahun, i Cili ka në dorë shpirtin tim, se edhe e treta do të realizohet, sepse atë e ka thënë Resulullahu (a.s.):"⁹

Po, synimi i Islamit është të garantojë që njerëzit të

jetojnë në një vend të qetë, ku të mos kenë frikë prej tjetërkujt përveç Allahut. Si rezultat i kësaj, vjen edhe mirëqenia materiale. Në periudhën e Khalifit Omer bin Abdulazizit, për shkak se myslimanët nuk po gjenin të varfër për t'i dhënë zekatin, shkuan tek Khalifi dhe e pyetën se çfarë të bënin me zekatin.¹⁰

ISLAMI ËSHTË FE E TOLERANCËS

Pejgamberi (a.s.), shumë njerëzve u ka dhënë "eman"-e¹¹ me shkrim. Prof. Dr. Muhammed Hamidullah, në vepërën e tij të quajtur "Letrat diplomatike të Pejgamberit", shprehet se në vende të ndryshme, ka parë shumë kopje të "emanname"-ve, që i përkisnin Pejgamberit tonë (a.s.). Një nga këto, ka edhe një ndodhi shumë të bukur:

Kur u çlirua Stambolli, nga mbretëritë përreth vinin delegacione për të uruar. Midis tyre, ishte edhe Patriarku Ortodoks i Kudsit (Jeruzalemit) Athanasios, i cili kur doli përpara Sulltan Fatihut, i tregon atij emannamen që kishte firmosur Pejgamberi ynë (a.s.), me gishtin e tij dhe disa dorëshkrime të shkruara me shkrim "kufi"¹², që kishin ngelur që nga koha e Omerit (r.a.). Pas kësaj, i kërkon që vendet e adhurimit që ndodheshin në Kuds, të qëndronin ashtu siç kishin qenë më parë. Sulltan **Fatih**u aprovon po ato të drejtat që u kishte dhënë Pejgamberi (a.s.) dhe lëshon një ferman me shkrim, në fund të të cilit gjendet një shënim: "E mallkoftë Allahu atë që e anulon këtë urdhër të padishahut!" Sot, ky ferman gjendet në Arkivin Osman të Kryeministrisë, i regjistruar si "Kilise Defteri, no: 8"¹³.

Në sajë të parimeve islame, shoqëria myslimane kishite arritur një nivel të tillë, saqë edhe komunitetet e tjera që jetonin në administrimin e saj, qoftë të krishterët e qoftë hebrejtë, jetonin në mirëqenie dhe ishin të kënaqur. Madje, ata nuk e dëshironin aspak administrimin e bashkëfetarëve të tyre dhe në shumë raste i kanë ftuar vetë myslimanët në vendet e tyre.

Bernard Lewis thotë:

10. Shih. Bejhaki, Delailu'n-Nubuue, VI, 493; M.S. Ramadan Buti, Fikhu's-sire, fq.434.

11. Eman / Emanname: Një dokument i lëshuar në vendet islame, i cili garanton jetën dhe pasurinë e atij që e posedon.

12. Kufi: Një stil shkrimi me gërma arabe.

13. -Ziya DemirAvni Arslan, Osmanlı'da Peygamber Sevğisi, Ankara 2009, s. 63; www.turkislam tarihi.nl/makaleler/kudus.php



“Osmanët i magjepsnin të krishterët. Toleranca osmane dhe mundësitë që njihite shteti i tyre, kishte tërhequr aty shumë njerëz që kërkonin të arrinin qetësinë. Fshatarët e shtypur shpresonin ndihmë prej armiqve të të zotëve të tyre. Madje, vetë **Lutheri**, në një vepër të tijën, të cilën e publikoi në 1541-in, i paralajmëron kështu të krishterët: «Në vend që të jetojnë nën administrimin e princërve, feudalëve dhe borgjezëve syngangopur si puna juaj, të varfërve mund t’u duket më mirë të jetojnë nën administrimin e turqve...”¹⁴

ISLAMI ËSHTË FE MËSHIRE

Islami është një fe mëshire. Mëshira është një nga parimet më të rëndësishme të fesë islame. Aq sa Allahu i Madhëruar, pranë fjalës “Bismilah”, që është edhe kryetitull në Librin e Tij, ka vendosur edhe dy emrat e Tij të bukur, **Rahman** dhe **Rrahim**, të cilët shprehin mëshirën e Tij të gjerë. Menjëherë më pas, në ajetin e dytë të sures së parë, **Fatiha**, janë përsëritur të njëjtët emra. Më tutje, emri **Rahman** është përdorur si fjala e parë e një sureje, e cila ka marrë po të njëjtin emër, **Rrahman**. Më konkretisht, aty urdhërohet: **“Rrahmani ua mësoi Kur’anin!”**, duke shprehur në këtë mënyrë faktin se Kurani Kerim i është ofruar njerëzimit si një mëshirë hyjnore. Gjithashtu, në suren **Isra**, deklarohet qartë se Kurani është mëshirë dhe shërim. (shih. **Isra**, 82)

Në të njëjtin kontekst edhe në sure të tjera të Kuranit, butësia dhe mëshira përmenden dhe këshillohen me qindra herë. Nga ana tjetër, një nga virtytet më të larta që Allahu Teala i dhuroi Pejgamberit tonë (a.s.), është mëshira. Në mënyrë të veçantë, në sajë të deklaratës hyjnore: **“Dhe Ne nuk të kemi dërguar ty (o Muhamed), veçse si mëshirë për botët.”** (Enbija, 107.), kjo cilësi e Rasullahu (a.s.), përbën një nivel aq të lartë, sa askush tjetër nuk mund ta arrijë. Një nga shembujt e mëshirës së tij të pashoqe është edhe ky:

Ndërkohë që në betejën e Bedrit ushtritë kishin dalë përball njëra-tjetrës, Rasullullahu (a.s.), u dërgon idhujtarëve përfaqësues me qëllim për të bërë paqe. Në këtë kohë, në radhët e ushtrisë së armikut filloi kriza për ujë. Një grup prej idhujtarëve, midis të të cilëve ishte edhe Hakim bin Hizami, erdhën për të pirë ujë në pusët

e myslimanëve. Kur myslimanët tentuan t’i pengonin, i Dërguari i Allahu (a.s.), tha:

“Lërimi të pinë!” Pastaj ata erdhën e shuan etjen. (Ibn-i Hisham, II, 261)

Pra, mund të themi se në Islam, fryti i parë përbëhet prej mëshirës. Të dashurit e Allahut, të cilët kanë bërë një jetë mbi këto parime, e kanë përkufizuar devotshmërinë me këto dy shprehje të shkurtra:

a)- Tadhim li-emrillah, të tregosh respekt dhe nënshtrim në zbatimin e urdhrave të Allahut,

b)- Shefkat ala halkillah, të mëshirosh të gjitha krijesat për hir të Krijuesit.

Islami është një fe mëshire. Ndërkohë që njerëzimi, i cili është rrokullisur në shumë gropa të gjynaheve dhe të shkujdesjes, e ka merituar shkatërrimin dhe humbjen

për shkak të atyre që ka bërë, Allahu i Madhëruar gjithmonë i ka hapur krahët e mëshirës dhe faljes duke dëshiruar t’i tërheqë robërit e Tij në atmosferën e lumturisë. Kjo deklaratë e Tij e qartë: **“Mëshira ime e tejkaloit zemërimin tim!”**¹⁵, është treguesi më i bukur i kësaj të vërtete.

Mund të themi me bindje se një shoqëri, e cila e jeton Islamin ashtu siç duhet, bëhet shoqëri e paqes dhe qetësisë. Njerëzit që jetojnë aty, ndihen të sigurt edhe në jetën e kësaj bote, por mund të shohin me shpresë edhe jetën e botës tjetër. I Dërguari i Allahut (a.s.), ka thënë:

“Atij që është mysliman, i është dhënë furnizim i mjaftueshëm dhe është i kënaqur me mirësitë që i ka falur Allahu, ka arritur shpëtimin (e vërtetë).” (Muslim, Zekat, 125. Shih. Tirmidhi, Zuhd, 35/2348)

O Zot! Na e bëj të mundur ta kuptojmë Islamin dhe ta zbatojmë atë në mënyrën më të bukur në jetën tonë, me qëllim që të arrijmë shpëtimin në të dyja botët; që nga dora dhe gjuha jonë të mos cenohet asnjë krijesë; të bëjmë një jetë të qetë, pa cenuar askënd dhe pa u cenuar nga askush; dhe që të gjitha gjymtyrët e mirësitë, të cilat na i ke falur, t’i përdorim gjithmonë në rrugë të drejtë!

Amin!..

14. -Bernard Lewis, “The War and the Politics”, In *The Legacy of Islam*, botimi i dytë, Oxford 1974, fq. 156-209.

15. Shih. Buhari, Teuhid, 15, 22; Muslim, Teube, 14-16.



NË KËTË KOHË, *Besimi* ËSHTË SI **ZJARR** QË MBARTET NË DORË...

Sallh Zeki Meriç

Besimi është kushti i parë për të hyrë në Islam. Njeriu hyn në besim duke e pohuar me gjuhë dhe duke e konfirmuar me zemër njësimin e Zotit dhe Muhamedin (a.s.), si robi dhe të Dërguarin i Tij.

Baza e besimit, faktikisht është konfirmimi me zemër. Iman do të thotë, t'i besosh Zotit që nuk shikohet, që mund të mësohet për Të dhe që e tregon ekzistencën e Tij me anë të shfaqjeve. Po ashtu, do të thotë t'u besosh engjëjve që njeriu nuk i shikon, Ahiretit që nuk është përjetuar, por që do ndodhë në të ardhmen dhe ringjalljes pas vdekjes. Mbi të gjitha, do të thotë t'u besosh profetësive të pejgamberëve që Zoti (xh.xh.), ua ka dhënë atyre nëpërmjet shpalljes dhe të besosh se librat, të cilët janë kushtetuta hyjnore për jetën.

Kurani Fisnik, i cili është udhëzuesi i jetës sonë, na përkufizon ne si besimtarë. Besimtar është ai që ka besuar. Allahu i Madhëruar, duke u nisur nga vlera

që kemi marrë prej besimit dhe duke na u drejtuar me shprehjen "o ju që keni besuar", e përmend këtë në tetëdhjetë e tetë vende të Kuranit Fisnik. Kjo do të thotë se Zoti i Lartmadhëruar i pranon si bashkëbisedues ata që i besojnë Atij.

Ibn Mes'udi, (r.a.), në lidhje me këtë shprehje, ka thënë: "Kur të dëgjosh thirrjen e Zotit të Lartësuar "o ju që keni besuar", hapi veshët mirë dhe dëgjo me gjithë shpirt, sepse pas kësaj thirrjeje, Allahu të urdhëron për ndonjë punë të mirë ose të ndalon nga ndonjë gjë e keqe." (Sujuti, Itikan, II, 43; Ibn Kethir, Tefsir, I, 148)

Çfarë mund të ketë ndonjë gjë më të vlefshme se besimi i besimtarit, i cili ka pasur nderin të bëhet protagonist i kësaj thirrjeje? Njeriu, të cilit i është dhënë besimi me mirësinë e Allahut Teala, duhet ta mbartë besimin e tij në mënyrë të përpiktë, derisa të shkojë te Zoti (xh.xh.) dhe të dalë në audiencën e

Tij me këtë amanet.

Nisur nga kjo, përderisa të jemi gjallë, duhet të shqetësohemi thellësisht për besimin. Ne duhet të jemi vigjilentë, se përgjatë jetës mund të ketë sulme të brendshme e të jashtme kundër besimit që kemi në zemër dhe që është më i vlefshëm se çdo gjë. Prandaj, duhet të marrim masa shpirtërore dhe mendore kundër kësaj.

Të besosh në punën që ke bërë, është një gjendje shkujdesjeje. Kërkimi i rrugëve të sigurta për ta mbrojtur besimin dhe përgjërimi ndaj Allahut të Lartësuar për mëshirë, përsëri është një gjendje që buron nga besimi. Ne si besimtarë duhet ta shpresojmë xhenetin dhe të mbartim dëshirën për të parë bukurinë e Allahut Teala.

Njeriu gjithmonë duhet të shqetësohet në lidhje me llogarinë që do të japë në Ahiret. Allahu Teala na ka krijuar, por nuk na ka lënë pa përgjegjësi. Allahu i Madhëruar na ka dhënë besimin, na ka bërë të kuptojmë shumë gjëra nëpërmjet nurit të udhëzimit dhe si rezultat, na ka dhënë disa përgjegjësi, për të cilat do na marrë në llogari. Besimtari duhet të jetë i vetëdijshëm për këtë.

Nëse një besimtar frikësohet nga dita e llogarisë dhe shqetësohet për të ardhmen e besimit të tij, i shtohet përpikëria ndaj veprave dhe e përcakton drejtimin e jetës së tij. Mbi të gjitha, ky shqetësim e inkurajon atë që t'i drejtohet Zotit (xh.sh.), të mbrohet nga mëkatet dhe e bën të gatshëm kundrejt rreziqeve në të ardhmen, në mënyrë që të mos bjerë viktimë e tyre. Gjendjen e atyre njerëzve që nuk shqetësohen për të ardhmen e tyre, Kurani Fisnik e shpreh kështu: **“Cili është më i mirë, ai që themelet e godinës së vet i vë në përkushtimin ndaj Allahut dhe në kënaqësinë e Tij, apo ai që themelet e godinës së**

tij i vë në bregun e gërryer dhe rrokulliset me të në zjarrin e xhehenemit? Allahu nuk e udhëzon në rrugë të drejtë popullin keqbërës.” (Teube, 109)

Miqtë e Zotit (xh.sh.), shprehen se “përgjatë gjithë jetës duhet ta mbajmë hapur derën e frikës ndaj Allahut. Ndërsa në kohën e vdekjes, duhet të kapemi pas shpresës”. Besimtarët duhet të kenë frikë përgjatë gjithë jetës prej Allahut, prej tmerrit të Ditës së Kiametit dhe prej ndëshkimit të Xhehenemit, por kjo frikë nuk duhet t'i shtyjë ata në pasivitet, mosveprim, dëshpërim dhe pesimizëm. Përkundrazi, duhet t'i orientojë drejt qëndrimeve dhe sjelljeve që ua heqin shkaqet e të pasurit frikë.

Rendja pas jetës së kësaj bote, dëshirat, pasionet dhe çdo lloj përpjekjeje që na e rrit egoizmin tonë, janë gjëra që na bëjnë ta harrojmë ëmbëlsinë e besimit.



Shenja për mbartjen e një shqetësimi të vazhdueshëm për besimin, shfaqet në veprat dhe sjelljet tona. Prej njeriut që është humbur në vitrinat e shndritshme të jetës moderne, është e pamundur të presësh shqetësim për botën tjetër, sepse, në një jetë që nuk ka ndjeshmëri, nuk ka as mendim për fenë dhe nuk ka as vepra që e vërtetojnë besimin. Për të mos rënë në kthetrat e jetës që të hedhin në humnerë, duhet të kemi një besim të fortë. Ndërsa besimi i fortë arrihet duke përvetësuar një mënyrë jetese që e shton atë. Me dashje apo pa dashje, shumë herë mund të shkojmë në buzë të asaj humnere apo të na hedhin në të. Për këtë arsye, ne duhet të kemi një mjedis që na shpie te besimi, duhet të kryejmë shërbime fetare që na e ëmbëlsojnë besimin dhe duhet të kemi një vetëdije të fortë adhurimi ndaj Allahut Teala që të na e mbrojë besimin tonë si një armaturë.



Arjan Ymeraj

URTËSITË DHE DOBITË E ADHURIMEVE NË ISLAM

URTËSITË

Në Librin e Tij Fisnik, Allahu i Madhëruar na tregon se qëllimi i kryerjes së të gjitha adhurimeve është arritja e devotshmërisë. Kjo do të thotë se, nëse nuk arrihet devotshmëria nëpërmjet një adhurimi, ky adhurim nuk është realizuar me qëllimin për të cilin është urdhëruar të kryhet.

Por, ç'është në vetvete devotshmëria ose devocioni, pra bindja ndaj Allahut? Për këtë, kemi shpjegimin e Ibn Rexhebit, i cili thotë: "Esenca e devotshmërisë është vendosja e një mburoje (e cila të ruan) kundrejt hidhërimit të Allahut të Madhëruar. Kjo mburojë është t'u bindesh urdhrave të Allahut dhe t'u përmbahesh ndalesave të Tij..." (Xhami'ul Ulum ue'l-Hikem: 190/191)

Që të arrihet devotshmëria, duhet patjetër që njeriu t'i kryejë adhurimet si bindje ndaj urdhrat të Allahut, e jo për arsye të tjera në interes të dobisë së tij trupore, edhe pse me këtë adhurim njeriu mund të ketë shumë përfitime dhe dobi në shëndetin e trupit të tij. Ndaj, dijetarët bëjnë thirrje që njeriu të kontrollojë qëllimin-nijetin e tij para se ta kryejë një adhurim, në mënyrë që të mos privohet nga shpërblimi i madh që Allahu ka përgatitur

për atë që kryen një adhurim me sinqeritet, për të fituar kënaqësinë e Allahut.

Për këtë, Allahu i Madhëruar i urdhëron besimtarët në Kuranin Famëlartë, duke thënë: **"O njerëz! Adhurojeni Zotin tuaj, i Cili ju ka krijuar ju dhe ata që ishin para jush, në mënyrë që të bëheni të devotshëm** (që të ruheni nga të këqijat)..." (Bekare, 21)

Allahu i Madhëruar i urdhëron besimtarët të jenë të kujdesshëm ndaj ligjeve të Tij në çdo aspekt të jetës së tyre dhe i nxit të jenë të vëmendshëm ndaj dispozitave të fesë. Për këtë, Ai thotë: **"Po, kështu është! Ndërsa kush madhëron shenjat (dispozitat) e fesë së Allahut, tregon përkushtimin (devotshmërinë) e zemrës së tij"** (Haxhxh, 32)

Ndërsa, urtësinë e obligueshmërisë së agjërimit ndaj këtij umeti, e ka qartësuar Allahu i Lartësuar, i Cili thotë: **"O ju që besuat, agjërimi ju është bërë obligim, ashtu siç ishte obligim edhe për ata që ishin para jush, në mënyrë që të bëheni të devotshëm."** (Bekare, 183)

Ibn Kajim el Xheuzijeh, për urtësinë e obligimit të agjërimit, ka thënë: "Qëllimi i agjërimit është frenimi i vetes nga epshet dhe tekant, shkëputja, ndërprerja (e

përkohshme) nga gjërat e zakonshme me të cilat është i mësuar. Ai është balancimi i fuqisë epshore, në mënyrë që të përgatitet për të arritur lumturinë dhe mirësinë dhe për të pranuar atë, me të cilin shpirti pastrohet dhe arrin fitoren e jetës së Përhershme. Uria dhe etja i zbusin epshet, tekat dhe pangopësinë e vetvetes. Ato i përkujtojnë njeriut gjendjen e të gjerëve të uritur. Agjërimi ngushton fushën e veprimtarisë së shejtanit dhe rrugët e qarkullimit nëpër trupin e njeriut, duke ngushtuar rrugët e qarkullimit të ushqimit dhe lëngjeve. Ia frenon forcën e gjymtyrëve, duke bërë që të mos lëshohen lirshëm pa asnjë kontroll dhe të bien në ato gjëra që janë të dëmshme për të, si në dynja, ashtu dhe në Ahiret. Atij i qetësohen gjymtyrët dhe agjërimi i kontrollon fuqitë e njeriut që të mos acarohen, duke i frenuar ato.

Agjërimi është frenimi i të devotshmëve, mburoja e luftëtarëve (të epsheve dhe tekave), ushtrimi i të mirëve të devotshëm, të afruar tek Allahu. Është vepër, të cilën Zoti i botëve e ka dalluar dhe veçuar nga të gjitha veprat e tjera dhe të cilën robi e bën për hir të Tij, në mënyrë të veçantë, sepse ai nuk vepron diçka të jashtme të dukshme, por frenon veten, duke braktisur ushqimin, pijen dhe epshin, për hir të të Adhuruarit të tij. I lë ato që shpirti i tij i dëshiron dhe i do, duke i dhënë përparësi dashurisë së Allahut dhe arritjes së kënaqësisë së Tij. Agjërimi është diçka e fshehtë mes Allahut dhe robit të Tij, të cilën nuk e di askush veç Tij. Njerëzit mund të dinë prej tij (agjëruarit) lënien e gjërave të jashtme e të dukshme, por nuk mund të dinë se ai e ka lënë ushqimin, pijen dhe epshin e tij për hir të të Adhuruarit të tij dhe ky është në fakt realiteti i agjërimit..."

Pas këtij fjalimi të gjatë, mes të tjerash Ibn Kajjim Xheuzijeh thotë: "Agjërimi mbron shëndetin e zemrës dhe të gjymtyrëve dhe ua rikthen gjymtyrëve forcën, të cilën ia kishin rrëmbyer epshet dhe tekat. Agjërimi është shkaku ndihmues kryesor për arritjen e devotshmërisë, siç ka thënë Allahu i Madhëruar: **"O ju që keni besuar, ju është bërë obligim agjërimi, ashtu siç u ishte bërë edhe atyre që ishin para jush, në mënyrë që të bëheni të devotshëm."** (Bekare, 185).

Qëllimi i agjërimin nuk është stërvitja e trupit për të përballuar etjen e urinë, por është stërvitja e trupit për të lënë gjërat e kënaqshme, për të kënaqur Allahun. Gjërat e kënaqshme që lihen, janë ushqimi, pija dhe epshi, këto janë kënaqësitë e trupit. Kurse kënaqësia që kërkohet, është arritja e kënaqësisë së Allahut të Lartësuar. Pa tjetër duhet ta kemi parasysh këtë qëllim.

Allahu i Lartësuar nuk kërkon prej nesh të lëmë vetëm ushqimin e pijen, por kërkon të lëmë edhe shpifjet dhe injorancën. Pikërisht për këtë, është e pëlqyeshme për agjëruarin që, kur e ofendon dikush, të thotë: "Unë jam agjërueshëm." E mos t'ia kthejë atij, sepse nëse ia kthen, i shkon agjërimi vetëm me ofendime e përlëshje. Por,

nëse i thotë: "Unë jam agjërueshëm.", e njofton atë që e ofendoi dhe e luftoi se ai nuk është i pafuqishëm për t'ia kthyer, por ajo që e ndalon ta bëjë një gjë të tillë është agjërimi.

Ndërsa për namazin, Allahu i Madhëruar përmend qëllimin e tij, duke thënë **"... me të vërtetë, namazi para ndalon nga çdo vepër e papëlqyer, e ulët dhe e keqe (fahsha) dhe veprat e shëmtuara e gjynahet (munker). E përmendja e Allahut është më e madhja** (adhurimi me vlerë më të lartë tek Allahu)..." (Ankebut, 45)

Me fjalë të tjera, themi se qëllimi i namazit është adhurimi dhe lidhja me Zotin, Krijuesin e gjithësisë. Gjithashtu, ai ka për qëllim, si çdo adhurim tjetër, largimin dhe ruajtjen nga çdo gjë e keqe që na ka ndaluar Allahu, pra namazi synon arritjen e devotshmërisë.

Gjithashtu, Allahu i Lartësuar në historinë e Shuajbit, (a.s.), kur populli i tij me tallje i thotë: **"O Shuajb! A mos vallë namazi yt po të urdhëron që ne t'i braktisim ata që i kanë adhuruar prindërit tanë, ose (po të urdhëron) të mos bëjmë me pasurinë tonë çfarë të duam? Me të vërtetë, ti qenke i butë e i mençur."** (Hud, 87), na tregon se namazi të largon nga veprat e liga, pra të bën të devotshëm.

Allahu i Madhëruar, në ajetet 196-197 të suretu'l-Bekare, kur flet për haxhin, pelegrinazhin - vizitën në (Qabe) Shtëpinë e Lashtë e të Shenjtë në Mekë, pasi shpjegon mënyrën e riteve që kryhen atje, e mbyll fjalën e tij, duke thënë: **"Dhe, kini shumë frikë ndaj Allahut** (jini të devotshëm) **dhe dijeni se Ai është i ashpër në ndëshkim. Dhe përgatituni për udhëtimin, por përgatitja më e mirë është devotshmëria. Kështu pra, m'u frikësoni Mua, o ju (njerëz) që kuptoni."** Pra, qëllimi i përgatitjes për në haxh dhe kryerja e saj në mënyrë të plotë dhe pa bërë asnjë nga veprat që ndalohen gjatë kësaj kohe në atë vend të shenjtë, është arritja e devotshmërisë.

Gjithashtu, obligimi i haxhit ka edhe urtësi të tjera si:

Së pari: Përmbushja e urdhit të Allahut me vërtetësi në njëshmërinë e Tij dhe adhurimi i çiltër e i sinqertë për Të, të cilat gjatë haxhit pasqyrohen në nivelet më të larta. Haxhi është nënshtrim dhe përlulje, distancim nga dynjaja, duke emigruar nga kënaqësitë e saj drejt Zotit. Ai është dorëzim para madhërisë së Tij, duke braktisur përkohësisht familjen, kënaqësitë bashkëshortore, stolisjet dhe parfumosjen, pasurinë, atdheun. Njeriu arrin devotshmërinë, i zhveshur nga rrobat e tij, me kokë të zbuluar, modest dhe zhvendoset nga njëri rit tek tjetri me zemër të përlulur, me sy të përlotur, me gjuhë që përmend Allahun, duke shpresuar në faljen dhe mëshirën e Tij.

Së dyti: Edukimi me cilësinë e shfrytëzimit të kohës, që është kapitali më i çmuar i njeriut dhe që duhet ruajtur nga shpërdorimi apo neglizhimi. Gjatë ditëve të pakta të haxhit njeriu kryen vepra të mëdha, në vende të ndryshme. Kjo tregon se njeriu ka një potencial të madh

veprimi, përmes të cilit, nëse e kultivon dhe e shfrytëzon, do arrijë fryte të shumëfishuara. Kjo duhet ta edukojë myslimanin në zakonin e shfrytëzimit të kohës.

Edhe qëllimi i therjes së kurbanit (sakrifica me të cilën robi synon afrimin të Allahut) është arritja e devotshmërisë. Për këtë, Allahu i Lartësuar i Begatë na thotë: **“Tek Allahu nuk arrin as mishi e as gjaku i tyre** (i bagëtive për kurban), **por të Ai arrin bindja** (përkushtimi) **juaj. Kështu, Ai i ka vënë ato në shërbimin tuaj, që ju ta madhëroni Allahun, sepse ju ka udhëzuar. Dhe jepu lajm të mirë punëdrejtëve** (bimirësve).” (Haxhxh, 37)

DOBITË

Ndërsa, për dobitë e adhurimeve në Islam mund të përmendim:

NAMAZI

Namazi shlyen gjynahet dhe gabimet. Profeti, salallahu alejhi ue selem, ka thënë: *“Çfarë mendoni sikur një lumë të kalonte pranë derës së ndonjërit prej jush dhe të lahej në të pesë herë në ditë? A do të mbetet diçka e papastër në trupin e tij?”* Thanë: “Jo, nuk mbetet asgjë e papastër në trupin e tij.” Ai (a.s.), tha: *“Ja, ky është shembulli i pesë kohëve të namazit, Allahu fshin me to gjynahet.”* (Transmeton Buhariu)

Në një hadith tjetër, ka thënë: *“Pesë kohët e namazit, xhumaja deri në xhuma dhe ramazani deri në ramazan, nëse braktisen gjynahet e mëdha, janë shlyerëse të gjynaheve ndërmjet (në periudhat mes) tyre.”* (Transmeton Muslimi)

Ebu Dherr Gifari, (r.a.), thotë se një ditë vjeshte, kishim dalë në rrugë bashkë me Profetin, (a.s.). Gjethet binin. Nga një pemë u thyen dy degë. Gjethet e tyre menjëherë u shpërndanë. Profeti, (a.s.), tha: *“O Ebu Dherr! Kur myslimani fal namaz për kënaqësi të Allahut, (xh.sh.), i hiqen (bien) gjynahet ashtu siç u shkundën gjethet e këtyre degëve.”* (Transmeton Ahmedit)

Ndërsa, Ibn Mes’udi, (r.a.), tregon se një njeri kishte puthur një grua të huaj. Erdhi te Profeti, (a.s.), që të pastrohej (i penduar për atë gjynah). Atëherë Allahu, (xh.sh.), shpalli ajetin: **“Fale namazin ditën dhe natën, vërtet punët e mira i shlyejnë punët e këqija.”** Njeriu atëherë i tha Profetit, (a.s.): *“A vlen kjo vetëm për mua?”* Profeti, (a.s.), iu përgjigj: *“Është për mbarë umetin tim!”* (Transmeton Buhariu dhe Muslimi)

Namazi bëhet shkak për fitimin e mëshirës së Allahut, (xh.sh.). Ubade bin Samit, (r.a.), na njofton se Profeti, (a.s.), ka thënë: *“Allahu i Madhëruar ka urdhëruar të falen pesë vaktet e namazit. Ai që merr abdest të plotë dhe këto i fal në kohën e duhur dhe, nëse rukutë i bën të plota (të sakta), Allahu e ka dhënë fjalën se atë do ta mëshirojë. Për atë që nuk i bën këto, nuk ka dhënë fjalë: nëse do, Allahu e fal edhe atë e, nëse nuk do, e dënon.”* (Trans-

meton Ahmedit, Ebu Davudi dhe Nesaiu)

Namazi bëhet dritë dhe shpëtim në Ditën e Kiametit, ndërsa moskryerja bëhet shkak për humbjen e personit. Zejd bin Halid Xhuhejn, (r.a.), na tregon se Profeti, (a.s.), ka thënë: *“Atij që namazin e vet e fal në kohën e duhur, ky namaz Ditën e Kiametit i bëhet dritë dhe argument (dëshmi) dhe është arsye për ta shpëtuar nga Xhehen-nemi. Nëse nuk kujdeset për namazin, nuk i bëhet dritë dhe argument dhe nuk gjen shpëtim. Ai do të jetë bashkë me Karunin, Faraonin, Hamanin dhe Ubej bin Halefîn.”* (Transmeton Ahmedit dhe Darimi)

Ibn Kajjimi, duke komentuar këtë hadith, thotë: *“Ai që largohet nga falja për shkak të dëshirës për pushtet, do të jetë i ringjallur pranë Faraonit; ai që e ka lënë namazin nga dëshira për pasuri, do të ringjallet pranë Karunit; atë që kryelartësia dhe pozita e kanë penguar nga falja, do të ringjallet në shoqëri të Hamanit; ndërsa, nëse është penguar nga namazi për shkak të tregtisë, atëherë do të ringjallet pranë Ubej b. Halefit.”*

Namazi është shkak për të qenë prej banorëve të Xhenetit. Profeti, (a.s.), ka thënë: *“Kush përkujdeset për pesë vaktet e namazit: për rukutë, sexhdet, abdestin dhe kohët e tyre; si dhe e di se ato janë obligim prej Allahut, do të hyjë në Xhenet.”* Ose ka thënë: *“Xheneti është bërë obligim për atë (hyrja në të).”* (Transmeton Ahmedit)

Gjithashtu, Ebu Hurejre (r.a.), transmeton: *“Erdhi një njeri te Profeti, (a.s.), e i tha: “O i Dërguari i Allahut, më trego një punë që, nëse e bëj të më çojë në Xhenet. Profeti, (a.s.), i tha: “Të adhurosh Allahun e Lartmadhëruar, dhe të mos i shoqërosh Atij asgjë, të falësh namazin, të japësh zekatin, dhe të agjërosh Ramazanin.”* Njeriu tha: *“Pasha Atë, në dorën e të Cilit është shpirti im, nuk do të shtoj gjë mbi këto që më the.”* Pasi iku, Profeti, (a.s.), tha: *“Kush dëshiron të shikojë një njeri xheneti (që është prej banorëve të xhenetit), le ta shikojë këtë burrë.”* (Transmeton Buhariu dhe Muslimi)

Në një transmetim tjetër, Ebu Hurejre, (r.a.), tregon: *“Ishim ulur një ditë me Profetin, (a.s.), i cili tha: “Pasha Atë, në dorën e të Cilit është shpirti im!” dhe këtë e përsëriti tri herë. Pastaj filloi të qante. Edhe ne filluam të qanim, pa e ditur se për se u betua. Pastaj ngriti kokën dhe në fytyrën e tij u duk gëzimi. Kjo gjë ishte më e dashur për ne, sesa devetë e kuqe. Atëherë, Profeti, (a.s.), tha: “Atij njeriu që fal pesë namazet, agjëron Ramazanin, jep zekatin dhe ruhet nga shtatë gjynahet e mëdha, do t’i hapen dyert e Xhenetit dhe do t’i thuhet, hyr me selam.”* (Transmeton Nesai dhe Ibn Maxhe)

Namazi ia përmirëson sjelljen njeriut. Ai ia përsos natyrën, e pengon nga prishja dhe devijimi i tij; dhe e largon nga imoraliteti dhe punët e këqija. **“Vërtet që namazi të ruan nga shthurja dhe nga çdo vepër e shëmtuar.”** (Ankebut, 45)

vijon në numrin e ardhshëm...



NJERIU MODEL PËR SHËRBIMIN FETAR

Prof. dr. Hasan Kamil Jëllmaz

Shërbimi fetar është detyrë e trashëguar nga profetët, që kanë qenë mësuesit dhe shërbyesit e parë të fesë në tokë. Të gjithë pejgamberët pa përjashtim, e kanë kryer me rigorozitetin më të madh këtë shërbim të nderuar, duke ua lënë amanet trashëgimtarëve. Dijetarët, në cilësinë e trashëguesve të pejgamberëve, e kanë konsideruar të shenjtë shërbimin fetar. Kjo gradë është e lidhur direkt me edukimin dhe të qenët model në ofrimin e shërbimit fetar. Formimi i njeriut model, që parashikon shërbimi fetar, është i lidhur ngushtë me cilësinë në vepra, bukurinë në moral, çiltërsinë në zemër, nurin në fytyrë, elegancën në të folur, ndjeshmërinë në ndjenja dhe largpamësinë në gjykim. Prandaj, personit që do të kryej shërbimin fetar, i duhet një besim i shëndoshë dhe një jetë e rregullt adhurimi. Ai që pretendon të marrë përsipër edukimin e të

tjerëve, së pari duhet të edukojë veten e tij. Sepse, për të përgatitur nxënës të shkëlqyer, duhet mësues i shkëlqyer. Rruga që të çon drejt suksesit në këtë profesion është sinqeriteti, dashuria dhe entuziazmi. Shërbimi fetar merr trajtë të plotë vetëm përmes dashurisë, sepse rruga e vetme për në zemër është dashuria. Personi që mbart kauzën islame duhet të pushtojë zemrat e njerëzve me dashuri. Njeriu motivohet në punën e tij nga entuziazmi, prandaj personi që kryen shërbimin fetar duhet të ndezë entuziazmin tek njerëzit dhe jo ta fikë atë.

Ushqimi hallall ka një rol shumë të rëndësishëm në formimin e një personaliteti të shëndoshë islam, prandaj njerëzit e fesë duhet të tregojnë kujdes në ushqimin e tyre. Ata duhet të qëndrojnë larg çdo lloj ushqimi që dëmton shëndetin e njerëzve, por në të njëjtën kohë, duhet të distancohen edhe nga ushqimi

met haram, që dëmtojnë shëndeti shpirtëror. Një llokmë haram në bark, është si një pjesë e kalbur në brendësi të pemës. Ngaqë fuqia dhe ndikimi i fjalës vjen nga përputhja e besimit me veprat, njerëzit e fesë duhet t'i kushtojnë shumë vëmendje gjendjes shpirtërore. Allahu në Kuran përcakton si fjalë të bukur fjalën që flet për Allahun dhe që shoqërohet me vepra të mira: **“E kush flet më bukur se ai që i fton njerëzit drejt Allahut, bën vepra të mira dhe thotë: ‘Unë, me të vërtetë jam mysliman.’”** (Fussilet, 33)

Vepra dhe punët e mira e mbajnë të gjallë e entuziast njeriun. Njeriu që nuk ka entuziazëm për punën që bën, e humbet gjallërinë dhe dinamizmin e punës. Personi që i shërben fesë, është i vetëdijshëm se kapaciteti i tij është në përpjesëtim të drejtë me synimet që ka. Në këtë mënyrë, ai pyet veten rreth arsyes së ekzistencës së tij dhe rolit që ka në këtë gjithësi dhe sipas përgjigjes, përcakton edhe synimet e tij. Lumturia më e madhe e njeriut është përcaktimi i qëllimeve të mëdha dhe përpjekja për arritjen e tyre. Puna pa qëllime dhe pa plane të përcaktuara qartë nuk mund të jetë frytdhënëse. Qëllimet dhe synimet e mëdha japin përfundime të mëdha. Të suksesshëm janë ata që e dinë rrugën ku do të shkojnë, sepse ai që e di çfarë kërkon, e gjen lehtë atë që do.

Njeriu i fesë gjykon vazhdimisht veten dhe veprat e tij. Në vetëgjykimin e tij shfaqet përherë pyetja: “Çfarë bëra sot për Allahun dhe nga ato që bëra, sa i dedikohen Atij?” Njeriu i fesë duhet t'i gjykojë veprat para dhe pas kryerjes.

Njeriu i fesë ka një kauzë të shenjtë. Problemi i tij i vetëm është përmirësimi i gjendje së myslimanëve, kudo që janë në botë. Nga shqetësimet që ka për çështjet e umetit, atij nuk i hyn gjumi në sy.

Njeriu i fesë punon dhe vepron në formën më të mirë të mundshme, në përputhje të plotë me ajetet, të cilat urdhërojnë për punë cilësore dhe hadithin e Pejgamberit (a.s.): *“Allahu e do atë që, kur merr përsipër një punë, e bën më së miri.”* (Musned, I, 157)

Si çdo person, që ekspozon mallin e prodhuar edhe teologu islam ekspozon njerëzit që ka edukuar.

Teologu është vazhdimisht në përmirësim të vetes. Ai nuk duhet të mjaftohet asnjëherë me atë që zotëron. Kush nuk përtërihet, është i destinuar të mundet. Kurse, kush përtërin veten, lartësohet. Dituria është një nevojë e natyrshme e njeriut, kurse kulmi i diturisë është njohja e Allahut.

Njeriu i fesë nuk duhet të kufizohet vetëm me fu-

shën profesionale përkatëse; përkundrazi, fushat e interesimit të tij duhet të jenë të gjitha bukuritë dhe urtësitë e botës. Ai di të lexojë natyrën dhe veten e tij. Teologu islam nuk duhet të jetë vetëm një transmetues informacioni, por një edukator dhe udhëzues, që kultivon në zemrat e njerëzve sinqeritet, çiltërsi dhe që hap horizontet e zgjeron interesin për qëllimin e krijimit.

Nëse njeriu i fesë ka egoizëm, atëherë nuk mund të bëhet fjalë për shërbim fetar. Njerëzit largohen sa të munden prej egoistëve. Rruga për të shpëtuar nga egoizmi është pastrimi shpirtëror. Përmes pastrimit shpirtëror, njeriu kupton se çdo gjë i përket Allahut. Ajo që duhet të bëjë ai, është vetëm të fitojë pëlqimin dhe dashurinë e Tij. Njeriu i fesë vepron në mënyrë individuale, por vazhdimisht këshillohet me bashkëpunëtorët që ndajnë të njëjtat qëllime. Në këtë mënyrë, fitojnë disiplinën e punës në ekip.

Teologu islam duhet të vlerësojë dhe administrojë mirë kohën. Në suren Asr, Allahu betohet në kohën për humbjen e sigurt të njeriut. Faktori kryesor që e çon njeriun në humbje, është mosvlerësimi dhe keqpërdorimi i kohës. Sot, në botën moderne, për të shprehur rëndësinë e kohës është përhapur shumë termi “time management” (menaxhimi i kohës). Planifikimi i kohës shpreh bërjen e gjërave në kohën e duhur.

Njeriu i fesë duhet të kultivojë tek njerëzit dashuri dhe entuziazëm. Duhet të jetë në pozicionin e një dashurie monumentale, e cila ndez njerëzit. Teologu që ka dashuri dhe mëshirë, së pari arrin në zemrat e bashkëbiseduesve; prej aty arrin të hyjë në mendjet e tyre. E rëndësishme është të hysh në zemra, sepse, nëse nuk hyn në zemrat e njerëzve, nuk mund të hysh kurrë në mendjet e tyre.

Rruga për të fituar njerëzit kalon përmes zgjidhjes së problemeve të tyre dhe kjo kërkon sakrificë, vetëmohim, preokupim dhe altruizëm.

Hyrja në zemër arrihet përmes dashurisë, kurse shenja e dashurisë është bindja dhe sakrifica në rrugë të asaj që do. Nëse në themel të sjelljeve qëndron dashuria, atëherë aty ka sinqeritet, çiltërsi dhe begati. Kur veprat realizohen mbi themelin e dashurisë, hyjnizohen. Shërbyesi fetar transmeton karakter dhe ngjall admirim te bashkëbiseduesit. Karakteri i personit që ka marrë përsipër t'i shërbejë fesë është i një rëndësie të veçantë, sepse shpreh konsekuencën dhe koherencën e sjelljeve. Në marrëdhëniet njerëzore, parësore është drejtësia, siguria, besueshmë-

ria dhe vërtetësia. Njerëzit admirojnë gjenialitetin, por ndjekin gjithmonë njeriun më me karakter. Njeriu i fesë duhet të ngjallë interes tek bashkëbiseduesi, përmes personalitetit dhe karakterit. Shërbyesi i fesë është udhëzues, jo autoritar, është karizmatik dhe simpatik. Edukimi nuk realizohet me fjalë apo me force, por duke qenë shembull në atë që predikon. Njeriu i fesë duhet të pasqyrojë energji pozitive dhe shpirtërore. Ai nuk duhet ta harrojë asnjëherë identitetin shpirtëror që ka.

Shërbyesi fetar duhet të zotërojë edhe cilësitë e liderit, kurse lideri nga ana e tij duhet të ketë dy cilësi: e para, të marrë përsipër rrisht, gjë që shpreh guxim, vetëbesim dhe vendosmëri dhe e dyta është bujaria, e cila shpreh interesimin për të tjerët. Njeriu bujar është i qetë dhe i lumtur. Kurse lumturia e vërtetë fillon duke bërë të tjerët të lumtur. Dera dhe zemra e një njeriu, që ndan gëzimet dhe hidhërimet me të tjerët, është gjithmonë e hapur.

Njeriu i fesë nuk pret përfitime materiale nga kjo punë. Ai merr pjesë intensivisht në problemet dhe shqetësimet e njerëzve. Muhamedi (a.s.), herë pas herë pyeste: *“Kush prej jush ka përkëdhelur një jetim, ka shoqëruar një xhenaze apo ka vizituar një të sëmurë?”* (Taberani, Sahihul xhami, 80)

Njeriu i fesë përpiqet të mbajë marrëdhënie të mira me të gjithë. Për mbarëvajtjen e shërbimeve fetare, krahas sinqeritetit duhet edhe mirësjellje. Njeriu fetar duhet të qëndrojë larg vrazhdësisë. Fytyra e tij duhet të shprehë buzëqeshje dhe dashamirësi, sepse ashpërsia e tepërt sjell urrejtje, kurse toleranca e tepërt sjell dobësim të autoritetit. Suksesi qëndron në gjetjen e rrugës së mesme.

Thirrja e Musait (a.s.), karakterizohej nga përpikmëria dhe ndershmëria, thirrja e Isait (a.s.), nga dashuria, kurse Pejgamberi (a.s.), përveç këtyre shtoi drejtësinë, barazinë dhe rrugën e mesme. Kur mirësjellja shoqërohet me fjalë të ëmbla dhe të rrjedh-

shme, bën më shumë jehonë në zemra.

Për këtë arsye, shërbimi fetar nuk duhet ofruar me fjalë të rastit, por me një gjuhë të zhdërvjellët, të urtë, të bukur dhe mbresëlënëse. Zgjedhja e gjuhës në komunikimin fetar është urdhër hyjnor: **“Thirr në rrugën e Zotit tënd me mençuri dhe këshillë të bukur dhe diskuto me ata në mënyrën më të mirë.”** (En-Nahl, 125) **“Këshilloji dhe thuaju fjalë që i prekin në zemër.”** (Nisa, 63)

Një tjetër veçori e njeriut të fesë është mirëkuptimi përballë gabimeve të ndryshme të njerëzve. Rruga më e lehtë në marrëdhëniet njerëzore është

ndjekja e dëshirave, të cilat fajësojnë të tjerët, duke e nxjerrë veten të pafajshëm. Në këtë mënyrë u jepet fund marrëdhënieve njerëzore. Të pranosh gabimet tuaja, është punë e vështirë, por është një sjellje dinjitoze. Njeriu i fesë, i pajisur me këtë sjellje, nuk i përgjigjet së keqes me të keqe, por me të mirë. Në lidhje me këtë rast, Kurani thotë: **“Nuk barazohet e mira me të keqen! Të keqen ktheje me të mirë e atëherë armiku yt do të të bëhet menjëherë mik i ngushtë.”** (Fusilet, 34)

E keqja kapërcehet vetëm me cilësi të mira, si: duke përdorur urtësinë përballë injorancës, durimin përballë vështirësive dhe faljen përballë së keqes. Fjala e Mevlanës është shumë domethënëse në këtë

kontekst: *“Shpata e urtësisë është më e mprehtë se shpata e zemërimit.”* Shërbyesi i fesë duhet të përshkohet nga empatia, përpjekja për të njohur dhe përjetuar ndjenjat e tjetrit, nga dëshira për të bërë për të tjerët atë që dëshiron për vete.

Si përfundim, shërbimi fetar është një punë që kërkon durim dhe qëndrueshmëri. Në shërbimin ku shfaqen padurimi dhe pakënaqësitë, është e pamundur arritja e përfundimeve të kënaqshme. Prandaj ky shërbim, në radhë të parë kërkon dashuri dhe përpjekje, ndërsa suksesi është prej Allahut.



NJERIU NË ETAPËN ESTETIKE

Nuredin Nazarko

Sipas filozofit ekzistencialist Kirkegard, njeriu përgjatë jetës së tij përballet me tri etapa; etapa estetike, etapa etike, etapa fetare si niveli më i lartë në jetën e njeriut. (Shih më gjerësisht, Stumpf, E.S. *Filozofia, historia & problemet (libri I)*. Tiranë: Toena, f. 448 -450.) Duhet mbajtur parasysh që njeriu është një qenie e paparashikueshme dhe që jeta e tij nuk mund të rrjedhë sipas një recete të caktuar. Përmbysjet janë të zakonshme në jetën e njeriut dhe çdokush është i ekspozuar ndaj situatave që mund ta ndryshojnë rrënjësisht rrjedhën e jetës së tij në përkohësi. Duke qenë se jeta e njeriut nuk mund të rrjedhë në mënyrë të skematizuar, edhe pse nuk mungojnë përpjekjet në këtë sferë, njeriu është i ekspozuar në çdo çast të jetës së tij ndaj përjetimit të njëjës apo tjetrës etapë, përdërisa nuk ka një linjë vertikale konstante dhe statike të kalimit të njeriut nga etapa më e ulët në etapën më të lartë. Kësisoj mbërritja në etapën fetare, edhe pse është etapa më e lartë, nuk do të thotë se njeriu do të mund ta mbyllë me siguri jetën e tij me këtë etapë. Çdokush mund të përjetojë njëjën

apo tjetrën etapë, por mund të ketë dhe ecuri vertikale. Mundësitë shtrihen përballë njeriut dhe është po vetë njeriu që do të marrë vendimin për përfshirjen e tij në njëjën apo tjetrën etapë, në momentin që arsyetimi i tij kalon në stadin e të qenit përgjegjës për vendim-marrjen. Edhe pse përballë njeriut qëndrojnë tri etapa, në ditët e sotme etapa që po dominon më së tepërmi, është etapa estetike. Por cilat janë karakteristikat e etapës estetike dhe pse pikërisht dominon kjo etapë në jetët e shumë njerëzve?

Në këtë nivel njeriu sillet sipas impulseve dhe emociioneve të tij. Megjithëse ai nuk është thjesht sensual në këtë etapë, në pjesën më të madhe ai drejtohet nga shqisat e tij. Për këtë arsye, njeriu estetik nuk di asgjë për standartet morale universale. Ai nuk ka ndonjë besim fetar të veçantë. Motivi kryesor i tij është dëshira për të shijuar larminë më të madhe të kënaqësive nga shqisat. Jeta e tij nuk ka parim kufizimi përveç shijes së tij; ai e urren çdo gjë që do ta kufizonte lirinë e tij të pamasë për zgjedhje. (Po aty, f. 448.)



“Në këtë nivel njeriu sillet sipas impulseve dhe emocioneve të tij. Megjithëse ai nuk është thjesht sensual në këtë etapë, në pjesën më të madhe ai drejtohet nga shqisat e tij.” Njeriu i këtij niveli, bazament të sjelljes ka impulset dhe emocionet. Janë pikërisht këto që e drejtojnë në fjalët dhe veprimet e tij. Kjo do të thotë që njeriu që vepron nën efektin e impulseve dhe emocioneve nuk lë aspak hapësirë për arsyeshmërinë, madje kjo e fundit as që i nevojitet në këtë rast. Jo se emocionet dhe impulset dhe shqisat nuk kanë rëndësinë e tyre për njeriun, por nuk duhet të jenë ato busulla që orienton njeriun në sjelljet dhe veprimet e tij, përndryshe ajo çka është më e lartë tek njeriu do t'i nënshtrohet asaj që është më e ulët.

“Për këtë arsye njeriu estetik nuk di asgjë për standartet morale universale.” Duke u udhëhequr kryekëput nga emocionet dhe perceptimet shqisore që nuk të sigurojnë njohjen e njëmendtë, njeriu i etapës estetike nuk njihet dhe madje as që do që t'i njohë standartet morale universale. Njohja e standarteve morale, me një njohje të njëmendtë, nuk mund të vijë ndryshe vetëm se nëpërmjet njohjes së burimit të moralit. Këto standarte qëndrojnë në mbi emocionet, impulset apo perceptimet shqisore, sepse dhe burimi i tyre nuk është aspak i natyrës emocionale, impulsive dhe shqisore. Njeriu i etapës estetike i kokolepsur në rrjetën e shtysave emocionale dhe shkëlqimit përjashtësor shqisor e ka gati të pamundur të njohë dhe kuptojë se çfarë janë standartet morale, sepse tek ai ajo çfarë është më e ulët nuk mund ta përfshijë atë që është më e lartë.

“Ai nuk ka ndonjë besim fetar të veçantë.” Njeriu i kësaj etape nuk deklarohet si i thhtar i mirëfilltë i asnjë besimi fetar. Pavarësisht deklarimeve se i përket këtij apo atij besimi fetar, njeriu i kësaj etape nuk njihet dhe zbaton as elementët më qenësorë të besimit fetar që deklarohet se i përket. Kjo do të thotë që ai është tërësisht i painteresuar rreth parimeve që një besim fetar kërkon të zbatohen në jetën e përditshme. Rrjedhimisht njerëzit e kësaj etape janë bashkëngrënës dhe bashkëpirës të së njëjtës tryezë, pavarësisht mëtimit të tyre për përkatësi ndaj njërit apo tjetrit besim fetar.

“Motivi kryesor i tij është dëshira për të shijuar larminë më të madhe të kënaqësive nga shqisat.” E veçanta e njeriut si qenie është se ai mund t'i vendosë vetes qëllime për t'i arritur dhe realizuar. E natyrisht që të ndjekësh rrugëtimin e mbërritjes tek qëllimi që i ke përcaktuar vetes, duhet një shtysë, një motiv që të

prodhojë energji të atillë që ta mposhtë dembelizmin, përtacinë dhe rehatinë, si faktorë pengues të realizimit të qëllimit. Duke qënë se njeriu i etapës estetike në themel udhëhiqet nga emocionet, impulset dhe perceptimet shqisore, atëherë edhe qëllimi i tij më i lartë do të jetë pikërisht, arritja e kënaqësisë më të madhe që i lejojnë shqisat të arrijë, pa u vramundur për standartet morale, pasi siç u përmend ky njeri nuk njihet asnjë standart moral. Mbërritja në majën e kësaj piramide kënaqësie është motivi që vendos në lëvizje energjitë e këtij njeriu, i cili beson se energjitë e tij po udhëzohen në kahjen e duhur, për të qenë sa më i kënaqur, rrjedhimisht sa më i lumtur, sipas perceptimit të po vetë atij.

“Jeta e tij nuk ka parim kufizimi përveç shijes së tij; ai e urren çdo gjë që do ta kufizonte lirinë e tij të pamasë për zgjedhje.” Njeriu i etapës estetike duke mos njohur asnjë standart moral, nuk njihet as kufizime, sepse kufizimet në jetën e njeriut mund të vendosen vetëm

në qoftë se fjalët dhe veprimet udhëhiqen nga standartet morale. I vetmi kufizim për këtë soj njeriu është kufizueshmëria e natyrës njerëzore. Për të nuk ka dhe nuk ka pse të ketë kufizime, përderisa ai beson se është i lirë të flasë dhe veprojë si të dëshirojë. Ai është i predispozuar të kryejë çdo lloj vepre, përderisa të ketë mundësinë për ta kryer këtë vepër. Për këtë njeri nuk ka dilema morale në brendësinë e tij, pasi që nuk njihet kufizime.

Është pikërisht kjo arsyeja, pra kufizueshmëria, që ai ndjen neveri ndaj moralitetit dhe as që dëshiron t'i njohë standartet morale. Kjo, sepse sipas tij, kufizueshmëria që vjen nga standartet morale vetëm e dëmton cilësinë e jetës së tij dhe nuk i japin shansin që të përnjështohet me narcizmin dhe hedonizmin, aq të dashura për një njeri emotiv.

Kjo lloj mënyrë e të jetuari është tepër joshëse për natyrën e njeriut, i cili është i mikluar nga prezenca e elementëve të tillë në jetën e tij. Pakufizueshmëria në fjalë dhe veprime duket si rruga më e lehtë për marrjen e kënaqësisë nga kjo jetë dhe është pikërisht kjo arsyeja që shumë njerëz zgjedhin të shkelin këtë rrugë në përkohësi, sepse të kufizosh veten nëpërmjet standarteve morale është me të vërtetë një sfidë, që jo gjithkush mund ta marrë përsipër ta jetësojë këtë mënyrë të jetuari. Si rrjedhojë e këtij mirazhi (*dukja e pakufizueshmërisë si rruga më e lehtë*) shumë prej njerëzve rendin si i eturi në shkretëtirë për të arritur ujën në horizont, pa e ditur se kë do të gjejnë atje.

“Në këtë nivel njeriu sillet sipas impulseve dhe emocioneve të tij. Megjithëse ai nuk është thjesht sensual në këtë etapë, në pjesën më të madhe ai drejtohet nga shqisat e tij.”

EKONOMIA TURKE

ECURI DHE SFIDA

Idlir Bekteshi

Historia ka njohur vende që kanë pasur rritje të lartë ekonomike, e cila është shoqëruar me rritje të mirëqenies sociale. Perandoria Osmane ishte një nga shembujt e këtij modeli ekonomik të suksesshëm që krijoi rritje ekonomike stabël dhe mirëqenie sociale përgjatë 500 viteve. Karakteristika të përbashkëta të këtyre historive të suksesit ishin aplikimi me rigorozitet i të drejtës së pronës, sensi i fortë i drejtësisë dhe trajtimi pa dallim i qytetarëve, alokimi eficient i burimeve, stimulimi i novacioneve teknologjike, mendje e hapur për reforma kur ndryshimet janë të nevojshme dhe gatishmëri për të qenë fleksibël në rast ristrukturimesh dhe riorganizimesh për t'iu adaptuar ndryshimeve të shpejta globale. Rënia e Perandorisë Osmane u shkaktua pikërisht nga humbja e këtyre cilësive të domosdoshme për zhvillim të qëndrueshëm dhe stabilitet ekonomik.

Gjatë viteve të para të Republikës së Re Turke stabiliteti ekonomik dhe financiar nuk bënin pjesë fare në sfidat e postpavarësisë. Prioritet në këtë periudhë ishte parandalimi i urisë, në mënyrë që të ruheshin ekuilibrat socialë pas shumë vite konfliktesh që kishin shkatërruar pjesën më të madhe të kapitalit njerëzor. Mbi të gjitha, trashëgimia kryesore nga perandoria. Një nga humbësit kryesorë të Luftës së Parë Botërore, ishte një borxhli i jashtëm marramendës. Kushtet ishin të atilla, që luftohej vetëm për mbijetesë.

Nuk ishte vetëm mungesa e burimeve në rang kombëtar që krijonte pengesa për zhvillim të qëndrueshëm gjatë atyre viteve, por kësaj i shtohej edhe situata ekonomike ndërkombëtare, e cila gjithashtu ishte në vësh-

tirësi serioze. Kriza ekonomike e vitit 1929 në SHBA rriti gjithashtu koston e huamarrjeve nga jashtë dhe, sapo kjo krizë mori fund, filluan trazirat sociale në Europë, që çuan në Luftën e Dytë Botërore.

Që nga Pavarësia në vitin 1923 deri në vitin 2000, kur Republika e Turqisë aplikoi për anëtarësi në Bashkimin Europian ekonomia e vendit u karakterizua nga luhajtje të konsiderueshme. Vështirësi serioze paraqiteshin në vitet e para pas pavarësisë. Më konkretisht, në vitet 20, 77% e popullsisë jetonte në fshat, 82% e popullsisë aktive merrej me bujqësi, 6% me industri, 5% me tregti dhe 7% ishte e angazhuar me sektorin e shërbimeve. Industria zinte vetëm 10% të të ardhurave kombëtare, kurse bujqësia 67%. Gjithsesi prodhimi bujqësor ishte mjaft primitiv. Në vitet e para të Republikës kishte vetëm 220 traktorë. Industria përballonte vetëm nevojat bazë të popullsisë, e cila mezi plotësonte nevojat bazë për ushqim.

Vitet '50 konsiderohen si dekada e parë kur në vend u shfaqën shenjat e para të rimëkëmbjes ekonomike. Fatkeqësisht, një grusht shteti ushtarak e ndërpreu për një kohë të shkurtër procesin. Gjatë viteve '60 të ekonomisë së centralizuar u akumulua një sasi kapitali që bënte të mundur një stabilitet afatgjatë ekonomik e financiar. Megjithatë, dy krizat e çmimit të naftës në vitet '70 rritën varësinë e ecurisë së rritjes ekonomi-




ke nga fondet e huaja. Reformat e viteve '80 mundësuan rritje të konsiderueshme për pak vite, por patën edhe efekte anësore të cilat çuan në krizën bankare të vitit 1983. Megjithatë, ringritja ishte e shpejtë dhe vendi vazhdoi rritjen edhe për një dekadë tjetër. Liberalizimi financiar solli efekte anësore, të cilat çuan në një tjetër krizë bankare në vitin 1994. Me rikuperimin edhe nga kjo e fundit, që nga viti 2001 vendi ka ndërmarrë një proces të pandërprerë reformash dhe ristrukturimesh në ekonomi.


Vitet 2000 janë vitet kur rimëkëmbja ekonomike e Turqisë është evidente. Grafiku më poshtë paraqet ecurinë e GDP gjatë viteve 2004 - 2012. Për saqrim, GDP janë inicialet në anglisht për Gross Domestic Product – Prodhimi i Brendshëm Bruto, i cili mat vlerën e të gjitha produkteve dhe shërbimeve të prodhuara gjatë një viti në një vend të caktuar. Sot vlerësohet që industria zë 27% të të ardhurave kombëtare, bujqësia 9,1%, kurse shërbimet 63,9%




Për ta ilustruar më mire, kemi më poshtë po ashtu ecurinë e GDP per capita, që është GDP për frymë të popullsisë.



Sipas Organizatës për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik OECD, Turqia është vendi me rritjen e pritshme më të lartë të GDP për vitet 2012 – 2017 mes një numri të konsiderueshëm vendesh të marra në shqyrtim. Më poshtë grafiku i publikuar nga Organizata e sipërpërmendur, ku në boshtin horizontal janë vendet e marra në shqyrtim, kurse në atë vertikal rritja e parashikuar e GDP në përqindje.



A silhouette of a person in profile, facing right, in a prayerful pose. They are holding a string of prayer beads (tasbeeh) in their right hand. The background is a soft, hazy sunset or sunrise over a body of water, with a gradient from dark green to light yellow. The overall mood is serene and contemplative.

Jonida Vishkurti

*Rëndësia dhe vlera
e namazit të natës.*

Allahu është Krijuesi i Gjithësisë, Krijuesi i gjithçkaje që arrijnë të perceptojnë shqisat tona. Ai e krijoi njeriun në disa faza, nga një pikë uji e deri në një copë mishi dhe i dha formën më të bukur duke e lartësuar ndër krijesat e tjera. Andaj, ti o njeri kthehu nga Zoti yt me falje e pendim, me përkushtim e devotshmëri që të gjesh një ardhmëri më të mirë tek i Gjithëpush-tetshmi. Allahu në Kuranin Famëlartë thotë:

“O ju njerëz! Kini frikë Zotin tuaj që ju ka krijuar prej një veteje (njeriu) dhe nga ajo krijoi palën (shoqën) e saj e prej tyre u shtuan shumë burra e gra. Dhe kini frikë Allahun, që me emrin e Tij përbetoheni, ruajeni farefisn (akraballëkun), se Allahu është mbikëqyrës mbi ju.” (Nisa,1)

“Unë nuk i krijova xhindët dhe njerëzit për tjetër, vetëm që të më adhurojnë.” (Dharijat,56)

Këto dy perla nga Kurani Fisnik shprehin qartë qëllimin e krijimit të njeriut, që nuk është tjetër veçse adhurimi dhe madhërimi i Allahut Fuqiplotë përmes adhurimeve të shumta. Ndër adhurimet përmendet edhe namazi, shtylla e dytë e fesë islame, e cila ka një vlerë dhe rëndësi të madhe në Islam. Ndër namazet vullnetare përmendet edhe namazi i natës, i cili ka një shpërblim të madh nga Allahu. Allahu thotë: “Dhe natën fal namaz; shpresoj se Zoti yt do të të dërgojë (ringjallë) ty në një pozicion të respektueshëm.” Dhe në një ajet tjetër Allahu thotë: “Me të vërtetë, të devotshmit do të jenë në xhenete me burime të kulluara dhe do të marrin prej aty atë që u ka thënë Zoti i tyre. Me të vërtetë, ata kanë qenë përpara të sinqertë dhe bujarë, kanë qenë prej atyre që falnin namaz nate dhe i luteshin Allahut që t’i falte.” Madhëroje o njeri Allahun, Zotin tënd, ngrihu në errësirë të natës e fal namaz për Të. Vërtet shpërblimin dhe pagesën për këtë punë e të tjera e ka vetëm Allahu në dorë. Shpejto në punë e vepra të mira, derisa vdekja nuk ka arritur, të punojmë në punë të hajrit e të duhemi për hir të Allahut që Ai të na ngrejë në pozita të larta.

Në një hadith të transmetuar nga Sehlu Ibn Sead (r.a.), thuhet:

“Një ditë erdhi Xhebraili tek Profeti (a.s.) dhe i tha: ‘O Muhamed, jeto sa të duash, se ti do të vdesësh, puno çfarë të duash, se ti do të shpërblehesh për të, duaj kë të duash, se ti do të ndahesh prej tij dhe dije mirë se krenaria e besimit është namazi i natës.’ Allahu në Kuran thotë: **“O ti i mbështjellë! Ngrihu për falje natën, përveç një pjese të vogël të saj.**

Gjysmën e saj ose diçka më pak se gjysmën. Ose shto diçka prej saj dhe Kuranin lexoje me vëmendje. Ne do të të shpallim ty fjalë të rëndë (të madhe). E s’ka dyshim se aktiviteti i natës është fuqizues dhe fjalë më e qartë.” (Muzemil,1-6) Allahu i Madhëruar i lavdëron të gjithë besimtarët e devotshëm, duke përmendur vetinë e tyre më të veçantë – namazin e natës: **“Argumentet tona i besojnë, në të vërtetë, ata që kur këshillohen me to, bien në fytyra (bëjnë sexhde), që madhërojnë Zotin e tyre në shenjë falënderimi dhe ata nuk bëjnë kryelartësi, i heqin trupat e tyre prej dyshekëve, duke e lutur Zotin e tyre nga frika dhe nga shpresa dhe nga ajo që Ne ua kemi dhënë (pasuria) atyre, ata japin. Pra, për ata që kanë vepruar, nuk di askush për atë kënaqësi (të zemrës e shpirtit), që u është caktuar atyre si shpërblim.”** (Sexhde,15-16) Të gjitha këto argumente nga Kurani dhe Suneti flasin për rëndësinë dhe vlerën e këtij adhurimi, i cili ka shumë dobi për besimtarin dhe bëhet shkak për fitimin e Xhenetit dhe shpëtim prej dënimit të zjarrit të Xhehenemit. I Dërguari i Allahut (a.s.), në shumë hadithe i ka nxitur besimtarët për namazin e natës e ndër to përmendim: **“Namazi më i mirë pas farzit është namazi i natës.”** (Muslimi) **“Falni namaz nate, sepse ka qenë praktikë e njerëzve të mirë para jush, të afron te Zoti, të shlyen mëkatet dhe të mbron nga rënia në mëkate.”** (Tirmidhi – hasen). **“Në xhenet ka disa dhoma, pjesa e jashtme shihet prej brendisë së tyre dhe brendia e tyre shihet prej jashtë.”** Një beduin pyeti: **“Për kë janë ato, o i Dërguar?”** Tha: **“Për ata që ruajnë gjuhën, ushqejnë të varfrit, agjërojnë dhe falen natën, kur të tjerët flenë.”** (Tirmidhi – sahih).

Namazi i natës mund të falet në fillimin e natës, në mesin e saj ose në fundin e saj, mjafton që të jetë pas jacisë, kurse koha më e mirë dhe më e pëlqyeshme për faljen e këtij namazi është 1/3 e fundit të natës. Transmetohet nga Ebu Hurejre (r.a.), se Profeti (a.s.), ka thënë:

Allahu (xh.sh.) zbret çdo natë në pjesën e dynjasë në 1/3 e fundit të saj dhe thotë:

“Kush më lutet Mua, që t’i përgjigjem atij, kush më kërkon Mua, që Unë t’i jap atij dhe kush pendohet tek Unë, t’a fal atë. Ti motër dhe vëlla, kthehu nga Allahu, pendohu dhe kërko falje nga Ai. Vërtet Ai është Falës dhe Mëshirues, adhuroje Atë në formën më të mirë, që të gjesh shpërblim dhe ardhmëri më të mirë tek Allahu.

ARTI NË ATEIZËM, OSE NË TOTALITARIZËM

RASTI I BASHKIMIT SOVJETIK

Edison Çeraj

Meqë këto ditë është hapur një diskutim serioz (si rrallëherë) në median e shkruar në lidhje me krijimtarinë artistike nën komunizëm, pra nën totalitarizëm ose ateizëm, i cili nisi nga një shkrim i Fatos Lubonjës në një të përditshme¹, e pashë të udhës të hedh ca rreshta duke iu referuar kryesisht një trajtëse të Izetbegoviçit për fenomenin në fjalë, i cili ndalet në veçanti te ish-Bashkimi Sovjetik, duke qenë se pikërisht në Rusinë e atëherëshme u ngjiz, u bë doktrinë estetike dhe u aplikua i ashtuquajtur i “realizëm socialist”, që u ndoq nga shumë vende të tjera komuniste të kohës, dhe një ndër këto vende që edhe Shqipëria, ku më shumë se komunizmi si i tillë, tanimë dihet që është aplikuar me devotshmëri religjioze stalinizmi.²

Duhet thënë se asnjë periudhë në historinë e artit apo të kulturës në përgjithësi nuk mund të shihet bardh e zi, në kuptimin që të përkufizohet e të përmyllet me një të rënë lapsi, se ka qenë e errët apo e ndritur, e keqe apo e mirë, e tillë apo e atillë, sepse vetë historia, në jo pak raste na ka dëshmuar se pikërisht atëherë kur konditat kanë qenë “të favorshme”, ka pasur edhe shterpësi artistike, sikundërse kur konditat kanë qenë “të pafavorshme”, janë shfaqur individë që kanë lënë pas një krijimtari artistike të mirëfilltë. Ajo që në përcaktim me një fjalë goje si e mirë apo e keqe, si liri apo robëri/izolim, në fakt, nuk ka asgjë të prerë me thikë, pasi nëse çlirohemi nga etiketat do kuptojmë se këto janë të pleksura me njëra-tjetrën dhe aty ku neve na duket ose konstatojmë se mbizotëron njëra, diku pranë, në një mënyrë a në një tjetër, jeta e jetuar ka dëshmuar se ndodhet edhe tjetra. Kjo, sepse njeriu apo një grup i caktuar njerëzish nuk mund të kenë kontroll mbi historinë, pavarësisht se e duan këtë dhe vetëkënaqen e vetëpikëllohen me këtë iluzion që na ndjek vazhdimisht. *Lufta dhe paqja*, romani i njohur i Tolstoit, rreth dymijë faqe, është një provë e madhe që e vërteton këtë të fundit si mos më mirë.

In media res

Një nga ligjësitë e “ateizmit shtetëror” është fenomeni se në truallin rus, pranë ekspansionit të jashtëzakonshëm të arsimit si “civilizues”, ndodhi një turrje gati e paprecedent në art. Ecuria e arsimit që u shënu

1. Në gazetën *Panorama* të datës 13 shkurt, 2014.

2. Për lidhjen e sistemeve totalitare me religjionin, shih: <http://edisonceraj.blogspot.com/2013/08/per-nje-fenomenologji-te-totalitarizmit.html>

në vendet komuniste tejkalon çdo të dhënë që është regjistruar në këtë drejtim deri në atë kohë. Sipas disa të dhënave, në Bashkimin Sovjetik, më 1965 kishte mbi 60 milionë njerëz në marrëdhënie shkollë. Mirëpo, siç e kemi parë, ky është një arsimit i zhveshur, karakteri “civilizues” i të cilit vetëm sa është sforcuar me indoktrinim jokritik politik dhe ideologjik. Në këtë vend tipik me prirje drejt civilizimit, me një nëntekst që ulërin me mesianizmin që synon parajsën tokësore³, arti dhe kultura në përgjithësi kanë mbetur dukshëm në një gjendje amullie. Në veçanti kjo ka të bëjë me raportin e pushtetit publik dhe njeriut qytetar ose, më konkretisht, me çështjet e lirisë së njeriut, si çështje elementare e kulturës.

Sipas botëkuptimit zyrtar (të gjitha botëkuptimet janë zyrtare atje), letërsia në Bashkimin Sovjetik duhej të ishte një mjet presioni i përditshëm mbi masat. Me vendimin e KQ të PKBS, më 1932 u likuiduan grupe të ndryshme letrare dhe u themelua Lidhja Unike e Shkrimtarëve Sovjetikë. Ky likuidim mori edhe aspektin e tij konkret: nga 700 shkrimtarë që morën pjesë në Kongresin I të shkrimtarëve sovjetikë në vitin 1934, njëzet vjet më vonë, në një kongres tjetër, pra në vitin 1954, kishin mbetur gjallë vetëm 50 syresh. Pjesa më e madhe tyre e gjetën vdekjen në spastrimet e Stalinit. Realizmi socialist u shpall drejtimi (metoda) i vetëm i drejtë në artin sovjetik. Si shprehje e këtij arti “të angazhuar”, në Bashkimin Sovjetik u shfaq i ashtuquajtur i “roman prodhues”, që flet për industrializimin dhe të ardhmen e begatë që ai do ndërtonte për të gjithë. Në kongresin e shkrimtarëve sovjetikë të vitit 1965 u dënua teoria e antiheroit në letërsinë sovjetike, dhe konstatohet se “karakteristika e letërsisë sovjetike është patriotizmi i thellë dhe veprat heroike”.

“Nga të gjitha artet, filmi është më i rëndësishmi për ne”, thoshte Lenini. Në fakt, filmi është më pak art nga të gjitha fenomenet që gëzojnë këtë emër. Nëse u dashka që arti t’i shërbejë dikujt ose një gjëje, ideologjisë ose pushtetit (e njëjta gjë), atëherë filmi është më i përshtatshmi për të marrë rolin e një punëtori me rrogë.

R. N. Jurjenjev, një kritik sovjetik i filmit, në një prej monografive të tij për komedinë sovjetike filmike tregon se si në filmat me tema të kohës Stalini nuk e duronte paraqitjen e konflikteve, të vështirësive ose të të metave. Ai kërkonte që në vend të tyre të jepeshin skena me gosti,

3. Të gjithë fajin e ka bash një parajsë e tillë.

me dasma, mitingje, valle popullore dhe këngë korale. Meqë Stalini i shihte të gjithë filmat para se të shfaqeshin në publik, jepte direktiva të ndryshme që shndërroheshin në ligje estetike. Kjo pati si pasojë rënien e prodhimit në industrinë e filmit dhe fenomenin e sëmundjes së njohur si "frika nga satira".

Një vend që në shekullin e XIX, ende i varfër, gjysmanalfabet dhe i paorganizuar⁴, i dha botës Pushkinin, Gogolin, Çehovin, Turgenjevin, Tolstoin, Dostojevskin, Çajkovskin, Rimski-Korsakovin etj., në gjysmën e shekullit XX nuk mund të krenohet me asnjë krijues të artit apo të letërsisë që do mund të barazohej me protagonistët e mëdhenj të kulturës ruse të orëve të para, kur ajo po debutonte në skenën historike. Nëse në letërsi mund të përmendet ndonjë emër i rëndësishëm, i dalë nga gjeni i fuqishëm shpirtëror i rusëve, ai përbën një opozitë të vazhdueshme përballë sistemit. Ja të përmendim ndonjë: Pasternaku, Solzhenjicini, Vozneznski apo Brodski. Në të vërtetë, dhe rus është pjellor, por atmosfera e asaj kohe të zinte frymën.

Pas revolucionit të nëntorit filloi lartësimi i shkencës ruse dhe recesioni i artit. Rusia sovjetike nxori fizikanë, atomistë, inxhinierë, burra shteti dhe organizatorë, por jo poetë, piktorë dhe muzikantë.

Amullia që e theksuar në veçanti në filozofi, sa që mund të themi se pati një zbrazëti të plotë; natyrisht nëse këtu nuk fusim profesorët e filozofisë apo nëpunësit e instituteve të filozofisë. Rusia sovjetike e asaj kohe nuk kishte asnjë emër filozofi që mund të radhitej krahas Heidegger-it, Marcuse-s, Gadamer-it apo Sartre-t. Sidoqoftë, "filozofët" sovjetikë nuk janë aspak të denjë përkrah bashkëvendësve të tyre që forcën e mendimit ia kushtuan shkencës, teknikës ose politikës.

Gjithandej ndihej ngopja me formulën e të ashtuquajturit "realizëm socialist". Interesimi i publikut ishte në rënie dhe kështu orvateshin në mënyrë të vazhdueshme ta nxisnin me shprehje tipike të fabrikës së optimizmit: "Platforma është e lartë dhe e mrekullueshme teksa valëvitet flamuri i realizmit socialist."⁵ Shkrimtarë si Grigurko, Bojko, Malcev, Tarasov, Sushinski e ndonjë tjetër, të panjohur në Europë, madje, pak a shumë edhe në Rusinë e asaj kohe, lavdëroheshin vazhdueshëm nga kritika zyrtare, pikërisht sepse u qaseshin temave bashkëkohore, si, fjala vjen, "prodhimit". Këta autorë përshkruajnë ndërtimin e objekteve të mëdha industriale dhe "pasqyrojnë jetën e klasës punëtore dhe fshatare". Këto janë veprat që punohen sipas sistemit të porosisë shoqërore *soczakaz*⁶.

Akademiku Korzhev pranonte se "për fat të keq, në ekspozitat tona paraqiten jo rrallë punime që janë variacione të personazheve tashmë të krijuara". Ndërkaq

4. Domethënë, "i pacivilizuar", për të folur me gjuhën e iluministëve të djeshëm e të sotëm.

5. Një parullë e vendosur në ekspozitën retrospektive të akademikëve sovjetikë në Maniez, në fillim të vitit 1974.

6. "Soczakaz" – është një term që përdorej asokohe për veprat e p - rositura artistike, stereotipa tipikë, pa frymëzimin e natyrshëm vetjak.

poeti Boris Olejnik ankohej për pikturimin bardh e zi të jetës, për cektësi e mediokritet: "Në qiellin e poezisë sovjetike shfaqen yje me një shkëlqim të zbehtë, të njëllojtë. S'ka poezi të vërtetë. Ka vetëm vargje dhe imitime të poezisë."

Në një botim vjetar të vitit 1979, grupi emblemë i shkrimtarëve sovjetikë (A. Vozneznski, Bela Ahmadulina, Vasili Aksionov, Fazil Iskender etj.) e përshkruajnë jetën letrare në Bashkimin Sovjetik si "një sëmundje kronike të cilën mund ta identifikosh si frikë nga letërsia dhe si një inerci të vranët që shkakton gjendjen e frikësimit të qetë e bajat."⁷

Ky raport negativ ndaj artit u manifestua njëlloj edhe në arkitekturë. Gjithandej nëpër botë, qytetërimi i dha arkitekturës një drejtim që e bënte atë sa më funksionale, drejt "tekturës" së zhveshur. Por, "qytetet e ndërmjetme" (ose pjesët e reja të qyteteve) në vendet socialiste paraqisnin tërësitë urbane më të shkreta e më të mërzitshme që janë ndërtuar ndonjëherë. Ato janë gati të gjitha të njëtrajtshme deri në mërzi e ankth. Për këtë sajoheshin (dhe sajohen akoma edhe më shumë sot) arsytetime të ndryshme, si për shembull, nevojat e mëdha, mjetet e pamjaftueshme, ndërtimi industrial e të tjera kësodore.⁸ Mirëpo tashmë dihet se të tilla arsytetime nuk qëndrojnë. Po të vihet re me kujdes, të gjitha objektet apo ndërtesat e këndshme dhe me një mesazh kuptimplotë, datojnë në ato periudha kur njerëzit ishin shumë më "të varfër". Gjithsesi, ndërtesat mund të bëhen të bukura edhe me elemente/pjesë të fabrikua. Këtu është fjala për qëndrimin e brendshëm, të vetëdijshëm a të pavetëdijshëm, ose për pyetjen e fshehur: Përderisa njerëzit nuk kanë shpirt, atëherë pse duhet të kenë qytetet?

Sido që të jetë, kur bie fjala për art, duhet të bëjmë dallimin midis popullit rus dhe regjimit sovjetik të asaj kohe. I pari është përplot me ngjyrim religjioz dhe artistik, ndërsa i dyti me një prirje të theksuar kundër religjionit, dhe si i tillë edhe kundër artit. Interesimi i njerëzve për letërsi është i madh, gati "histerik", siç që shprehur shkrimtari Vasili Aksionov.

Ky fenomen meriton të studiohet gjerë e gjatë. Por, ka shumë të ngjarë që kjo "histeri" të ketë qenë manifestim i religjiozitetit "të papërrjetuar" të njeriut rus; pra, përjetimi i asaj që në njëfarë mënyre që bërë e pamundur me anë të religjionit. Atëherë kur ateizmi kthehet në sistem, arti zëvendëson religjionin e dëbuar.⁹

7. Ky vjetar njihet më shumë për debatin e ashpër ndërmjet grupit të shkrimtarëve amerikanë (Albee, Miller, Updike etj.) dhe Drejtorisë së Organizatës të Shkrimtarëve Moskovicë, për shkak të ndalimit të shtypjes së vjetarit dhe masave administrative kundër autorëve të tij.

8. Këto arsytetime janë fije e për pe njësoj me arsytimet që bëhen sot në "demokraci" dhe në përrallën e "tregut të lirë", sepse në thelb kemi të bëjmë po me totalitarizëm (i cili dje ishte në trajta lokale, kurse sot në trajta globale) dhe me punë e vetëm punë për të ndërtuar paraqisn tokësore.

9. Edhe përvoja e komunizmit në Shqipëri thotë shumë në këtë ko - tekst.

NDËSHKIMI IMADH

Filiz Konxha



Njëri prej bijve të Izraelit i tha Allahut Teala:

-O Zot! Unë kam bërë shumë mëkate, por Ti nuk më ke ndëshkuar për to!

Allahu Teala i dërgoi shpallje pejgamberit të Tij:

-Shko tek ai dhe thuaj: "Unë i kam dhënë atij ndëshkimin më të madh, por ai nuk e kupton këtë... Atij i kam hequr lotët dhe lutjen!"

Hareja dhe qetësia e zemrave të ndjeshme e të buta është vetëdija për të qenë bashkë me Allahun e Madhëruar. Ndërkohë që kjo gjendje bashkimi lind ndjesinë e lutjes në zemër, në sy shfaqet si lot dhe në gjuhë si përgjërimit. Nisur nga kjo, një rob që nuk ka entuziazëm lutjeje në zemër, shprehje të bukur të lutjes e përgjërimit në gjuhë dhe lotë në sy, sigurisht se është një rob i privuar. Ky privim është një ndëshkim i madh hyjnor, që kërkon shumë istigfar. Lusim Allahun Teala, i cili është shumë i mëshirshëm e shumë bujar kundrejt robërve të tij, që të mos na privojë nga lutja dhe nga lotët që derdhen për hir të Tij!

Siç ndodhet në bazën e tërbimit njerëzor ndjenja e mendjemadhësisë dhe e mburrjes¹, edhe në bazën dhe esencën e adhurimit ndodhet vetëdija e dobësisë së vetes dhe e nevojës kundrejt Allahut Teala. Allahu i Madhëruar, që është zotëruesi i vetëm i emrit "es-Samed", që do të thotë: Ai që çdo gjë ka nevojë për të,

por që Ai nuk ka nevojë për asgjë", ia kujton edhe një herë këtë dobësi njeriut, duke thënë:

"O njerëz! Të gjithë keni nevojë për Allahun."²

Ata që shpëtojnë nga dallgët e frikës duke e kuptuar nevojën për Zotin e dobësinë e vetes së tyre dhe që ia dedikojnë Allahut Teala të gjithë egon e tyre me vetëdijen, "më kap për dore O Zot! Më kap se nuk mundem pa Ty", për të arritur në bregun e shpresës, natyrisht se do ta arrijnë bregun në mënyrë të sigurt. Për shkak se njerëzit e tillë do të arrijnë shfaqjet pozitive të Zotit, xhelle xhelaluhu, do t'i ndejnë në zemër frymët e qetësisë së afrimit hyjnor dhe në këtë mënyrë, do të bëjnë një jetë larg frikës e pikëllimit dhe nën mbrojtjen e Allahut Teala dhe të sigurt nga e keqja e shejtanit (djallit), nga e keqja e vetes dhe nga e keqja e çdo krijese. Allahu i Madhëruar thotë:

"Lutmëni Mua, në mënyrë që t'ju përgjigjem."³

Kur Allahu i Madhëruar flet për zotat e pavërtetë, thotë se ata nuk mund t'i përgjigjen lutjes dhe pastaj pyet se si mund të jetë zot një qenie që nuk mund t'i përgjigjet duasë. Sikundër kësaj, Ai (xh.xh.), na njofton se është afër robërve të Tij dhe u përgjigjet lutjeve të

1. Surja Alak, 6-7.

2. Surja Fatir, 15.

3. Surja Gafir, 60.

tyre. Sa mirësi e madhe është ky nderim, që Zoti i botëve i bën robët të Tij! Mirësia e të qenit me Zotin, xhelle she'nuh, të biseduarit me Të dhe të ndjerët se është më pranë nga damarët e qafës me mëshirën dhe ndihmën e Tij, është një mirësi e madhe hyjnore që pothuajse e deh perceptimin njerëzor me kënaqësi shpirtërore. Ndërsa privimi nga kjo mirësi shpirtërore, me të vërtetë është një humbje e qartë.

A janë një lutje me të vërtetë fjalët që shpesh nxirren nga gjuha jonë si të tilla? Me çfarë ngrihen në audiencën e lartë fjalët që do të shkojnë te Zoti? A e arrijnë përgjigjen e Allahut të Madhëruar me këtë mënyrë përsëritjet e fjalëve që edhe vetë njeriu nuk e di se çfarë ka thënë? Ja, masat e vlefshmërisë së lutjeve tona janë të fshehura në përgjigjet e këtyre pyetjeve.

Kurani Famëlartë na tregon se si duhet të bëhet lutja:

"Lutjuni Zotit tuaj përulshëm dhe ngadalë! Njëmend, Ai nuk i do ata që e kalojnë kufirin."⁴

"Ata ngrihen nga shtrati, i luten Zotit të tyre me frikë e shpresë dhe japin nga ajo që iu kemi dhënë Ne."⁵

"Ai është i Përrjetshmi, s'ka zot tjetër të vërtetë përveç Tij. Prandaj lutjuni vetëm Atij, duke iu drejtuar me adhurim të sinqertë. Qoftë i lavdëruar Allahu, Zoti i botëve!"⁶

Kurani Fisnik na njofton se ata që ngelin ballë për ballë me vdekjen kundrejt dallgëve të tërbuara, i luten Zotit në mënyrë të sinqertë.⁷ Domethënë, kur njeriu shikon se nuk ka ngelur zgjidhje tjetër përveç Allahut Teala, i drejtohet Atij në mënyrë të sinqertë dhe i lutet. Ja pra, kur lutjet bëhen në një dobësi të tillë, ato janë lutje të sinqerta. Pasi i ndjeri Profesor Nexhip Fazëlli transmeton ngjarjen për të cilën folëm më sipër, pyet: "A patjetër duhet të biem në një pus me gjarpërinj, në mënyrë që të qajmë dhe t'i lutemi Zotit?.. A nuk mjafton të kuptojmë se dynjaja në të vërtetë është një pus i tmerrshëm dhe i mbushur me gjarpërinj?"⁸

Lutja duhet të bëhet nga zemra. I Dërguari i Allahut, (a.s.), thotë kështu:

"Lutjuni Allahut, duke besuar se do të pranohet! Dije-ni se Allahu nuk e pranon një lutje të bërë me një zemër të shkujdesur."⁹

Hz. Mevlana thotë:

"Lutja e atij që e ka zemrën të pastër nga sëmundja,

4. Surja Araf, 55.

5. Surja Sexhde, 16.

6. Surja Gafir, 65.

7. Shik. Junus, 22; Ankebut, 65; Rum, 33.

8. Xhinnet Mustatili, fq. 326.

9. Tirmidhi, Deavat, 65.

arrin deri te Allahu, azze ve xhelle!"¹⁰

Edhe ky ajet fisnik tregon se veprat e mira janë shkallët që i ngrenë deri në audiencën hyjnore fjalët e bukura që dalin nga gjuha:

"Kush dëshiron lavdi e pushtet, ta dijë se e gjithë lavdia e pushteti i takojnë Allahut. Tek Ai ngjiten fjalët e bukura, ndërsa veprën e mirë Ai e ngre Vetë. Sa i përket atyre që kurdisin të këqija, ata do të kenë dënim të rëndë dhe dredhitë e tyre do të dështojnë."¹¹

Ky ajet shpreh domosdoshmërinë e unifikimit të lutjes në fjalë me veprat e mira. Edhe mufessiri i madh Elmallëllë shprehet se "shfaqjet e mirësisë së Allahut Teala gjithmonë janë në bashkimin e të fshehtave të shkaqeve materiale dhe atyre shpirtërore". Siç bëhet lutja, e cila është një sebeb shpirtëror, shkak për frymëzimin e sebeb material, edhe sebeb material u hapin derën lutjeve që janë sebeb shpirtëror. Nisur nga ky aspekt, mosprania e shkaqeve nuk duhet ta zvarrisë njeriun në pesimizëm, po ashtu, edhe bashkimi i shkaqeve nuk duhet t'i japë atij një siguri që mund ta bëjë të harrojë Allahun e Madhëruar. As lutjet nuk duhet të lihen, por edhe shkaqet duhet të kryhen. Ne nuk duhet ta lëmë asnjëherë lutjen me një zemër të sinqertë ndaj Allahut Teala. Po ashtu, në të njëjtën kohë duhet ta dimë se produktiviteti më i madh i lutjes është zbulimi i të fshehtave shpirtërore. Nëse çështjen e mendojmë më thellë, shohim se zbulimet artistike më të mëdha janë vepra të frymëzimit hyjnor që bien si rrufe në zemrën e njeriut."¹²

Shpeshherë ne lutemi vetëm kur kemi vështirësi apo kur nuk kemi rrugëzgjidhje tjetër. Ndërkohë, lutja nuk është dera e fundit te e cila mund të strehohemi kur shkaqet janë mbaruar apo te e cila mund të trokasim. Përkundrazi, ajo është një derë e përhershme, në të cilën duhet të trokasim vazhdimisht kur shkaqet janë mbaruar, kur shkaqet janë formuar, kur vazhdojnë dhe për arritjen e suksesit, sepse "lutja është esenca e adhurimit."¹³

Zoti na mbrojtë nga sëmundja shpirtërore, që na ndalon nga lutja dhe na bëftë prej robërve që i luten e i përgjërohen natë e ditë me frikë dhe me shpresë si dhe me dëshirën për të arritur kënaqësinë e bukurinë e Tij!

Amin!

10. Mesnevi, bejti nr: 9988.

11. Surja Fatir, 10.

12. Shik. Hak Dini Kur'an Dili, I, 366.

13. Tirmidhi, Deavat, 1.



Sulbe të zgjedhura

Naim Drilja

SHOQËRIA në Islam

I Dërguari i Allahut (a.s.), ka thënë: “Njeriu është në fenë e shokut të vet, prandaj le të ketë kujdes secili prej jush se me kë shoqerohet.” Hadithi në fjalë tregon qartë se shoqëria ka ndikim të dukshëm tek individi. (Ebu-Davud, Trimidhi.)

Ne duhet të tregojmë shumë kujdes se me kë shoqërohemi. Një fjalë e urtë arabe thotë: “Shok numërohet ai person që ju bën të shkoni drejt një kahu në jetën tuaj.” Pra, nëse shoku që keni është i mirë, ai ju fton drejt punëve dhe sjelljeve të mira, por nëse ai është i keq, atëherë do t’ju ftojë drejt gjërave të këqija dhe të liga. Ne duhet ta zgjedhim me kujdes të madh shoqërinë tonë, të zgjedhim ata që janë të sinqertë, të cilët na këshillojnë për gjëra të mira dhe na tërheqin vërejtje kur shohin se jemi duke kryer një punë të keqe.

Besimi është forca që i bashkon besimtarët dhe i bën ata vëllezër. Pejgamberi (a.s.), ka thënë: “Kush zotëron këto tri cilësi, ka për ta shijuar ëmbëlisinë e besimit: njeriu që e do Allahun dhe të Dërguarin e Tij më shumë se çdo gjë tjetër, njeriu që e do një person tjetër vetëm për hir të Allahut dhe personi që urren të kthehet në mosbesimin, ashtu siç urren hedhjen në zjarr.” (Buhari, Muslim.)

Pejgamberi (a.s.), ka thënë: “Dallimi mes shokut të mirë dhe shokut të keq është si dallimi mes shitësit të parfumeve dhe farkëtarit. Tek shitësi i parfumeve ose blen erë të mirë, ose së paku, kur të largohesh prej dyqanit të tij do të dalësh me aromë të mirë. Ndërsa kur shkon tek punishtja e farkëtarit ose mund të të digjen rrobat, ose kur të largohesh prej aty do të dalësh duke të marrë rrobat erë të keqe.” (Buhari, Muslim)

Shoqëria e keqe të largon nga Islami... Të shtyn të mos e falësh namazin në xhami, duke u arsyetuar se mund ta falësh edhe në shtëpi.

Të largon nga rruga e Zotit, duke u tallur me ty, duke të thënë: “Ku je duke shkuar? Në ligjëratat?”

“Pse shkon në ligjëratat e filan personi? Eja me ne të

takohemi me këtë apo atë.”

Ndërsa shoku i mirë gjithmonë të ndihmon ta kujtosh Allahun. Ne e dimë se gjatë hixhretit me Pejgamberin (a.s.), Ebu Bekrin (r.a.), e kaploi frika jo për veten e tij, por për Pejgamberin (a.s.). Kur ata ishin në shpellë, i Dërguari i Allahut e qetësoi Ebu Bekrin (r.a.), duke i thënë:

“Mos u pikëll, se Allahu është me ne.”

Llokman Hakimi (Allahu e mëshiroftë!), ka thënë: “Tri cilësi të njeriut njihen vetëm në tri situata: urtësia njihet në hidhërim, trimëria në betejë dhe shoqëria e mirë në vështirësi.”

Imran ibn Hetani (r.a.), tregon: “Vajta në xhami dhe gjeta aty vetëm Ebu Dherrin të mbuluar me një rrobë të zeze. I thashë: ‘O Ebu Dherr! Pse qëndron kështu vetëm?’ Ai më tha: ‘E kam dëgjuar Pejgamberin (a.s.), të thotë: ‘Vetmia është më e mirë se shoqëria e keqe, por shoqëria e mirë është më e mirë se vetmia! Fjalët e dobishme janë më të mira se heshtja, kurse heshtja është më e mirë se fjalët e këqija!’” (Bejhekiu)


Sa njerëz kanë humbur sot rrugën e drejtë për shkak të shoqërisë që kanë pasur, e cila i ka futur në harame? Allahu (xh.sh.), në Kuranin famëlartë urdhëron e thotë: **“Ditën e Gjykimit keqbërësi do të hajë gishtat e duarve dhe do të thotë: ‘Ah, sikur të kisha ndjekur rrugën (e drejtë) me të Dërguarin! Ah, sikur të mos isha bërë mik me filanin!’”** (Furkan, 27-28)

Llokman Hakimi e ka këshilluar të birin me këto fjalë:

-Biri im, mos u shoqëro me njerëz të këqinj. Frikësohu se mund t’i godasë dënimi i Allahut dhe përfshihesh edhe ti.

-Bir im, shoqërohu me njerëz të urtë dhe të ditur, sepse mund të zbrësë mbi ta mëshira e Allahut dhe përfshihesh edhe ti.

Aliu (r.a.), ka thënë: “Mos u shoqëro me njerëzit e këqinj, sepse ata t’i zbukurojnë punët e mbrapshta dhe dëshirojnë që edhe ti të bëhesh si ata.”



“Dallimi mes shokut të mirë dhe shokut të keq është si dallimi mes shitësit të parfumeve dhe farkëtarit. Tek shitësi i parfumeve ose blen erë të mirë, ose së paku, kur të largohesh prej dyqanit të tij do të dalësh me aromë të mirë. Ndërsa kur shkon tek punishtja e farkëtarit ose mund të të digjen rrobat, ose kur të largohesh prej aty do të dalësh duke të marrë rrobat erë të keqe.”

DOBITË E KONSUMIT TË PESHKUT

Peshku është një nga ushqimet më të mira për shëndetin e njeriut, për vetë faktin sepse ai është i pasur me proteina, vitamina, minerale dhe yndyra të pangopura siç është omega 3

Në lidhje me ndikimin e peshkut mbi shëndetin e njeriut çdo ditë e më shumë po dalin kërkime shkencore dhe çdo ditë e më shumë po këshillohet shtimi i peshkut në për tryeza.

Disa nga dobitë e peshkut mbi shëndet janë:

1. Është zbuluar se acidet yndyrore omega 3 të cilat gjenden tek peshku bëjnë mrekulli mbi zemrën, arteriet dhe venat pra mbi gjithë sistemin kardiovaskular të njeriut. Një dietë e pasur me peshk ul në minimum kapjen nga sëmundjet kardiovaskulare, Peshku parandalon akumulimin e triglicerieve dhe rrit të ashtuquajturin kolesterol i mirë HLD.

2. Gjithashtu peshku ndikon edhe në normalizimin e tensionit të gjakut.

3. Peshku ndihmon në rënien nga pesha, në këtë përfundim ka arritur një studim i bërë nga University of Georgia në Amerikë.

4. Konsumimi i omega 3 e cila gjendet në peshk ndihmon në parandalimin e kancerit sidomos luan një rol të rëndësishëm parandalues në kancerin e gjirit, prostatës dhe zorrës së trashë,

5. Konsumimi i peshkut ndihmon në ruajtjen, zhvilli-



min dhe rritjen e veprimtarisë së trurit. Acidi omga 3 është një ushqim i pazëvendësueshëm për trurin. Ajo rrit përqendrimin, kujtesën dhe mbron trurin nga një sërë sëmundjesh.

6. Gjithashtu konsumimi i peshkut ka veçori antiinflatore, prandaj është shumë efikas në reduktimin e inflamacionit në gjak dhe inde.

7. Konsumimi i peshkut ndihmon po ashtu në mbajtjen e një lëkurë të freskët dhe gjendje të mirë.

8. Një tjetër dobi e rëndësishme e konsumimit të peshkut është lufta e tij kundër stresit dhe depresionit. Studimet flasin për nivel më të ulët të stresit dhe depresionit tek personat që konsumojnë peshk më shpesh.

Të gjitha këto dobi kanë bërë që të nxitet konsumimi i peshkut sidomos peshku me përmbajtje të acidit omega 3 siç është salmoni, sardelja dhe toni.

ALERGJITË E PRANVERËS

Çfarë janë alergjitë e pranverës?

Në pranverë, kur pemët fillojnë të lulëzojnë, ku polen ka kudo në ajër, të gjithë ata të cilët kanë probleme me alergji, fillojnë teshtitjen konstante, përlojten e syve...

Reaksionet alergjike posaçërisht janë të dukshme gjatë ditëve me erë, sepse gjatë erës, përmes ajrit mund të bartet poleni, përderisa gjatë ditëve me shi, reaksionet janë më të dobëta, sepse shiu pastron grimcat e polenit.

Edhe pse nuk ekziston ilaçi magjik, i cili parandalon plotësisht paraqitjen e alergjisë, ekzistojnë disa mënyra se si mund të parandalohet.

Çfarë i shkakton alergjitë e pranverës?

Grimcat e imëta të cilat barten nga pemët, bari – poleni, janë “kyqësit” më të shpeshtë të alergjisë së pranverës.

Kur grimcat e polenit arrijnë në hundën e personit

alergjik, sistemi imunitar i njeriut sulm në organizëm. Për këtë krijohen antitrupe të cilat sulmojnë alergjenet, gjë që shpie në lirim të histaminës në gjak, i cili është iniciator i reaksioneve alergjike siç janë: rrjedhja e hundës, kruarja e syve dhe simptomat e tjera.

Si ti parandaloni alergjitë?

Është shumë e vështirë ti parandaloni alergjitë e pranverës, megjithatë, përmbahuni disa këshillave se si ti zvogëloni simptomat:

1. Qëndroni në shtëpi kur niveli i polenit në ajër është i lartë – gjatë orëve të paradites dhe mbyllni dyert dhe dritaret në mënyrë që të parandaloni grimcat e polenit, që të hyjnë në shtëpinë tuaj.

2. Keni kujdes rreth higjienës së shtëpisë. Thithni pluhurin me makinë thithëse minimum dy herë në javë dhe pastroni pluhurin detalisht.

3. Pas shëtites pranverore në natyrë, zhvishuni, bëni dush dhe lani flokët.

DOMATE E ZEZË

Një risi vërtet e madhe do të vijë në tavolinat tona. Më 10 prill doli në treg SunBlack, një varietet i veçantë i domates, ku specifikë në pamje të parë ka ngjyrën e zezë, por jo vetëm. Domatja e zezë vjen si një mirëbërëse e fuqishme për shëndetin tonë.

Pra e reja nuk ka të bëjë vetëm me ngjyrën e zezë të domates, por mbi të gjitha për të mirat e shëndetit tonë. SunBlack, është i pasur anthocyanins, antioksidantë të fuqishëm që reduktojnë radikale të lira dhe që kryesisht i gjejnë tek rrushi i kuq, luleshtrydhja, manaferrat, qershia, por jo në sasi të konsiderueshme në varietet e zakonshme të domateve.



BLETËT NË AMERIKËN E VERIUT

Ndonëse shkatërrimi i kolonive të bletëve në Amerikën e Veriut është ende një mister i pazgjidhur, një biolog i Shërbimit Gjeologjik të Shteteve të Bashkuara po përpiqet të ruajë kujtimin e mijëra llojeve të insekteve polenizuese, disa prej të cilëve mund të jenë në zhdukje.

Një fenomen misterioz që po shkatërron kolonitë e bletëve u kanoset insekteve mjaltëbërëse në të gjithë botën. Specialistët thonë se katër mijë speciet e bletëve të Amerikës së Veriut mund të zhduken.

Hulumtuesja nga Universiteti "Rutgers" Rachael Winfree thotë se bletët mjaltëbërëse nuk janë të vetmet që po rrezikohen.

"Ajo që ne kemi gjetur është se insektet e egra vendase kanë përgjysmuar aktivitetin tek lulet."

Një shkencëtar me Shërbimin Gjeologjik amerikan, Sam Droege thotë se bletët janë tepër të bukura për t'u harruar nëse zhduken përgjithmonë. Me ndihmën e një tekniku laborator, ai është duke krijuar portrete të bletëve plot ngjyra.

"Kur sheh speciet vendase, vëren ngjyra metalike, të gjelbër, blu, të zeza me shenja të ndryshme, dhe disa janë të kuqe."

Zoti Droege po fotografon jo vetëm bletët shtëpiake, por edhe speciet e egra të cilat polenizojnë bimët.

Ai i mbledh vetë disa nga speciet, ndërsa të tjerat i dërgohen nga agjenci qeveritare, hulumtues dhe institute në të gjithë vendin.

Përpara sesionit të fotove, bletët duhet të lahen dhe thahen. Zoti Droege i vendos ato në një kuti të posaçme të bardhë e cila përcjell dritën pa lënë hije.

Nga këto fotografi, të marra nga kënde të ndryshme,



prodhohet një fotografi e vetme e bukur nga bashkimi i tyre nga një program kompjuterik.

Zoti Droege thotë se puna e tij ka dy elementë.

"Një element është thjesht shkencor, në mënyrë që të ilustron udhëzuesin tonë të identifikimit, të cilat janë shumë teknike dhe mund të shihen vetëm nga një numër i vogël njerëzish. Por, aspekti tjetër është një lloj mjeti për të treguar dhe ilustruar gjithë bukurinë e tyre."

Zoti Droege thotë se fotot e detajuara do të ndihmojnë hulumtuesit me kursimin e kohës dhe parandalimin e gabimeve të identifikimit.

Disa nga fotot janë në dispozicion në faqen e internetit të Shërbimit Gjeologjik të Shteteve të Bashkuara.

RESTAUROHET XHAMIA E PAZARIT NË KRUIJË

Zëvendëskryeministri i Turqisë, Emrullah İşler, i cili ndodhej për një vizitë zyrtare në Tiranë ku u takua me personalitete të politikës shqiptare ndër të tjera mori pjesë në ceremoninë e përrurimit të Restaurimit të Xhamisë së Pazarit Krujë, realizuar nga Agjencia Turke për Bashkëpunim dhe Koordinim TİKA. (Agjenci donatore e varur nga Kryeministria e Republikës së Turqisë). İşler në ceremoni u shoqëria nga deputetë dhe personalitete të lartë të Turqisë si dhe nga Ministrija e Kulturës, Mirela Kumbaro, Ministri i Shëndetësisë, Iir Beqaj, Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Bujar Leskaj, Prefekti i Tiranës, Sadi Vorpsi, Kryetari i Partisë Drejtësi Integrim dhe Unitet, Shpëtim Idrizi dhe shumë personalitete të tjerë të lartë dhe pjesëmarrje të gjerë të komunitetit.

Restaurimi i Xhamisë, është realizuar pas një kohe të gjatë. Punimet e Fizibilitetit, Projektimi, Kolaudimet e Projektit, Zbatimi – afërsisht 2 vjet, të gjitha punimet e projektimit dhe zbatimit janë realizuar nga firma Turke të kontraktuara nga TİKA me përvojë në restaurimin e objekteve të ngjashme, dhe të gjitha punimet e restaurimit janë realizuar konform ligjeve shqiptare të restaurimit, të supervizuara nga specialistë të TİKA dhe Institutit të Monumenteve të Kulturës së Republikës së Shqipërisë.



TİKA ka restauruar edhe Xhaminë e Kalasë së Prezës, e cila pritet të inaugurohet në një kohë të mëvonshme (në një vizite zyrtare të Kryeministrit të Turqisë Z. Recep Tayyip ERDOĞAN).

Ndërkohë, 3 xhamitë e tjera, po me financim të TİKA, restaurimet e të cilave po vazhdojnë me ritme të shpejta dhe që priten të përfundojnë brenda pak muajsh janë Xhamia e Nazireshës Elbasan, Xhamia e İljas Bej Mirahorit Korçë dhe Xhamia e Plumbit Berat. TİKA krahas projekteve të Restaurimit të Monumenteve Kulturore, realizon shume projekte në ndihmë të popullit Shqiptar në fusha të ndryshme si arsim, shëndetësi, infrastrukturë, kulturë, bujqësi, etj.

Në ceremoninë e përrurimit të Restaurimit të Xhamisë së Pazarit Krujë mori pjesë edhe medreseja e Shkodrës ku përshëndeti zv. Kryeministrin e Turqisë me disa ilahi dhe poezi turqisht-shqip. Z. İşler u shpreh tepër i kënaqur për pritjen e organizuar dhe shprehu dëshirën që shpejt të vizitohet Shkodrën.

GJETJA E AVIONIT TË HUMBUR

Në kushtet kur satelitët përshkojnë mbarë globin dhe kur përdoren gjerësisht sistemet GPS në makina, apo telefona celularë, si mund të zhduket pa lënë gjurmë një avion i madh?

Konsulentit për sigurinë e aviacionit, John McGraw, thotë se kjo është më e lehtë se sa mendohet.

“Njerëzit kanë përshtypjen se çdo avion, edhe kur është duke fluturuar mbi oqean, është brenda rrezes vëzhguese të radarëve, të monitoruara nga njerëzit. Por nuk ndodh kështu. Radarët nuk kanë një rreze aq të gjatë”

Por zoti McGraw thotë se avionit Boeing 777 ka mjaft teknologji që ndihmojnë në gjetjen e vend-ndodhjes së tij.

Sistemet e avionëve transmetojnë automatikisht lartësinë, kushtet e motit, pozicionin dhe shpejtësinë, për kontrollorët e trafikut. Po ashtu, ka të paktën tre mënyra me të cilat piloti mund të komunikojë me zyrtarët. Në se avioni bie në oqean, kutia e zezë, e cila regjistron të dhënat, lëshon një sinjal që kapet deri tre kilometra larg.

Ish-hetuesi i Agjencisë Amerikane të Aviacionit thotë se ka edhe rregullore globale.

“Linja ajrore ka përgjegjësi për “ndjekjen e fluturimit”. Ky është një standard ndërkombëtar, që kërkon të dihet vendodhja e avionit në çdo kohë.”

Por në rastin e avionit të linjës Malaysia Airlines, zoti Daniel thotë se shoqëria nuk ka dhënë shumë informacione.

“Mundet të mos jenë ndjekur standardet... Dhe kjo është shumë shqetësuese, sepse ky është një informacion shtesë, mbi bazën e të cilit hetuesit mund të punojnë për përcaktimin e vendodhjes së avionit.”

Autoritetet po punojnë intensivisht për gjetjen e avionit dhe të kutisë së zezë, për të zbuluar se çfarë ka ndodhur. Pas zhdukjes në vitin 2009 të një avioni të linjës Air France, Bordi Amerikan i Sigurisë së Transportit kërkoi vendosjen e një regjistruesi të vazhdueshëm të të dhënave të fluturimit në rastet e emergjencave.

“Në të kaluarën përdorimi i kësaj pajisjeje nuk ka qenë i justifikuar, ngaqë është tepër e kushtueshme dhe ngaqë nuk ka pasur shumë aksidente. Por rasti i tanishëm, sigurisht që do të shërbejë si nxitje për ta bërë këtë.”

Autoritetet kanë ende shpresa për gjetjen e avionit të humbur.